

Sami
Frashëri
VEPORA

BIBLIOTEKA

854-82

F 86

4

RRINDJA

Biblioteka RILINDJA

Redaktor

Nazmi Rrahmani


814-82

F 86

Zija Xholi

SAMI FRASHËRI

Monografi




RILINDJA


Redaksia e botimeve

Prishtinë

1978







PARATHËNIE

Kanë kaluar 74 vjet nga ajo ditë vere, (18 qershor 1904), kur Sami Frashëri mbylli sytë përgjithnjë në Stamboll, qytet i cili për dekada të tëra u bë qendra e betejave të tij politike dhe ideologjike, shpesh dhe ajo e mundimeve dhe e ndjekjeve të tij nga sulltan Abdyl Hamiti II dhe pushteti i tij i egër dhe gjakatar.

Gjatë 74 vjetëve të kaluar nga vdekja e Samiut, a është shkruar dhe thënë gjithçka që duhej për jetën dhe veprën e tij? Kësaj pyetje, me keqardhje, nuk mund t'i jepet një përgjigje plotësisht pozitive. Për Samiun mbetet akoma shumë për të shkruar e për të thënë. Bile për të do të ketë gjithnjë diçka të panjohur për t'u zbuluar, diçka të re për t'i shtuar, aq e rëndësishme është vepra e tij për historinë e Shqipërisë dhe kulturën shqiptare, aq monumentale është ajo për historinë e Turqisë dhe kulturën turke.

Gjithë jeta e ndërgjegjshme e Samiut ka qenë jeta e një studiuesi dhe shkrimtari që nuk ka njohur as pushim, as lodhje. Për Samiun vlejnë po ato fjalë që ai vetë thoshte për Hoxhë Tahsinin: libri nuk i hiqej nga dora, leximin e pushonte vetëm kur mësonte të tjerët dhe, do të shtonim ne për Samiun, kur shkruante vetë apo merrej me veprimtari patriotike, sepse Samiu, si të gjithë mendimtarët e Rilindjes sonë Kombëtare, ishte njeri i mendimit dhe i vep-

rimit. Që nga viti 1872, kur filloi të shkruajë, dhe derisa vdiq, gjatë 32 vjetëve, Samiu botoi 6 vepra në gjuhën shqipe midis të cilave „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet”, mbi 60 vepra në gjuhën turke dhe arabe midis të cilave „Fjalorin e përgjithshëm të historisë e të gjeografisë” në 6 vëllime.

Në veprën në gjuhën shqipe ai nuk la pa prekur asnjë ide apo problem që kishte të bënte me lëvizjen çlirimtare shqiptare. Kurse në veprën në gjuhën turke gati nuk la fushë të diturisë pa prekur dhe pa thënë në secilën prej tyre një fjalë të mençur, një ide të re e përparimtare.

Pasuria e jashtëzakonshme e veprës së Samiut flet për talentin e tij, por dhe për intensitetin me të cilin ai ka punuar. Ai punoi me ngut, nxitonte të botonte, mbase, sepse e ndiente se nuk kishte shumë për të jetuar, apo sepse kishte shumë për të thënë apo, që na duket më afër të vërtetës, sepse Atdheu i tij Shqipëria dhe shoqëria në të cilën jetonte kishte plot probleme që kërkonin zgjidhje, bile zgjidhje urgjente.

A u t o r i

I. SAMI FRASHËRI — FIGURË QENDRORE E RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Sami Frashëri është një fenomen i shkëlqyer i kulturës sonë, një nga figurat më përfaqësuese të mendimit e të veprimit patriotik çlirimtar shqiptar. Me personalitetin e tij të fuqishëm, me veprën e tij të gjerë ai zuri një vend aq të rëndësishëm në Rilindjen Kombëtare Shqiptare sa që edhe sot nuk mund të kuptohet dhe të studiohet ajo drejt në tërësinë e saj pa iu drejtuar veprës, mendimeve dhe qëndrimeve të Samiut.


Në qoftë se edhe sot idetë dhe qëndrimet e Samiut ruajnë rolin e kriterit, kjo është prova më e mirë e drejtësisë dhe e saktësisë së tyre. Koha, ky gjykatës i rreptë dhe i paanshëm i punëve dhe i veprave të njerëzve, ruan dhe mbron vetëm ato ide e qëndrime që kanë shprehur interesat jetike të popullit dhe kanë ditur t'i tregojnë atij rrugën e lirisë, drejtësisë, progresit social në periudha të caktuara.

Samiu jetoi pak, gjithsej 54 vjet, që nga 1 qershori 1850, kur lindi në Frashër dhe deri më 18 qershor 1904, kur vdiq në Stamboll. Në rrugën e jetës së tij dallohen tre vendbanime, që koincidojnë dhe me tri etapa të formimit të tij: Frashëri, vendlindja, një fshat i madh në juglindje të Shqipërisë, Janina — qendër vilajeti dhe Stambolli — kryeqyteti i perandorisë Osmane.

Frashëri është feminija e Samiut, janë elementet e para të dijes, të marra në fshatin e lindjes, është dashuria për atdheun dhe popullin e vet që do të bëhet ndjenja e cila do ta mbajë të pushtuar për të gjithë jetën, ideja që do të mbizotërojë të gjithë botëkuptimin dhe veprimarinë e tij. Kur ishte femijë ai largohet nga Frashëri (pa e ditur se largohet për gjithnjë) dhe merr rrugën e Janinës, ku u vendos familja pas vdekjes së babait të tyre, Halid Frashërit.

Janina është rinia e Samiut, janë themelet e formimit të tij intelektual, një formim më tepër në frymën evropiane sa në atë turko-arabe, i marrë në gjimnazin „Zosimea” të qytetit, të cilin e mbaroi më 1871. Në autobiografinë e tij Samiu shprehet me entuziazëm për lëndët që mësoheshin në „Zosimea” dhe për metodat e mësimi që përdorëshin atje: „Ishte me 8 vjet, — shkruan Samiu, — e mbarova në 7 dhe mësova: greqishten, greqishten e vjetër, frengjishten, italishten, historinë, gjeografinë, shkencat matematike, kozmografinë, fizikën, kiminë, historinë e natyrës, anatominë.” Po t’u shtohen këtyre diturive njohja e gjuhëve turqisht dhe arabisht, mësimin e të cilave e kishte filluar qysh në fshat, po të kujtohen dhe notat „shumë mirë”, me të cilat janë vlerësuar dijet e tij në dëftesat e shkollës, që ruhen dhe sot atëherë kuptohet se ç’dije mori Samiu në të ri të tij, sa të mëdha ishin aftësitë e tij intelektuale.

Formimi arsimor nuk është i vetmi që mori Samiu në Janinë. Ai mori atje dhe një formim politik në thelbin e tij patriotik, liridashës, antiperandorak. Për disa arsye Janina e luajti këtë rol të shkollës politike. Së pari, me të kaluarën e saj historike jo të largët. Janina, si kryeqendër e pashallëkut të Ali Pashës, ishte simbol i rezistencës dhe i orvatjeve të një shqiptari për t’u shkëputur nga Porta e Lartë. Së dyti, me përbërjen e popullsisë së saj, Janina ishte një përzierje popullsisish shqiptare, greke, vllahe mbi të cilët qëndronte një zgjedhë e vetme, zgjedha osmane.



Shtëpia ku lindën vëllazërit Frashër

Janina ishte një prefiguracion i të gjitha atyre kontradiktave dhe problemeve që në një shkallë më të gjerë shqetësonin të gjitha vendet dhe popujt e Ballkanit dhe do të bëheshin shkak i ngjarjeve që do të zënë për vite të tëra paraskenën politike të tyre.

Stambolli është pjekuria e Samiut; është vendi e koha ku e kur ai do të zhytet në dallgët e jetës dhe do të pagëzohet në zjarrin e luftës politike, do të tregojë vlerën e bindjeve të tij dhe efikasitetin e veprimit të tij. Kur u largua nga Janina për në Stamboll

më 1872, me deftesën e pjekurisë në xhep, Samiu ishte 22-vjeçar. Periudha e përgatitjes për jetë kishte mbaruar dhe tani fillonte periudha kur Samiu „do të jentonte”, do të bënte zgjedhjet e jetës.

Stambolli, i propozonte Samiut të ri rrugë të ndryshme. Një rrug ishte ajo e karrierës zyrtare. Këtë kuptim kishte Stambolli për shumë feudalë shqiptarë që shkonin atje për t'i shitur sulltanit zotëri dhe nderin e tyre në shkëmbim të ofiqeve dhe të gradave. Një rrugë tjetër ishte ajo e shërbimit jo fronit të sulltanit por çështjes së popullit, jo të huajit, por atdheut të vet, jo shtypjes dhe reaksionit, por lirisë dhe progresit. Kjo nuk premtonte grada dhe ofiqe; mundimet dhe rreziqet ishin fati i pashmangshëm i kujtdu që merrte këtë rrugë. Samiu këtë do ta provonte shumë shpejt në familjen e vet. Abdyli, vëllai i tij më i madh, do ta paguante me burgim, bile gati dhe me kokë, pjesëmarrjen e tij në lëvizjen për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë gjatë ngjarjeve patriotike dhe çlirimtare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Me të mbëritur në Stamboll Samiu nuk priti shumë dhe nuk mendoi gjatë (mbase punën e kishte menduar qysh më parë dhe vendimin e kishte marrë qysh në Janinë), por u hodh i tëri në rrugën e nderit dhe të dinjitetit, në rrugën në shërbim të lirisë dhe të pavarësisë kombëtare të popullit të vet si dhe në atë të luftës kundër despotizmit dhe absolutizmit të sulltanit. Në këtë rrugë, nga e cila nuk e largoi asnjë peripeci dhe asnjë pengesë, Samiu u rrit e u bë një luftëtar dhe revolucionar i vendosur, një punëtor i mendjes që nuk e pat shoqin, një erudit që dhe sot i bën nder kulturës e shkencës sonë dhe asaj turke. Këtë vështirësi në zgjedhjen e rrugës së drejtë, këtë nevojë për ta ndjekur atë pa u lëkundur, në mënyrë konsekuente, e kishte kuptuar dhe ndierë më mirë se kushdo tjetër vetë Samiu. „Detyrat e njeriut, ka shkruar ai, janë të rënda. Prirjet e njerëzve ndaj të keqes dhe imoraliteti përbëjnë një moçal. Për

t'i dalë nbanë këtij moçali dhe për të arritur bregun duhet ndjekur rruga e drejtë, pa shikuar as majtas, as djathtas.(6)¹⁾

Zgjedhjes madhore që bëri Samiu në jetë, t'i kushtohet lirisë dhe pavarësisë kombëtare shqiptare, të përpiqet dhe të tregojë rrugën e progresit politik, ekonomik dhe kulturor të popujve, i përgjigjet gjithë publicistika, e gjithë vepra e tij letrare, gjithë krijimi i tij filozofiko-shkencor, gjithë bota e ideve filozofike, moralo-politike, organizative që ai përpunoi dhe propagandoi. Për këtë lidhje të ideve me interesat shoqërore kishte ndërgjegje të qartë dhe vetë Samiu kur shkruante „kurkush nuk i shërben një ideje, që të jetë në kundërshtim me interesat e tij” (740)²⁾.

Nuk mund të fitohet një ide e qartë e interesave politiko-sociale me të cilat u lidh Samiu në qoftë se nuk merren parasysh viti 1878 dhe gjithë ngjarjet që ndodhën atë vit dhe më vonë. Viti 1878 është viti i Paqes së Shën-Stefanit dhe i vendimeve të Fuqive të Mëdha në Kongresin e Berlinit, që i jepnin një konfiguracion të ri hartës së vendeve ballkanike kryesisht në dëm të territoreve shqiptare. Gjymtimi brutal që i bëhej territorit kombëtar shqiptar dha shkas për një lëvizje të menjëhershme rezistence e kryengritjesh nga ana e shqiptarëve, e paparë ndonjëherë më parë nga pikëpamja e gjerësisë dhe e pjesëmarrjes si dhe nga ajo e organizimit dhe e ideve që e frymëzuan.

Ndryshe nga rezistencat e mëparshme që përgjithësisht kishin pasur karakter spontan, rezistenca e viteve 1878-1881 kishte karakter të organizuar. Ajo drejtohej nga një qendër e vetme, nga Lidhja Shqip-

¹⁾ Citohet nga vepra e Samiut „Fjalët e uria”, përkthimi i të cilave ruhet në arkivin e Institutit të Historisë. Numri në kllapë i përgjigjet numrit që mban në origjinal çdo fjalë e urtë.

²⁾ *Po aty.*

tare e Prizrenit, që kishte komitetet e saj në të gjitha anët e atdheut. Ndryshe nga rezistencat e mëparshme që përgjithësisht kishin pasur karakter të ngushtë lokal, që shpërthenin herë në një krahinë dhe herë në një tjetër, në ndonjë rast edhe në disa kraheina përnjëherësh, rezistenca e viteve 1878-1881 kishte një shtrirje shumë të gjerë kombëtare. Vetë Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ishte një organizatë përfaqësuese në shkallë kombëtare. Ndryshe nga rezistenca e mëparshme që frymëzoheshin nga ide të kufizuara, rezistenca e viteve 1878-1881 frymëzohej nga një program më i qartë, nga ide më të gjera dhe më themelore siç ishte ajo e mbrojtjes së territorit kombëtar, e arritjes së autonomisë kombëtare, të cilën, në rrethanat e atëhershme, kur Perandoria Osmane shkonte në mënyrë të pashmangshme drejt greminës, një hap e ndante nga liria dhe pavarësia e plotë.

Ngjarjet e viteve 1878-1881 shënuan një kufi, me të cilin fillonte një etapë e re në lëvizjen çlirimtare shqiptare, që nga ana e saj u bë shkas për një hov të ri të mendimit çlirimtar shqiptar. Mendimtarët dhe patriotët e Rilindjes Kombëtare qysh në zjarrin e ngjarjeve të 1878 dhe më vonë gjatë 30-vjetëve të fundit të shekullit XIX e të fillimit të shekullit XX plotë ngut dhe zell iu përveshën punës për të përgjithësuar përvojën historike të këtyre ngjarjeve, për t'u dhënë përgjigje problemeve të shumta që ato kishin nxjerrë, për të zhdukur dobësitë dhe mungesat që ishin vërtetuar. Gjatë 30 e ca vjetëve në fushën e prodhimit mendor, qoftë si vëllim, qoftë si vlerë u bë më shumë se ç'ishte bërë gjatë disa shekujve më parë. Në të gjitha iniciativat patriotike dhe revolucionare, në atë të krijimit të alfabetit, të shkrimit dhe të botimit të librit shqip, të nxjerrjes së gazetave dhe të revistave, të çeljes së shkollës shqipe ndeshet vazhdimisht një emër, ngrihet mbi gjithë të tjerët një personalitet. Ky është emri i Sami Frashërit, i cili së bashku me

vëllezërit e tij Abdyl dhe Naim u bë epiqendra e lëvizjes çlirimtare shqiptare, e përpunimit të programit që e frymëzoi dhe e udhëhoqi.

Ishte një fat i madh për lëvizjen çlirimtare shqiptare që pati në krye një mendimtar dhe dijetar si Samiun, por në të njëjtën kohë ishte një fat po aq i madh për Samiun që jetoi në një situatë të tillë revolucionare, në atë gjendje hovi dhe ringjalljeje patriotike, e cila i dha krahë të fluturonte në lartësitë e mendimit të përparuar, i dha guxim të duronte mundimet e punës së lodhshme krijuese e të përballonte vështirësitë e luftës politike. Në një kuptim Samiu, ashtu si Naimi, ishte biri i ngjarjeve patriotike të 1878-1881.

II. „ZËDHËNËSI I LINDJES” — TRIBUNË E MBROJTJES SË INTERESAVE KOMBËTARE SHQIPTARE

Samiu vendoset në Stamboll më 1872 dhe menjëherë hyn në jetën letrare politike të kohës. Ai boton në turqisht romanin „Dashuria e Talatit me Fitneten” (1872)¹⁾. Me të marrë penden për të shkruar (të cilën nuk do ta lëshojë nga dora për më se 30 vjet), me të dalë para publikut lexues, Samiu e tregon veten si një shkrimtar me talent, si një krijues që nuk trembet të futet në rrugë të pashkelur dhe të krijojë në mënyrë të re për kulturën e kohës si nga brendia ashtu dhe nga forma.

Pas romanit Samiu kalon në dramën dhe boton një të tjetër brenda dy vjetëve tri pjesë: „Besa ose mbajtja e fjalës së dhënë”, (1875), „Zotëria Jahja” (1876), „Gave” (1876). Qysh në parathënien e dramës „Besa” me subjekt nga Shqipëria dhe me personazhe shqiptare, Samiu shpejton t’u thotë lexuesve dhe spektatorëve se autori është shqiptar dhe se qëllimi i tij është të vërë në pah vlerat e larta morale të

¹⁾ Të dhënat mbi veprat e Samiut në gjuhën turqisht janë marrë nga një bibliografi e përgatitur nga Zyber Baku, që ndodhet në Bibliotekën Kombëtare.

popullit shqiptar: „Qysh prej një kohe të gjatë s'më është ndarë nga mendja ideja për të shkruar një veperë letrare, për të vënë në pah disa zakone dhe moralin e kombit shqiptar, dhe kjo, jo sepse jam prej atij kombi, por sepse ai është shquar për besnikërinë, dashurinë për atdhe, shpirtin e sakrificës“¹⁾).

Jeta e Shqipërisë, fati i popullit shqiptar zinte një vend të rëndësishëm në planet krijuese të Samiut në këtë periudhë. Për këtë shkëmben mendime me të vëllanë, Tahsinin, të cilit më 5 shkurt 1876 i shkruan: „Mendoj të shkruaj dy romane të mëdha: njërin me titull „Bija e Skendos“ me temë nga ngjarjet në Shqipëri në kohën e Ali Pashës...“²⁾

Rrugën e filluar me kaq sukses në fushën e romanit dhe të dramës Samiu nuk do ta vazhdojë. Planet e tij krijuese letrare për të cilat i shkruan të vëllait, ai nuk do t'i realizojë. Ngjarjet do të rrokullisen në një mënyrë të tillë, lëvizja patriotike çlirimtare me të cilën ai do të lidhet do të marrë një hov aq të madh saqë do ta detyrojnë Samiun t'i kushtohet politikës, filozofisë e shkencës, ku ai do të japë vepra madhore si në shqip ashtu dhe në turqisht.

Pasioni politik në kuptimin më të mirë të fjalës, në kuptimin e përpjekjeve për t'i treguar popullit shqiptar dhe popujve të perandorisë rrugën e lirisë dhe të progresit, e shtyn Samiun drejt publicistikës. Brenda disa viteve ai bëhet bashkëpunëtor apo drejtues i disa gazetave dhe revistave njëra pas tjetrës si „Feneri“ (1873), „Kopshti“ (1878), „Mëngjesi“ (1876), „Zëdhënësi i Lindjes“ (1878), „Java“ (1881). Me „Mëngjesin“ Samiu shënoi një traditë të re në publicistikën turke — traditën e gazetës së përditshme. Se ç'energji i kanë kërkuar gazetatat që botonte, se ç'lodhje të madhe i kanë shkaktuar, e thotë Samiu

¹⁾ Sh. S a m i. „Besa“, Istanbul, 1292 (1875).

²⁾ Cìtohet sipas letrës që ruhet në arkivin e Institutit të Historisë.

30383

në një letër tjetër që i shkruante të vëllait, Tahsinit, më 11 shkurt 1876: „U mërzita nga gazetaria, pothuaj më vjen neveri. Këputesh nga mëngjesi deri në mbrëmje”.¹⁾ Por kërkesat për të botuar gazetë, dëshira për të shpallur publikisht fjalën e re lirisdashëse dhe patriotike ishin më të forta se lodhja. Samiu e vazhdoi rrugën e propagandës nëpërmjet gazetës për t'u ngritur në rrugë akoma më efektive, siç do të jetë botimi i teksteve shkollore në shqip, hartimi i veprave divulgative politiko-shkencore deri te Enciklopedia e tij e famshme.

Pa ulur vlerën e secilit prej organeve të shtypit që u përmendën dhe që japin një ide të evolucionit të Samiut, do të ndaleshim më me hollësi në përmbytjen e njerit prej tyre, „Zëdhënësit e Lindjes,” ku tema shqiptare trajtohet gjerë dhe qëndrimi patriotik i Samiut duket qartë.

Samiu mori drejtimin dhe përgjegjësinë e gazetës „Zëdhënësi i Lindjes” më 1878, në ditët kur po bëheshin të njohura vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit më 1878, që preknin rëndë territorin e popullit shqiptar. Gazeta pati një jetë të shkurtër. Nën drejtimin e Samiut u botuan rreth 100 numra që prej prillit deri në nëntor 1878, të cilët janë secili një dëshmi e shqetësimeve dhe e interesave të Samiut, e qëndrimeve të tij politike që konvergjojnë që të gjithë në një mbrojtje të vendosur të interesave të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar.

„Zëdhënësi i Lindjes”, ndonëse botohet në gjuhën turke, ndonëse është pronë e një tregtari armen, nën kujdesin dhe drejtimin e Samiut, bëhet organi legal i çështjes shqiptare, mbrojtës konsekuent i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe qëndrimeve të saj. Gazeta e Samiut bëri maksimumin e asaj që mund të bëhej për mbrojtjen e interesave të ligjshme shqip-

¹⁾ Citohet sipas letrës që ruhet në arkivin e Institutit të Historisë.

tare në kushtet e legalitetit, në kushtet e censurës së egër të kohës. Lajmet e botuara në gazetë, artikujt e dalë nga pena e Samiut i nënshtrohen një tendence të caktuar, i binden një logjike të vetme patriotike dhe revolucionare. Ato janë syri vigjilent i patriotit shiptar që ka marrë përsëri të ndriçojë mendjet, e shqiptarëve të zgjojë ndërgjegjen e tyre kombëtare, të mos i lërë ata të mashtrohen.

Samiu ndjek me vëmendje dhe boton veçanërisht lajmet që kanë të bëjnë me territorin shqiptar dhe ku duken synimet grabitqare të fuqive të mëdha dhe të monarkive shoviniste fqinje. Kështu p.sh. në numrin e 7 qershorit 1878 botohet lajmi „Njoftohet nga Selaniku se çetat grake e kanë shtuar aktivitetin e tyre në vilajetin e Manastirit, në rrethet e Korçës, Gurebenesë etj., duke nxitur për rebelizëm popullsinë e krishtere. Çetat janë shtuar shumë dhe janë pajisur me armë të reja”.¹⁾ Kurse në numrin e 17 qershorit 1878 botohej daklarata e qeverisë greke që kishte dalë në gazetën e Athinës: „Në qoftë se përfaqësuesit e Evropës, të cilët po shkojnë në Kongresin do të mendonin se do të mund të siguronin paqen në Lindje pa zmadhimin e Greqisë do të ishin të gabuar”. Këto lajme dhe të tjera si këto tingëllojnë si një dënim i lakmive të qarqeve shoviniste fqinje dhe i fuqive të mëdha që i përkrahnin dhe në të njëjtën kohë si një këmbanë që jepte alarmin dhe i zgjonte shqiptarët për rreziqet që u kanoseshin.

Personaliteti i Samiut si patriot dhe si demokrat, më tepër se në lajmet, duket në komentet dhe në kryeartikujt e gazetës, të shkruara prej tij. Më 24 qershor 1878 Samiu në një shënim të redaksisë në lidhje me një lajm të botuar në gazetën „Neologos”, organ i shovinistëve grekë, që në atë kohë bo-

¹⁾ Të gjitha pjesët e cituara nga gazetat janë nga përkthimi që ruhet në arkivin e Institutit të Historisë.

tohej në Stamboll, sipas të cilit „myslimanët shqiptarë të Janinës kërkojnë të krijojnë një principatë shqiptare, kurse shqiptarët e krishterë që kërkojnë bashkimin me Greqinë, po u kundërshtojnë”, Samiu jep këtë përgjegje duke treguar se si qëndron e vërteta: „... jo vetëm në Janinë, jo vetëm myslimanët, por edhe bashkatdhetarët të krishterë, që e duanë At-dheun dhe që nuk janë mashtruar nga propaganda e të huajve, janë mbledhur që të gjithë dhe kanë hartuar një peticion për t'ia paraqitur Portës së Lartë dhe fuqive të mëdha. Këto peticione nuk kanë për qëllim formimin e një principate shqiptare, por nisen nga qëllimi që të mos jepej asnjë pëllëmbë nga toka shqiptare, gjithashtu në këto peticione kërkohet që shqiptarët, duke qënë si dhe më parë nën Perandorinë Osmane, me qëllim që të luftoheshin më lehtë intrigmat e të huajve, të bashkoheshin nën një administratë të vetme, dmth. të krijohej një vilajet që të përmblihte të gjithë shqiptarët pa përjashtim. . . Është shpresë e madhe, — përfundon Samiu, — që fuqitë e mëdha të mos lejojnë copëtimin e Shqipërisë dhe se Porta e Lartë do të pranojë dhe do të vërë në jetë idenë e organizimit të Shqipërisë në një vilajet të vetëm”. Në këto radhë të botuara legalisht Samiu flet haptazi për një atdhe shqiptar, për Shqipërinë, merr në mbrojtje të drejtat e pamohueshme të shqiptarëve për trojet e tyre, del kundër përçarjes midis të kishërëve e myslimanëve që mbillnin shovinistët, bëhet flamurtar i bashkimit kombëtar pa dallim feje.

Në këto radhë sigurisht tërheq vëmendjen theksimi i Samiut që Shqipëria si dhe më parë do të jetë nën Perandorinë Osmane. Ky qëndrim i Samiut buron nga konsideratat e legalitetit. Të dilje haptazi me kërkesën e pavarësisë së plotë do të thoshte që gazeta të mbyllej që të nesërmen dhe drejtori i saj të mbaronte në burg. Por në këtë rast çështja nuk është te legaliteti. Ajo duhet parë më thellë. Duke kërkuar që shqiptarët pa përjashtim të bashkohen

nën një administratë më vete apo, siç i thoshin në atë kohë, nën një vilajet më vete, Samiu mbronte një nga kërkesat e autonomisë që përbënte platformën revolucionare dhe patriotike të lëvizjes çlirimtare shqiptare. Kjo do të qëndrojë në ballë të të gjitha kërkesave për autonomi që do të formohen qartë në memorandumun e 27.XI.1878 drejtuar Portës nga Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes që u mblodh në Prizren. Prandaj dhe detyra imediate ishte të ruhej territori kombëtar nga copëtimi dhe pretendimet e huaja, të mbetej ai i bashkuar për t'u bërë ballë më mirë këtyre pretendimeve. Përsa i përket tutelës së Perandorisë Osmane që pranon Samiu, nuk do të thotë se ai ashtu si gjithë lëvizja çlirimtare nuk e kuptonte rrezikun që përbënte perandoria për atdheun tonë, aq më pak nuk do të thotë se ai kishte hequr dorë nga nevoja e luftës për shkëputjen prej saj. Çështja është se patriotët e Rilindjes Kombëtare dhe në radhë të parë vetë Samiu (siç do të shprehet me qartësinë më të madhe në raste të ndryshme dhe veçanërisht në veprën e tij „Shqipëria ç'ka qenë...”) nuk ushqenin asnjë iluzion për Perandorinë Osmane dhe të ardhmen e saj. Shumë ngjarje, veçanërisht ato të vitit 1878, kishin nxjerrë në shesh gjithë kalbësirën e grumbulluar prej vitesh, kishin treguar me evidencën më të plotë se Perandoria Osmane e kishte jetuar kohën e saj, se ajo s'mund të mbahej më gjatë, se ishte bërë një i sëmurë për vdekje, pa shpresë shpëtimi. Përballë kësaj situatë gjëja e parë dhe me e rëndësishme ishte të ruhej territori i atdheut. Dhe pastaj, gradualisht me ngritjen e ndërgjegjës kombëtare, me rritjen e bashkimit dhe të organizimit të popullit shqiptar me zgjerimin e lëvizjes së tij çlirimtare do të formuloheshin dhe kërkesat e tjera të autonomisë politike për të kaluar në kërkesat e lirisë dhe të pavarësisë së plotë.

Përveç kërkesës për një vilajet më vete, Samiu do t'u bëjë jehonë dhe kërkesave të tjera të auto-

misë siç ishin ato që nëpunësit, që do të shërbenin në këtë vilajet të dinin shqip, që arsimi të përhapej në të gjitha anët dhe në shkollat të mësohej gjuha shqipe, që një pjesë e të ardhurave të vilajetit të përdorej në vend etj. Kështu qysh më 27 qershor 1878, Samiu del me kërkesën e përdorimit të gjuhës amtare shqipe.

Përgjegjet që u jep Samiu në gazetën e tij në numrin e 17 gushtit 1878 pretendimeve të kalemxhinjve të një gazete greke, „Neologos”, që botohej në Stamboll janë plot motive patriotizmi dhe demokratizmi, plot ndjenja të një njeriu që ka një ide të lartë të nderit kombëtar dhe të dinjitetit njerëzor. Artikullshkruesit të „Neologosit” që bën sulme personale kundër redaktorit përgjegjës të „Zëdhënësit të Lindjes” dhe në mënyrë fyese e quan „shumë fanatik, toskë dhe armik të grekëve” Samiu i jep një përgjegje lakonike dhe të qartë që s’le asnjë dyshim për ndjenjat, bindjet, personalitetin e tij. Epiteti „toskë, — shkruan Samiu, — për ne është një titull nderi dhe krenarie. Kombësia dhe atdheu janë të shenjta për çdo njeri”. Samiu e thotë si publicist atë që do ta thotë aq bukur si poet, vëllai i tij Naimi:

*„Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin
shqipëtar”.*

Me përgjegjën kundër fyerjes „fanatik” Samiu e tregon veten njeri me mendime të lira dhe të gjera, armik të çdo lloj fanatizmi. „Fjala fanatik, — përgjigjet Samiu, — është fjala më e rëndë e më fyese për njerëzit me mendime të lira, fjala më e rëndë në fjalorin e qytetërimit dhe të kulturës”. Për akuzën tjetër si „armik i grekëve” Samiu gjen rastin të tregojë edhe një herë qëndrimin dashamirës ndaj të tjerëve, veçanërisht ndaj fqinjëve, shenjë e pandashme e patriotizmit të vërtetë. „Është një sjellje e panjerëzishme, — thotë Samiu, — që të urresh dhe të jesh

armik i një populli të tërë prej 2-3 milionë vetësh". Në këtë plan arsyetimi Samiu nxjerr konkluzionin se ajo që ne vlerësojmë dhe këshillojmë më shumë është të lëmë mënjatë dallimet fetare dhe të bashkëjetojmë si vëllezër, sigurisht, siç e theksonte vazhdimisht, pa i rënë më qafë njëri-tjetrit. Në faqet e „Zëdhënësit të Lindjes” Samiu mbron dhe propagandon qëndrimin e drejtë, miqësor ndaj popujve fqinjë, të cilit i përmbaheshin gjithë patriotët e Rilindjes Kombëtare.

Arsyetimet dhe qëndrimet e Samiut në gazetën e tij „Zëdhënësi i Lindjes” janë plot optimizëm dhe besim në të ardhmen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Optimizmin dhe besimin Samiu i mbështeste në drejtësinë e çështjes për të cilën përpiqen shqiptarët si dhe në patriotizmin dhe në trimërinë e tyre: „...shqiptarët, — shkruan Samiu në numrin e 13 shtatorit 1878, — njihen për dashurinë e madhe që ata kanë ndaj atdheut, për sedrën e tyre kombëtare... për trimërinë e tyre të jashtëzakonshme, për guximin dhe zotësinë e tyre luftarake”.

Idetë dhe qëndrimet e Samiut në „Zëdhënësi i Lindjes” ishin ato të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të të gjithë lëvizjes çlirimare shqiptare. Ato ai do t'i mbrojë dhe do t'i zhvillojë në një varg artikujsh dhe veprash në gjuhën shqip. Për realizimin e tyre ai do të punojë pa u lodhur asnjëherë me atë mençuri, guxim dhe këmbëngulje që të pakët i kanë patur si ai.

III. LETRA DREJTUAR DE RADËS — DOKUMENT I PATRIOTIZMIT LUFTARAK

Do të kapërcejmë kohën për të arritur më 4 mars 1881, datë kur Samiu i drejton një letër në gjuhën shqipe patriotit të shquar arbëresh, De Radës. E bëjmë këtë kapërcim të shpejtë, sepse letra është një plotësim i atyre që shkruante dhe mbronte te „Zëdhënësi i Lindjes”. Duke mos qenë i kufizuar prej kërkesave dhe rregullave të imponuara nga botimi legal, Samiu atë që te „Zëdhënësi i Lindjes” e thoshte me gjysmë zëri, me nënkuptime dhe nëntekste, në letër do ta thotë hapur, do të bëjë, si të thuash, „profession de foi¹⁾”. Në letrën drejtuar De Radës duket qartë pozita e Samiut në lëvizjen çlirimtare shqiptare si udhëheqës e frymëzues i saj, shprehen hap-tazi idetë dhe qëndrimet e tij që koincidojnë me idetë dhe qëndrimet më përparimtare të lëvizjes çlirimtare të kohës.

Letra drejtuar De Radës vërteton ato që shkruanim pak më sipër dhe pikërisht se kur Samiu kërkonte krijimin e një vilajeti të vetëm shqiptar nën Perandorinë Osmane, siç bënte dhe e gjithë lëvizja

¹⁾ Fjalë frengjisht, që në mënyrë figurative do të thotë shpallje e hapët e bindjeve të veta.

çlirimtare shqiptare e asaj kohe, kjo në asnjë mënyrë nuk donte të thoshte se ai ushqente ndonjë iluzion për Perandorinë Osmane dhe për politikën e saj. Autonomia diktohej nga gjithë rrethanat e brendshme dhe të jashtme në të cilat populli ynë duhej të mbronte të drejtat dhe trojet e veta. Sa për iluzionet ato ishin zhdukur me kohë. Me një qartësi të rrallë, që nuk lejon as fijen më të vogël të dyshimit, Samiu shprehet për Perandorinë Osmane si për një forcë politike që nuk ka bërë asnjëherë asgjë të mirë për Shqipërinë, si për një pushtet reaksionar, nga i cili i kanë ardhur dhe i vijnë të gjitha të këqijat Shqipërisë dhe popullit shqipëtar. „... Turku, shkruan Samiu, nukë do zgjuarjenë e shqipëtarëve dhe lindjen e Shqipërisë përsëri, por do t'a ketë të fjeturë e të verbuarë¹⁾). Ai e njofton mikun e tij se shkëputja nga Perandoria duhet të jetë fundi logjik i të gjitha përpjekjeve dhe objektivi i të gjitha synimeve. „Lidhja e Prizrenit” — shkruan ai, — pa nevojë të bashkojë Shqipërinë e t'a bëjë me një otonomi, e mbase me shkëputje (indépendance²⁾) fare, pas punës”. Një qëndrim kaq i prerë i Samiut ndaj Perandorisë Osmane dhe politikës së saj ndaj Shqipërisë e ve në dukje më së miri pozitën e Samiut, tregon se nga ç'patriotizëm i lartë frymëzohej ai, ç'mendje realiste ishte ai në gjykimin e situatave.

Në letrën De Radës Samiu gjen rastin të shfrejë atë që e gufonte në zemër për Shqipërinë, për „mëmëdhethin e dashur” dhe t'i thotë një shokut të tij të luftës atë që bluante në mendje për shpëtimin apo, si shprehet ai vetë, „ për ngjalljen e Shqipërisë”. Letra është një dëshmi tjetër, krahas plot dëshmime të drejtpërdrejta e të tërthorta, se Samiu është në qen-

¹⁾ Citimet jepen në bazë të letrës origjinale, botuar në „Buletin për shkencat shoqërore”, viti 1945, Nr. 2.

²⁾ Fjalë frengjisht që do të thotë pavarësi.

dër të lëvizjes çlirimtare shqiptare, është promotori i luftës ideologjike e politike në të cilën ishte angazhuar i gjithë populli shqiptar në këto vite të rënda të jetës së tij.

Samiu i shkruan De Radës se mbretëri e turkut i vështron shqiptarët si armiqtë e saj për të treguar një realitet historik, dhe për më tepër, për të ardhur në idenë tjetër se shpëtimi i Shqipërisë është në vetë dorën e shqiptarëve, se atë që nuk mund ta presë nga turku duhet ta presë nga vetja. Kështu, i shpjegon Samiu mikut të tij të largët, Lidhja Shqiptare ka tre vjet që po kërkon bashkimin e Shqipërisë në një krahinë autonome. Atë që nuk e bëri mbretëria e mori ajo vetë përsipër ta bëjë, përzuri të gjithë guvernatorët turq nga vilajeti i Kosovës, u shndërrua vetë në një kuvernë të përdorme, krijoi një forcë të armatosur në mbrojtje të realizimeve dhe të kërkesave të saj. Samiu i linte të kuptonte mikut të tij se realizimet e Lidhjes ishin vetëm fillimi, se asgjë nuk ishte vendosur për fare, se situatat ishin në zhvillim, se në lojë ishin forcat të mëdha dhe se në këtë lojë, si në çdo lojë të madhe politike, fjalën vendimtare dhe të fundit e ka forca. Me intuitën e atdhetarit ai e ndiente këtë forcë në popullin shqiptar. Me sy të mprehtë ai e shihte atë të formohej dhe të rritej gjithandej. „Dhjetë mijë shqiptarë, — lajmëron Samiu, — kanë zënë Ysqypin, dhjetë mijë të tjerë bëhen gati të unjen në toskëri”. Si një sihariq, si një lajm të pritur prej kohe Samiu njofton se e gjithë puna shkon drejt kryengritjes, e cila së shpejti do të pushtojë gjithë Shqipërinë.

Besimi në ngritjen e madhe në Shqipëri „ishte aq i fuqishëm, bindja në fitoren e ardhshme ishte aq e patundur saqë Samiu shkon përpara në kohë dhe mendon se ç’do të bëhet në Shqipëri pas dëbimit me forcë të turkut, si do të qeveriset vendi, kush do të vijë në krye. Patriotizmi është i lidhur ngushtë te Samiu me demokratizimin. Si demokrat ai e përfyty-



Sami Frashëri

ron Shqipërinë e ardhshme të lirë si një vend pa mbretër dhe princër të çdo lloji mbi krye, si një vend që do të qeveriset nga „një farë dhimokratie prej pleqet”. Se ç’demokraci do të dilte në Shqipërinë e çliruar, kjo nuk do të ishte çështje dëshirash, por çështje raporti forcash, çështje marrëdhënie klasash. Por ajo që ka rëndësi të vihet në dukje në këtë rast nuk është kjo anë e problemit, por fakti se Samiu i kthen shpinën me vendosmëri idesë së një mbreti në krye të Shqipërisë në një kohë kur në krye të të gjitha shteteve të porsaformuara ballkanike kishin ardhur dinasti mbretërore, se ai drejton me vendosmëri sytë nga demokracia, formën e së cilës nuk kërkon ta marrë hua nga vendet e tjera, por mundohet ta gjejë në vetë popullin shqiptar, në vetë traditat e jetës së tij.

Në letrën dërguar De Radës Samiu merret me serioze, nuk mund të ishte çështje që zgjidhet lehtë dhe arrihet brenda një kohe të shkurtër. Ajo presupozonte patjetër disa premisa, në realizimin e të cilave kishte hyrë lëvizja çlirimtare shqiptare dhe të cilat i kishte kuptuar me qartësinë më të madhe Samiu dhe Naimi. Këto premisa, këto kërkesa që qëndronin në themel të lëvizjes së përgjithshme të çlirimit kombëtar ishin bashkimi i popullit shqiptar pa dallim krahine e feje dhe të shkruarit e gjuhës shqipe.

Në letrën dërguar De Radës Samiu merret me këto të dy argumente. Përsa i përket bashkimit të Shqipërisë dhe të shqiptarëve Samiu thotë se „Shqipëria duhet të jetë një dhe e pandarë”, se „... të gjithë shqiptarëtë duanë të quhenë vëllezër dhe djemt e një mëmëdhethi të dashurë”. Në këtë çështje Samiu i përmbahet qëndrimit të të gjithë Rilindjes Kombëtare, por sjell dhe disa elemente interesante, që ka rëndësi të vihen në dukje. Samiu ngul këmbë se ndarja e Shqipërisë sipas feve është një sajim i armiqve të Shqipërisë, një diçka artificiale që nuk pajtohet as me interesat e Shqipërisë, as me gjendjen reale.

Në fakt, vëren ai, Shqipëria nuk është e ndarë sipas feve dhe shqiptarët nuk janë gjithashtu më vete sipas feve. Dhe në qoftë se ka ndarje në fetë, vazhdon arsyetimin e tij Samiu, kjo është çështje ndërgjegjeje e secilit, dhe se ajo nuk duhet të përzihet me kombësinë. Në kishë dhe në xhami le të shkojë kush të dojë sipas besimit të vet, kurse kur është çështja për Shqipërinë të gjithë duhet të jenë të bashkuar si vëllezër, pa dallim feje. Edhe në këtë çështje patriotizmi i Samiut është i lidhur ngushtë me demokratizmin e tij. Njëlloj si iluministët më të shquar Samiu ngritet kundër fanatizmit, produkt i natyrshëm i çdo feje, bëhet mbrojtës i tolerancës fetare, i çlirimit nga kthesat e errësirës fetare.

Samiu nuk mjaftohet me tolerancën fetare dhe nuk ndalet atje. Ai shkon dhe më lart, hedh vështrimin e tij dhe në faktorë të tjerë që e kërkojnë dhe e bëjnë të mundur bashkimin. Këta faktorë janë historia dhe natyra. Historikisht, thotë Samiu, populli shqiptar ka qenë i bashkuar, shqiptarët kanë jetuar si vëllezër. I përçau pushtuesi. Prandaj duhet të jemi të bashkuar „sikundër kemi qënë qëmoti”. Përveç historisë dhe natyra, thotë Samiu, na ka bërë të bashkuar: Dikur ideologët e çlirimit të shoqërisë nga zgjedhja feudale në vend të ndryshme të Europës i drejtoheshin natyrës për të provuar karakterin e paligjshëm të privilegjeve feudale dhe të absolutizmit tiranik. Edhe Samiu i drejtohet natyrës jo për të provuar karakterin e paligjshëm të privilegjeve shoqërore (që në momentin e dhënë historik nuk ishte në plan të parë), por karakterin artificial të ndarjes fetare në emër të vëllazërimit dhe të bashkimit kombëtar. Duke iu drejtuar natyrës për të nxjerrë argumente për çështjet politike që e interesonin Samiun tregon se sa pak e çmonte fenë dhe dogmat e saj. Por në të njëjtën kohë me këtë ai njëlloj si iluministët evropianë të shekullit të XVIII tregonte se sa larg ishte nga kuptimi i thelbit të vërtetë të njeriut, i faktorëve

realë që kushtëzojnë ngjarjet shoqërore dhe përcaktojnë procesin historik.

Në qoftë se premisa e parë e luftës me sukses për çlirimin e Shqipërisë ishte bashkimi politik i popullit shqiptar, premisa e dytë ishte të shkruarit e gjuhës shqipe, përhapja e dritave të arsimit në popullin shqiptar ose, po t'ia lëmë fjalën vetë Samiut, „të gjallurët e gjuhës shqip, dhe, lidhur me këtë, të ndrituarët e kombit tonë”. Të shkruarit e gjuhës shqipe, më tepër se premisë ishte hallkë kryesore dhe shumë e përshtatshme për realizimin e bashkimit politik dhe edukimit ideologjik të popullit shqiptar.

Duke e parë me syrin e patriotit, Samiu ngrinte lart vlerën e gjuhës shqipe si shenja më e sigurt e identitetit kombëtar të shqiptarëve, si mjeti më i mirë i afirmimit të tyre si komb më vete dhe i bashkimit të tyre politik. „Një gjuhë shqipe e pandame dhe e njëjtë”, i shkruante Samiu De Radës, sepse „shumë gjuhë dhe dialekte sjellinë ndarje e mërgim”. Duke e parë me syrin e iluministit dhe të demokratit Samiu ngrinte lart vlerën e gjuhës shqipe si një mjet i pazëvendësueshëm arsimit dhe kulture për popullin shqiptar.

Në personin e Samiut patriotit i vjen në ndihmë linguisti. Samiu ishte patriot i madh dhe linguist i shquar. Samiu shtron para kulturës shqipe dhe lëvizjes çlirimtare shqiptare detyrën e krijimit të një gjuhe të përbashkët shqipe, që të kapërcejë ndarjet dialektore dhe në të njëjtën kohë tregon rrugët e realizimit të këtij procesi, i cili në kushtet e mbizotërimit të dialekteve në gjuhën shqipe të atëhershme, nuk ishte i lehtë dhe i thjeshtë. Samiu ka një vizion të gjerë të problemit. Ai nuk do të humbë asgjë nga pasuria e gjuhës shqipe. Gjuha shqipe për Samiun është gjuha e të gjithë shqiptarëve, ngado që janë shpërndarë dhe kudo që jetojnë: në Shqipëri, në kolonitë, në Gegëri, në Toskëri dhe në çdo ngastër tjetër. Gjuha e përbashkët shqipe do të dalë nga gjuha e të gjithë shqiptarëve. Samiu nuk ka preferencë

për asnjë dialekt apo nëndialekt. Krijimin e gjuhës shqipe ai ia le procesit të natyrshëm. Në këtë proces dialektet dhe nëndialektet e ndryshme do të bashkohen, do të përzihen, si të thuash, do të konkurojnë dhe në jetë, çdo fjalë, çdo rregull gramatikor dhe sintaktik do të tregojë gjallërinë dhe vlerën e tij.

Samiu i paralajmëron një të ardhme të ndritur gjuhës shqipe. Ajo do të qëndrojë e barabartë përkrah gjuhëve të popujve të tjerë dhe do të mos ua ketë aspak nevojën atyre. „Gjuha shqipe, — i shkruan Samiu De Radës, — do të bëhet e begatë, e gjërë e do të shpëtonjë nga të pasurit nevojë me fjalë të huaja dhe gjithë dialektetë do të gjenden të gjitha të bashkuara e të përzjera”. Nuk do të kalonte shumë kohë dhe Naimi, ashtu si kishte paralajmëruar dhe e dëshironte Samiu, me krijimin e tij artistik do të nxirrte në shesh gjithë bukurinë, pasurinë dhe fuqinë e gjuhës shqipe, do ta ngrinte atë nga dialektet e veçanta për ta futur në rrugën e një gjuhe të vetme letrare shqipe.

Letrën De Radës Samiu e firmos poshtë me emrin e tij të plotë shqip Sami Frashëri dhe jo Shemsettin Sami, siç i firmoste shkrimet e tij në gjuhën turke. Kjo është plot kuptim. Samiu i drejtohej De Radës si shqiptari shqiptarit.

Letra nuk ishte një letërkëmbim i thjeshtë midis miqsh, por një mjet me të cilin atdhetarë dhe revolucionarë komunikojnë njëri me tjetrin, besojnë për problemet më jetësore të lëvizjes çlirimtare, për hallet më të mëdha të kombit. Në letër Jani Vretoja, i shkruan De Radës me dorë të tij: „Edhe unë J. Vretua u përshëndosh dhe përqafoj vëllazërisht”. Samiu flet për Abdyl Frashërin dhe e njofton De Radën se është i zënë i gjithi, nat'e ditë, me punët e Lidhjes shqiptare të Prizrenit, prandaj s'ka pasur kohë t'i shkruajë letër. Në fund të letrës Samiu bën shtesën: „Të dërgonj edhe një këngë (patriotique) të vëllajt tonë Pashko Vasësë...”. Fjala me siguri është

për vjershën aq të ndjerë, aq frymëzuese të Pashko Vasës „O mori Shqipëri, e mjera Shqipëri”, shkruar më 1879 dhe që ishte përhapur me të shpejtë e këndoj gjithandej, kudo ku ëndërrohej dhe luftohej për liri dhe Shqipëri.

Vretoja e përqafton De Radën e largët *vëllazërisht*. Samiu, mysliman nga jugu, e thërret Pashko Vasën, katolik nga veriu, *vëlla*. Dallimet krahinore dhe dasitë fetare në ato kohë diçka donin të thoshin dhe nuk mund të mos merreshin parasysht. Në qoftë se me gjithë këto, bile në kundërshtim me këto, patriotët e shquar të Rilindjes sonë Kombëtare e quanin njëri-tjetrin *vëlla*, kjo donte të thoshte se midis tyre kishte lindur dhe vepronte një solidaritet i ri, shumë më i fuqishëm nga dasitë fetare, një solidaritet i frymëzuar nga dashuria për atdhe, nga lufta për çështjen e përbashkët të çlirimit të Shqipërisë.

Problemet që trajtohen, mënyra sesi zgjidhen si dhe gjithë fryma që e përshkon nga fillimi në fund e bëjnë letrën e Samiut dërguar De Radës një dëshmi të rëndësishme të ndjenjave dhe mendimeve liri-dashëse dhe patriotike të autorit të saj.

IV. NË KRYE TË „SHOQËRISË SË SHKRONJËZAVE” TË STAMBOLLIT

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe gjithë ngjarjet e mëdha e të vogla që ndodhën nën udhëheqjen dhe frymëzimin e saj u bënë një provë e vështirë për lëvizjen çlirimtare shqiptare. Mësimet që nxorën patriotët e Rilindjes ishin të mëdha dhe të rëndësishme. Mësimi i parë ishte se shqiptarët nuk e kishin humbur asnjëherë identitetin e tyre, se ata kishin një ndërgjegje të qartë të të drejtave dhe interesave të tyre si popull dhe komb më vete. Mësimi i dytë ishte se populli shqiptar është një popull plot vitalitet, i gatshëm dhe i aftë të mbrojë interesat kombëtare dhe të fitojë të drejtat e tij.

Por qysh gjatë ditëve të zjarra të vitit 1878 dhe më vonë u dukën dhe dobësitë, lindën dhe problemet. U pa qartë se problemet ishin aq të shumta saqë nuk zgjidheshin me një të goditur; vështirësitë ishin aq të mëdha saqë nuk kapërceheshin menjëherë. Ato kërkonin një bashkim më të madh, një organizim më të fuqishëm, një ndërgjegje më të lartë, një program strategjik dhe taktik më të përpunuar. Në përpjekjet për të bërë bashkimin dhe organizimin e popullit, për t'i dhënë atij një ndërgjegje kombëtare, për t'i treguar rrugën e drejtë të luftës dhe të fitores dolën dhe u formuan shumë personalitete të shquara, në

në ballë të të cilëve, për hovin dhe mençurinë e tyre, u vunë Abdyli, Samiu dhe Naim Frashëri.

Qysh prej ngjarjeve të 1878-ës Samiu nuk nje pushim. Krahas mbrojtjes së mençur dhe të vendosur që i bën çështjes shqiptare në faqet e gazetës „Zëdhënësi i Lindjes”, Samiu merr pjesë në „Komitetin Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare”, i formuar në Stamboll më 1877, bëhet shpirti i të gjitha kërkesave dhe iniciativave të tij patriotike dhe çlirimtare. Pasoja më konkrete dhe më e rëndësishme e udhëzimeve dhe iniciativave të tij ishte krijimi më 1879 në Stamboll i „Shoqërisë të të shtypurit shkronja shqip”, apo, siç u quajt më thjesht, „Shoqërisë së shkronjzave”, qëllimi i së cilës do të ishte përhapja e arsimit dhe e diturisë në gjuhën shqipe me anën e librit, gazetës, shkollës. „Shoqëria e shkronjzave” ku merrnin pjesë apo u aktivizuan për punët e saj njerëz si Sami Frashëri, Hoxhë Hasan Tahsini, Pashko Vasa, Jani Vreto e të tjerë ishte një bashkim patriotësh të lidhur nga ideali i përbashkët si ta shpëtonin Shqipërinë dhe ta nxirrnin atë në dritë, të frymëzuar nga parimet më demokratike. Në bazë të rregullores së Shoqërisë të gjithë anëtarët ishin të barabartë, shokë e vëllezër, kurse drejtuesit zgjidheshin me vota të fshehta, jepnin llogari herë pas here për punë që bënin dhe mund të revokoheshin menjëherë në qoftë se për një arsye apo për një tjetër e humbnin besimin.

„Shoqëria e shkronjzave” në të njëjtën kohë ishte një klub i vërtetë dijetarësh e shkrimtarësh, njëri më me talent se tjetri. Hoxhë Tahsini, nga fshati Ninat i Konispolit, rektori i parë i Universitetit të Stambollit, ishte një dijetar i gjithanshëm në fusha të ndryshme të shkencave natyrore si në astronomi, në matematikë etj. Pashko Vasa, nga Shkodra, diplomat dhe burrë shteti i shquar ishte një shkrimtar dhe historian i zakonshëm, autor i një vëllimi me kujtime në italisht „Burgu i im”, i një vëllimi me poezi

në italisht „Trëndafila dhe gjemba”, i një romani në frengjisht „Bardha e Temalit” me subjekt shqiptar, i margaritarit të poezisë shqipe të shekullit XIX „Mori Shqypni e mjera Shqypni”, i veprës historiko-politike frengjisht „E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”. Jani Vreto, nga Postenani i Leskovikut, publicist dhe orator, do të bëhet autori i një varg studimesh filozofike dhe etike. Në krye të kësaj shoqate patriotësh dhe dijetarësh u zgjodh Sami Frashëri, më i riu në moshë, por me siguri më i denji ndër të barabartët nga zjarri i patriotizmit dhe nga gjerësia e diturisë, autori i ardhshëm i një numri të madh veprash letrare, politike, filozofike dhe shkencore në shqip, në turqisht, në arabisht

Patriotët dhe dijetarët e Shoqëris së Stambollit kishin prirjet dhe interesat e tyre të veçanta shkencore dhe letrare. Por ata në çdo rast u treguan të gatshëm t'i linin ato mënjanë dhe t'i përvisheshin bashkarisht punës për të nxjerrë atë që kërkonte shpëtimi i Shqipërisë, apo për të cilën kishte nevojë çështja shqiptare. Kështu detyrë urgjente e kohës ishte shkrimi i gjuhës shqipe dhe krijimi i vlerës së shkrimit të saj, alfabetit. Të gjithë, së bashku, Sami Frashëri, Hoxhë Tahsini, Pashko Vaso, Jani Vretoja provuan forcat në këtë punë dhe propozuan secili një alfabet më vete. Më i miri dhe më i përshtatshmi u gjend alfabeti i Samiut. Me të do të shkruhen dhe do të botohen veprat që do të përbëjnë pasurinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Të gjithë së bashku më 1879 krijuan abetaren e gjuhës shqipe, Alfabetaren e famshme të Stambollit. As më parë nuk ka pasur, as më vonë nuk do të ketë një abetare të gjuhës shqipe që të jetë shkruar nga një grup dijetarësh kaq të shquar dhe kaq entuziastë! Për rëndësinë e madhe që kishte krijimi i alfabetit dhe shkrimi i gjuhës shqipe Samiu ishte më se i ndërgjegjshëm. Në artikullin „Gjuha Shqip” të botuar në abetaren e Stambollit Samiu shkruante: „Kombetë mahenë me gjuhëtë; një


komb që humbet gjuhënë e vet, është i humbur e i haruarë; që me të humburit e gjuhës së tij është i humburë dhe ay vetë". Dhe më poshtë: „Sot është dita që edhe shqiptarëtë të zenë e të shkruanj' e të këndojnë gjuhën' e tyre, që të mundinë të ruajnë kombësinë".¹⁾

Samiu, si organizatori dhe drejtuesi i „Shoqërisë së shkronjézave”, punoi plot zell dhe konsekuencë për të vënë në jetë vendimet dhe orientimet e saj. Përveç alfabetit duheshin krijuar shkolla kombëtare shqipe dhe tekstet me të cilat ato do të punonin dhe do të mësonin. Samiu i përvishet punës dhe shkruan njëri pas tjetrit tekste themelore të shkollës si abetarja apo siç e ka quajtur ai „Abetare e gjuhës shqip” (1886), gramatika apo „Shpronjëtoare e gjuhës shqipe” (1886), gjeografia apo „Dheshkronja” (1888).

Tekstet e Samiut janë një shembull thjeshtësie, saktësie shkencore dhe, mbi të gjitha, tendencioziteti patriotik.

Hartimin e teksteve për shkollën e re kombëtare shqipe Samiu e quante një gjë shumë serioze. Me gjithëse tekstet hartoheshin për herë të parë, ai kërkonte që ato të ishin të një niveli të lartë shkencor dhe patriotik, siç e jepte vetë shembullin, dhe bile, të botoheshin sa më pastër dhe pa gabime. Kur më 1886 filluan të dilnin tekstet dhe botimet shqip, të shtypur në Bukuresht, dhe kur në ndonjërin prej tyre ishin lejuar gabime shtypi, Samiu menjëherë plot preokupacion i shkruan Jani Vretos: „Nuk' e marrim dot vesh pse të mos n'a dërgohen një herë ndërtimet (korekturat)? Për se kaqe nxitim? Apo thoni që të dalë puna çpejt në shesh, që të mos kenë ç'të thonë të prapët? Po mua më duket që atë herë ata do të përiqen më tepër se qëllimi i tyre është të mos bëhet

¹⁾ „Alfabetare e gjuhës shqip”, Konstantinopojë, 1879, f. 27, 29.



Sami Frashëri i dha, si dhe Naim Frashëri, tekstet e para mësimore, shkollës kombëtare shqiptare

punë, dhe po të jenë vivlatë plot me lajthime, athere do të gjejnë më tepër ç'të thonë".¹⁾

Duhej krijuar shkolla kombëtare shqipe. Ajo filloi me shkollën e parë shqipe në Korçë më 1887. Shkolla e parë kombëtare shqipe u çel me iniciativën dhe përpjekjet e Samiut, Naimit, Vretos, punoi me tekstet e tyre, u mbajt gjallë dhe u konsolidua me përpjekjet dhe ndihmën e tyre. „Në Korçë mësonjtorja po vete mbroth”, i shkruanin plot shpresë e gëzim Samiu dhe Naim Frashëri patriotit Visar Dodani në Rumani më 16.V.1887. Dhe vazdonin: „Shokë e ndihmës për shoqërit'e atjeshme mund të bëhen edhe në Korçë, edhe këtu si dhe n'Egjyptë e gjetkë. Shoqëria e Bukureshtit është nevojë të jetë e pare-

¹⁾ D o d a n i, „Memoriet e mia”, Konstancë, 1930, f.33.

shturë, fletore ka edhe më gati, të tjera po bëhen, andaj shtypshkronja të mos mbyllet kurrë, po të jetë hapur gjithnjë, se kjo do t'a bëjë shqiptarë të mbaruarë".¹⁾ Edhe nga këto radhë duket se me ç'interes Samiu dhe Naimi ndiqnin gjithçka bëhej për Shqipërinë, sesa kujdes e kishin të jepnin udhëzimet e duhura, ta nxisnin lëvizjen çlirimtare dhe pjesëmarrësit e saj për të shkuar gjithnjë përpara në rrugën e drejtë.

Duhej krijuar te shqiptarët një botëkuptim i drejtë, që do t'i ndihmonte të kuptonin nevojën e shkrimit të gjuhës shqipe, rëndësinë e arsimit dhe të diturisë, vlerën e lirisë dhe të atdhedashurisë. Idetë themelore të botëkuptimit patriotik dhe revolucionar që i duheshin atëherë popullit tonë i përpunon dhe i shpall Samiu në një varg artikujsh dhe veprash të shkruara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turqisht. Me to Samiu bëhet një figurë qëndrore që sundon gjithë kulturën përparimtare shqiptare dhe turke të kohës.

Duhej, më në fund, hartuar një program i qartë i shpëtimit, çlirimit dhe përparimit të Shqipërisë, duhej përpunuar një strategji dhe një taktikë që të merrte parasysh raportin e forcave, të orientohej në bazë të kushteve historike për ta çuar lëvizjen çlirimtare shqiptare në fitoren e saj. Sesa shumë i ka punuar mendja Samiut dhe për këto probleme të rëndësishme dhe se ç'zgjidhje të drejtë ai u ka dhënë atyre u duk qysh në faqet e gazetës „Zëdhënësi i Lindjes” si dhe në letrën dërguar De Radës. Qysh atëherë dhe vazhdimisht ai i ka bluar këto probleme e detyra në mendje, i ka ballafaquar më përvojën çlirimtare të popullit tonë dhe të popujve të tjerë, i ka pleqëruar dhe bashkërenduar me shokët e bashkëluftëtarët e tij dhe i ka dhënë të gjitha në një trajtë të plotë dhe të argumentuar në kryeveprën e tij në

¹⁾ V. Dodani, „Memoriet e mia”, f. 46-47.


gjuhën shqipe „Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë” (1899). Me idetë e saj do të jetojë dhe do të zhvillohet lëvizja çlirimtare shqiptare për të arritur në fitore, në lirinë dhe pavarësinë kombëtare më 1912.

V. PROPAGANDISTI I FLAKTË I DITURISË DHE I PËRPARIMIT

Kemi nevojë për një fletore në gjuhën shqipe. i shkruante Samiu De Radës më 1881. Një detyrë të këtillë i kishte shtruar vetes dhe „Shoqëria e shkronjzave” e Stambollit. Shumë shpejt dhe kjo detyrë u zgjidh. Si të gjitha detyrat e tjera të rëndësishme të lëvizjes kulturore çlirimtare shqiptare edhe kjo u zgjidh me iniciativën e Samiut e të Naimit dhe me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë. Më 1884 filloi të dalë në Stamboll një gazetë shqip me emrin „Drita” dhe më vonë me emrin „Dituria” që do të vazhdojë deri më 1885. Si nga artikujt e botuar ashtu dhe nga orientimi i përgjithshëm kjo gazetë mund të quhet gazeta e Samiut dhe e Naimit si dhe e shokut e bashkëpunëtorit të tyre të ngushtë Vretos.

Titujt e gazetës „Drita” dhe pastaj „Dituria” janë kuptimplotë. Me to Samiu dhe Naimi jepnin edhe qëllimin e gazetës: të përhapte dritën e diturisë në gjuhën shqipe për popullin shqiptar. Këtij qëllimi i bën jehonë Samiu në një varg artikujsh¹⁾ të shkruar

¹⁾ Artikujt e Samiut janë këto: „Dituria”, „Qytetëria”, „Qytetëri e grekëvevet”, „Qytetari e arabëvevet”, „Qytetëri e evropjanëvevet”, të botuar respektivisht në Nr. 1, 2, 3, te „Drita” dhe në Nr. 6, 8 te „Dituria”.



Tekste mësimore që i përgatiti Sami Frashëri

në një temë të vetme — në temën e diturisë, të origjinës dhe të zhvillimit të saj, të vendit dhe të rolit të saj në jetën e njeriut dhe në zhvillimin e shoqërisë. Me artikujt e tij Samiu do të përpiqej të jepte platformën filozofike të të gjithë veprimtarisë praktike të lëvizjes çlirimtare shqiptare për përhapjen e arsimit dhe të kulturës në gjuhën shqipe. Ata ishin jo vetëm të parët, por edhe më të mirët që u shkruan në këtë kohë, në gjuhën shqipe, për këto probleme, si nga përmbajtja, si nga stili, si nga gjuha.

Një nga plagët e rënda që kishte shkaktuar puschtimi Osman në trupin e kombit ishte padituria dhe prapambetja. Këto ndiheshin akoma më shumë në sfondin e progresit të dijeve dhe të shkencave, të vërtetuara në Evropë që nga shekujt e Rilindjes e këtej si dhe në sfondin e detyrave të reja që kishte nxjerrë në plan të parë lëvizja çlirimtare shqiptare.

Lëvizja çlirimtare për të përballuar pengesat e mëdha dhe të shumta që i dilnin çdo hap dhe për

të shkuar përpara drejt objektivave të caktuara duhej të ruante dhe të ngrinte lart gjuhën shqipe, duhej të përpunonte dhe të përhapte në masat ndërgjegjen kombëtare. Por si gjuha shqipe ashtu dhe ndërgjegjja kombëtare të nxjerrin në mënyrë të natyrshme në diturinë dhe kulturën. Gjuha shqipe do të ruhej dhe do të përparonte në qoftë se do të shkruhej, në qoftë se para saj do të ishte një dituri dhe një kulturë. Ndërgjegjja kombëtare do të formohej dhe do të konsolidohej në qoftë se do të mbështetej në një dituri dhe kulturë sa më të gjerë e përparimtare në gjuhën shqipe. Në të kundërtën, antagonistët e diturisë, injoranca dhe feja, forcat reaksionare feudale, klerikale bënë punën e tyre, punën e armiqve të kombit dhe të çlirimit kombëtar.

Në artikujt e tij Samiu merr përsipër të shpjegojë se ç'vend ze dituria në jetën e njeriut dhe në veprimtarinë shoqërore; ai futet në një varg arsytimesh për të treguar vlerën e saj. Në pëpjekjet për të gjetur thelbin e njeriut dhe dallimin e tij nga gjithë bota tjetër e qenieve të gjalla disa mendimtarë epërsinë ia kanë dhënë aftësisë për të jetuar në shoqëri, disa të tjerë aftësisë për të menduar dhe për të grumbulluar dituri, disa të tretë aftësitë për të vepruar. Samiu, si mendimtar i lidhur me mendimin antifeudal dhe iluminist i përmbahet pikëpamjes mbi njeriun si një qenie e pajisur me arsye, nga e cila ai merr të gjitha atributet njerëzore dhe që e dallon dhe e ngre atë mbi të gjithë botën e kafshëve. „Dituria, — thotë Samiu, — është ajo që e bën njeriun të quhet njeri dhe të shquhet nga kafshët e tjera”.¹⁾ Kredon e tij iluministe Samiu e kishte përpunuar disa vjet më parë, e kishte shpallur në gazetatat që drejtonte si dhe në veprëzat divulgative që botonte

¹⁾ Të gjitha citimet janë nxjerrë nga revistat „Drita” dhe „Dituria”, botuar në Stamboll më 1884-1885.

në gjuhën turke. Qysh në studimin e tij „Gratë” Samiu shkruante: „Në botë shkaku kryesor i të gjithë të këqijave dhe gabimeve është padituria”.

Me të zbuluar vlerën e diturisë, Samiu shkon më tej dhe shtron problemin e origjinës së diturisë, shpjegon se ç’duhet të bëjë njeriu për të fituar mësim e dituri. Për Samiun dituria është një tërësi që rritet dhe zhvillohet me përpjekjet jo të një njeriu, por të të gjithë brezave, prandaj për të fituar dituri njeriu ka nevojë për njerëzit e tjerë, për të gjithë shoqërinë. Po qe se njeriu kufizohet vetëm me atë që arrin vetë të mësojë dhe të zbulojë, ky mësim do të jetë shumë i pakët. „Sado mënt të tepërë të ketë njeriu nuk munt kurrë të dijë prej vetiu të gjithë të vërtetat dhe gjithë ç’i duhet të dijë as me të dëgjuar e me të parë mund të bëhetë njeri i ditur, as dhe me të vuarë, se jet’e njeriut është e pakë”. Së këndejmi dhe konkluzioni që nxjerr Samiu: dituria është mësim d.m.th. është një diçka që merret prej të tjerëve.

Krahas diturisë që njeriu merr nga të tjerët Samiu vë në dukje dhe diturinë që ai fiton vetë, që e nxjerr nga vëzhgimet e drejtpërdrejta dhe përvoja personale. Midis këtyre dy diturive dhe mësimëve Samiu zbulon një raport të caktuar, që është dhe kriteri për të përcaktuar shkallën e zhvillimit të një njeriu dhe të një shoqërie. Kur njeriu kufizohet me ato dituri që ka fituar vetë nga përvoja e tij personale dhe me këto manovron për të jetuar dhe punuar, kjo është shenja më e sigurt se ky njeri ka një bagazh të vogël diturish, kurse shoqëria që kënaqet me një njeri të tillë ndodhet në një shkallë më të ulët zhvillimi. Për ta bërë më të qartë mendimin e tij Samiu kujton fjalën e urtë „Mos pyet të mësuarin’ por të vuarin”, të cilës i jep një shpjegim interesant. Kjo fjalë e urtë, shpjegon Samiu, na ka ardhur nga kohët e vjetra. Atëherë kjo ishte e drejtë. Shkalla e zhvillimit të shoqërisë ishte aq e ulët, kërkesat e saj aq të pakta saqë njeriut i mjaftonin dhe ato që kish-

te mësuar nga përvoja e tij, nga të vuarët e tij. Kurse në ditët tona, vazhdon Samiu, kjo nuk është e vërtetë. Dituria është pasuruar aq shumë, shoqëria ka shkuar aq përpara saqë vetëm me atë bagazh që mund të kesh grumbulluar vetë nuk bën dot. Ai duhet plotësuar me diturinë që kanë arritur të tjerët, apo që e kanë lënë brezat e mëparshëm, d.m.th. duhet mësuar. Vërejtja e Samiut kap drejt tendencën reale; me të Samiu u del përpara kohëve që po vinin, kur grumbullimi i diturive do të bëhet me ritme aq të përshpejtuara saqë asnjë njeri, qoftë ky dhe gjenial, nuk mund të bëhet i mësuar në kuptimin bashkohor të fjalës pa u mbështetur në thesarin e diturive të grumbulluara nga e gjithë shoqëria.

Me interpretimin që i jep fjalës së urtë „mos pyet të mësuarin, por të vuarin” Samiu kërkon të vërë në dukje raportin midis dijes së fituar nga përvoja personale dhe asaj të fituar nga shoqëria për të argumentuar dhe propaganduar atë detyrë të rëndësishme që shtronte momenti aktual në atë kohë siç ishte përhapja e arsimit në gjuhën hqipe. Por fjala e urtë ka në vetvete dhe një interpretim tjetër që i afrohet më tepër të vërtetës. Në të populli ka vënë atë konkluzion që ka nxjerrë nga përvoja e tij shumëshkollë se midis diturisë së marrë nga libri a shkolla, nga të mësuarët, dhe asaj të nxjerrë nga praktika e jeta, nga të vuarët, epërsinë e ka dituria e praktikës, dituria e jetës. Atë që ka vuar njeriu në jetë, atë që ka provuar në shpinën e tij është vështirë ta harrojë dhe të mos e marrë parasysh. „Mos pyet të mësuarin, por të vuarin”, është vlerësimi i këtij burimi të pazëvendësueshëm diturie që është jeta, praktika.

Samiu i rreh mendja dhe në këtë anë të problemit. Duke ngritur lart mësimin ai ka ditur të vërë në dukje dhe rolin e praktikës, të kuptojë vendin e rëndësishëm që ajo ka zënë dhe zë në diturinë njerëzore. „Gjithë ç’mësohet sot, — thekson Samiu, —

është shkruar jo vetëm nga njerëz të diturë, por edhe të vuarë". Të vuarët, praktikën Samiu e sheh në një kuptim shumë të gjerë, në kuptimin se ajo që sot është mësuar për një njeri apo për një brez ka qenë dje përvojë për njeriun apo brezin e mëparshëm. Duke ndjekur këtë arsyetim arrihet në përvojën, në praktikën si burimi primar i çdo diturie. Këtë e thotë Samiu në një mënyrë origjinale: „Sot nuk ka njeri m'i vuarë se i mësuari, se ay di vetëm çka vuarë vetë, por dhe ç'kanë vuarë mijëra njerëz para tij”.

Nuk mund të flitet për diturinë, pa folur për fenë, e cila në kohën dhe ambientin ku jetonte Samiu, kishte pretendimin se mbante në dorë të vërtetën dhe kishte monopolin e mësimi që jepej në shkollat e Perandorisë Osmane. Edhe Samiu e merr parasysh fenë, por e merr për ta përjashtuar atë nga dituria. Duke ecur në traditat më të mira të iluminizmit, duke hedhur themelet e shkencës dhe të diturisë së re, Samiu pohon se feja dhe dituria nuk mund të pajtohen, se atje ku ka fe nuk ka dituri, prandaj për të mësuar duhet t'i drejtohem i jo fesë, por të vuarit. Kur mësohej vetëm besa, thotë ai, nuk bëhej fjalë për dituri, prandaj burimi i diturisë është vetëm të vuarit.

Samiu në artikujt e tij bën një inkursion historik, i drejtohet historisë së zhvillimit të shoqërisë për të provuar se midis diturisë dhe besimit ka një kontradiktë të papajtueshme, se në ndeshjen midis tyre epërsia dhe fitorja në fund të fundit janë në anën e diturisë dhe se kur feja e ka mbytur diturinë kjo ka qenë një gjëmë e madhe për njerëzimin. Kështu në radhën e filozofëve të shquar të Greqisë së Lashtë ai dallon materialistët Thalesin e Anaksagorën dhe i dallon për meritën e madhe që ndanë urtësinë nga besa e atëhershme, ngritën diturinë mbi përrallat. Këtu gjen rastin Samiu për të mbrojtur idenë e tij iluministe se feja dhe besytëritë janë të pafuqishme

para ditorisë. „ Të marëtë, sado të vrasinë e të the-
rinë të t'urtëtë, — thotë ai, — kurë të ditoritë s'mu-
ndenë nga të paditurët, edhe kurë egërsia e përallatë
s'qendronjë dot kundruell ditoris'e urtësisë”.

Samiu ndalet në qytetërimin mesjetar për të pro-
vuar në shembullin e tij se së pari, ku është feja atje
është errësira dhe paditura, „u bë, — siç thotë për
atë kohë Samiu, — një nat'e thellë e errëtë, mbretë-
ronte padia dhe egërsia...”. Së dyti, se feja atje ku
sundon pjell egërsi dhe mbahet me hekur dhe me
dhunë. Egërsia dhe padia janë aleatët e natyrshëm
të fesë. „Fuqi e besësë, — thotë gjithnjë për në atë
kohë Samiu, — u bashkua me fuqinë e egërsisë dhe
bënë një kohë të hekurit e të erësisë”. Këtu Samiu
përmend rolin e kobshëm të priftërinjve dhe të inku-
izicionit të tyre që ndiqnin egërsisht, i digjnin të gjallë
si magjistarë të gjithë ata që guxonin të thoshin ndo-
një fjalë të re, të gjithë „ata që përpiqeshin për të
ditur”.

Në inkursionin që bën Samiu në historinë e fi-
lozofisë nuk le pa përmendur dhe skolastikën, pa
vënë në dukje shterpësinë dhe kotësinë e saj. Thel-
blin e skolastikës ai e jep në një mënyrë origjinale,
duke e quajtur një filozofi, „e cila mundon shumë e
mëson pakë”. Kritika e skolastikës apo sipas termi-
nologjisë së Samiut, e „filozofisë së skolasurë”, ka
qenë një detyrë e mprehtë e shkencës dhe e filozo-
fisë në shekujt XVI e XVII, detyrë të cilën ato,
nëpërmjet veprës së Da Vinçit, Galileit, Bekonit,
Dekartit e përballuan dhe e zgjidhën me sukses. Me-
gjithëkëtë skolastika dhe ndikimi i saj nuk ishte ka-
përcyer për botën osmane, për shkollën e saj, ku
mësimet jepeshin në gjuhën e huaj arabe dhe mbësh-
teteshin kryesisht në kuranin. Shkolla e asaj kohe
ishte me të vërtetë një shkollë që shumë mundonte
dhe pak mësonte. Detyra e kohës ishte të krijohet
një shkollë e re, e mbështetur në një pedagogji të re,

e cila të mundonte sa më pak dhe të mësonte sa më shumë. Zgjidhja e saj kalonte patjetër nëpërmjet kritikës së skolastikës dhe shkurorëzimit të fesë, siç bën dhe arsyeton Samiu.

Samiu, duke kritikuar skolastikën dhe fenë, vjen në emrat dhe në veprën e atyre shkencëtarëve dhe mendimtarëve që kanë ngritur shkencën në kundërshtim me fenë si Koperniku, Kepleri, Galilei, Njutoni, që kanë hedhur themelet e filozofisë antiskolastike dhe antiklerikale si Dekarti, Volteri, Rusoi. Me këta emra Samiu i fut shqiptarët e kohës së tij në një botë interesante, në botën e shkencës dhe të filozofisë antiskolastike dhe antifeudale. Me këtë ai i mëson shqiptarët dhe u tregon se ç'tip kulture u duhet për të zhdukur zgjedhën feudale otomane dhe për të marrë rrugën e përparimit dhe të qytetërimit.

Në serinë e artikujve të tij në „Drita” dhe „Dituria” Samiu i hedh një vështrim të shpejtë qytetërimit njerëzor dhe fazave të ndryshme nëpër të cilat ai është rritur e ka shkuar përpara. Edhe në këtë fushë nuk është interesi i eruditit, i enciklopedistit ai që e shtyn, por interesi i patriotit dhe revolucionarit shqiptar, të cilit i duhej qytetërimi dhe që shkonte me ngulm drejt tij.

Ideja dhe përfytyrimi që ka Samiu për qytetërimin njerëzor, për thelbin dhe forcat e tij lëvizëse nuk i përgjigjen plotësisht procesit real historik nëpër të cilin ai ka kaluar. Por nëpër të ka plot vëzhgime, vlerësime, vërejtje të drejta, që tregojnë se ç'njohës i mirë i historisë ishte Samiu, dhe sa bukur dinte ai ta interpretonte zhvillimin e qytetërimit nën prizmin e interesave kombëtare shqiptare. Edhe përsa i përket qytetërimit dhe forcave të tij lëvizëse te Samiu flet iluministi. Thelbin e qytetërimit dhe masën e zhvillimit të tij Samiu e sheh në diturinë dhe në sasinë e saj. Për Samiun qytetërimi nuk është gjë tje-

tër veçse „rrojtj'e njeriut mi dhet me dituri, me urtësi, me butësi, me pasje e me çdo farë lehtësie. . .”.

Në qoftë se thelbi i qytetërimit është dituria, atëherë kjo, sipas Samiut, është dhe forca e tij lëvizëse. Dituria dhe qytetërimi kanë ecur krah për krah dhe janë zhvilluar si shkaku me pasojën. Për të provuar këtë Samiu u drejtohet kulturave të ndryshme që janë krijuar gjatë shekujve si kulturës egjiptiane dhe aziatike, kulturës greke, kulturës arabe dhe asaj evropiane. Në vlerësimin e këtyre kulturave Samiu diti të kapërcejë njëanshmërinë e shumë mendimtarëve e filozofëve të Evropës që në qendër të kulturës vinin Evropën dhe nuk përfillnin kulturën e popujve të tjerë të Azisë apo të Afikës. Ndryshe prej tyre, Samiu i udhëhequr nga një koncept më i gjerë, çmonte dhe kontributin që kanë dhënë në kulturën botërore vendet evropiane si ato të Azisë, Arabia etj.

Samiu diti gjithashtu të vërë drejt në dukje dhe disa karakteristika dalluese të kulturave për të cilat ai bën fjalë. Kështu ai flet për karakterin spekulativ të kulturës së grekëve, të cilët „ishinë, — siç thotë ai, — më tepër me fjalë se me punë”. Këtë tipar ai me të drejtë e shpjegon me mungesën e eksperimentit dhe me përbuzjen e punës nga ana e skllavopronarëve, të cilët „për të punuarë s'kishin veç duart'e skllavit, të cilët i mbaninë në një robëri të keqe dhe më shumë i vininë të punonjënë me hekura në këmbë e në qafë”. Ky konstatim e bën Samiun të shmanget nga terreni i kulturës, t'i shpëtojë absolutizimit të saj dhe të vërë në dukje se fizionominë e shoqërisë më tepër se kultura e përcakton ndarja e saj klasore, një ndarje e egër dhe e ashpër. „Njerëzitë, — vëren Samiu, — ishinë të ndarë më dy, ca me duar të hekurta që vrisnin' e prinin e rëmbejnë sa muntninë e ca në hekura nën zgjedhë që rënkoninë e nënë një skllavëri të keqe punoninë si kafshë e s'urdhëroninë gjekafsh”.

Nga kultura dhe qytetërimi i lashtë grek, Samiu kalon në kulturën dhe në qytetërimin arab. Si një

njohës i mirë i kulturës arabe që ishte, Samiu nxjerr në shesh vlerën e saj dhe tregon atë vend të veçantë që ka zënë ajo në historinë e kulturës botërore, si një kulturë që ka thënë një fjalë të re për kohën për shumë degë të shkencës dhe të teknikës, si një kulturë që shpëtoi nga harresa dhe ua transmetoi evropianëve shumë monumente të kulturës së lashtë greke. Përfaqësuesit e shquar të kësaj kulture për Samiun janë shkencëtarët dhe mendimtarët e njohur, Abu Sinani (Avicena) dhe Ibn Ruzhdiu (Averroesi). Është interesant të theksohet se në gjithë studimin e tij për kulturën arabe Samiu nuk e zë në gojë fare islamit dhe kuranin, provë tjetër që flet për drejtimin e mendimit të Samiut, një drejtim iluminist dhe antiklerikal.

Samiu është një mendje realiste. Plot realizëm ai flet për vlerat e gjithanshme të diturisë jo vetëm në luftë kundër paragjykimeve dhe injorancës për emancipimin intelektual të njeriut, por dhe në përpjekjet e shoqërisë për zhvillimin e prodhimit dhe përsosjen e jetës njerëzore. Një nga tiparet që dallojnë Samiun në shkencën e re në Evropën e shekujve XVII - XVIII është se ajo u vu në shërbim të prodhimit, ndihmoi në përvetësimin e forcave të mëdha të natyrës, siç është forca e avullit. Dituria, shpjegon në një vend tjetër Samiu, i duhet njeriut që ta ndihmojë „të nxjerr nga dheu dhe nga natyra gjëra të vjejtura... për të vajtur njerëzia mbar'e më mbar". Dituria, vëren më tej Samiu, është bërë tashmë pjesë e qytetërimit të sotëm dhe kusht i ekzistencës së tij. Prandaj njeriu mund të bëhet pjesë e këtij qytetërimi dhe të ecë në një hap me të vetëm në saje të diturisë. Për të ardhur në këtë ide Samiu vëren se „qytetëria i ka holluarë aq punërat sa dor'e ashpër dhe mendj'e pagdhundur e të paditurit nuk mund të punonjë gjë të pëlqyerë...". Prapa përgjegjës së Samiut për vlerën e kulturës dhe destinacionin e saj fliste interesi i atyre forcave shoqërore që ishin lidhur me zhvillimin e prodhimit, që në rrethanat e atëhershme, nuk mund të

ishte veçse një zhvillim kapitalist. Dhe në rrethanat e Shqipërisë vërtetohej ajo lidhje që kishte vënë në dukje Engelsi midis shkencës së re dhe borgjezisë që shkonte drejt pushtetit dhe rendit të saj në luftë kundër rendit feudal.

Por para se të zhvillohej prodhimi dhe me qëllim që të zhvillohej prodhimi ishin të nevojshëm liria dhe sovraniteti kombëtar. Këtij prioriteti, këtij kushti primar i përmbahet Samiu dhe në orientimet e kërkesat e tij për zhvillimin e kulturës dhe të diturisë. Ai do të përpiqet të vërë në pah dhe të përhapë ato elemente të kulturës dhe të diturisë që do të krijojnë te shqiptarët një ndërgjegje kombëtare, që do t'i frymëzojnë dhe do t'i ngrënë në luftë për liri dhe sovranitet kombëtar. Sigurisht jo çdo lloj lirie dhe sovraniteti kombëtar, por një liri dhe sovranitet që të shoqërohej me një zhvillim të mëtejshëm të prodhimit, me një përparim të përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror.

Ashtu si dituria edhe qytetërimi për Samiun nuk është një entitet i dhënë, por një proces në lëvizje dhe në zhvillim të pandërprerë. Në këtë zhvillim Samiu dalloi tri etapa të mëdha: egërsinë, barbarinë, qytetërinë të cilat i pat dhënë Morgani dhe që do t'u përmbahet Engelsi në veprën „Origjina e familjes, pronës private dhe shtetit”. Dhe qytetëria për Samiun, nuk është një etapë që ka marrë menjëherë pamjen e saj, por një proces që ka kërkuar vite e shekuj dhe akoma sot nuk ka përfunduar. „Qytetëria ka zënë të çpiketë, — vëren Samiu, — që nga mijëra vjetë e sot e kësaj dite e s'e ka mbaruarë udhën e saj sa vete po zgjerohet e po ritetë ditë më ditë”.

Për të kuptuar drejt dhe në të gjithë thellësinë e vet procesin e zhvillimit të qytetërimit Samiut i mungonte kuptimi shkencor, materialist i historisë. Koncepti i formacionit ekonomik-shoqëror nuk bënte pjesë në arsenalin e botëkuptimit të tij. Në vend të tij ai kapet pas entitetit shoqëror popull të cilin nuk e dallon nga kombi. Në vështrimin që ai i hedh historisë

së popujve, e parë kjo në raport me qytetërimin si nivel kulturore Samiu vë re së pari, se qytetërimi nuk ka qenë pronë e një populli të vetëm, por e të gjithë popujve, se ai ka rënë herë në dorën e njërit dhe herë në dorën e tjetrit; së dyti, se qytetërimi nuk ka ecur përpara në mënyrë të qetë, por nëpërmjet përmbyshesh të mëdha, uljesh e ngritjesh të fuqishme; së treti, se këto ulje dhe ngritje janë të lidhura njëra me tjetrën në mënyrë të tillë që shkalla që vjen më vonë është më e lartë se ajo që ka qenë më parë dhe kështu shkon përpara qytetërimi. „Qytetëria është një e pandarë, po ata që kanë ruajturë e që kanë ritur e zbuluarë kanë qenë në ç’do kohë të tjerë, herë ka rënë në dorë të një kombi, herë të një tjetri, nga një herë ka qenë vrejtur’ e veniturë, por kurrë s’ka qenë e shkuar fare, dhe me qënë, që të parët janë qënë kurdo mjeshtërit e mësonjësit’ e të pastajmët, ç’do qytetëri m’e pastajme ka pasurë qënë m’e gjërë e m’e plotë nga m’ë parë, sikundëre që qytetëri e grekërvet, ish shumë m’e mbarë nga qytetërit, e kombevet të vjetërë t’Azis’ e t’Egjiptësë edhe qytetëri e arabëvet m’e mbarë nga grekret, kështu edhe qytetëri e evropianëvet është m’e mbarë nga të tëra të shkuaratë”.

Me këto vërejtje të përgjithshme Samiu, si demokrat që ishte, donte të tregonte dhe të provonte se nuk ka popuj të zgjedhur për historinë dhe qytetërimin, se të gjithë popujt, kudo që të jenë dhe sido që të jenë, janë të aftë për qytetërim, se dhe ai më i prapambeturi një ditë mund të ngritet dhe të dalë në vendet e para. Po të kalohet nga këto vërejtje dhe arsye-time të përgjithshme në terrenin konkret shqiptar, për të cilin shkruante dhe mendonte Samiu, kjo donte të thoshte se populli shqiptar, megjithëse sot i prapambetur dhe nën zgjedhë, nesër mund të ngrihet, të fitojë lirinë dhe të shkojë përpara njëlloj si popujt e tjerë. Ky ishte arsyetimi i shpresës, argumentimi i Rilindjes. Në të sotmen e errët ai shihte të nesërmen e ndritur të popullit shqiptar.

Pozita e demokratit dhe e patriotit e solli Samiun në arsyetime plot frymë dialektike, e bëri atë të shpallte se në historinë e shoqërisë nuk ka asgjë të përjetshme, se shkatërrimi i pashmangshëm i së vjetrës bëhet kusht i domosdoshëm për fitoren e së resë, se progresi, të cilin ai e identifikonte me qytetërimin, është tendenca themelore e historisë së çdo populli dhe të gjithë shoqërisë, të cilën s'ka forcë që ta ndalë. „... qytetëri e Evropës, — siç thotë vetë Samiu, — qytetëria pa anë e funt, e cila ditë më ditë po shtohet e po përhapetë edhe, shpejt a vonë, një ditë do të mbulonjë gjithë dhenë e të ndritonjë gjithë kombet e dheut!”.

Artikujt e Samiut mbi diturinë dhe qytetërimin janë shkruar në mënyrë të përgjithshme, në planin e të gjithë shoqërisë. Por një lexim i vëmendshëm i tyre tregon se ata nuk janë aq të përgjithshëm sa duken, se ata janë shumë afër një vendi të caktuar, Shqipërisë, dhe frymëzohen prej interesave të saj. Lufta për arsim dhe dituri do të ishte rruga e gjerë në të cilën do të bëheshin përpjekjet për ta zgjuar popullin shqiptar dhe për ta hedhur në luftën e tij për liri dhe pavarësi. Prandaj Samiu, në emër të kësaj rruge, të kësaj detyre konkrete, bën gjithë ato arsyetime për të treguar thelbin e diturisë dhe rolin e saj në përparimin e njeriut dhe të shoqërisë.

Më tej, lëvizjes çlirimtare shqiptare nuk i duhej çdo lloj arsimit dhe diturie, por një arsim dhe dituri në gjuhën amtare shqipe, si mjete më i mirë për zgjimin e ndjenjave kombëtare dhe afirmimin e popullit tonë si komb më vete. Prandaj Samiu, në emër të kësaj detyre, në qytetërimin dhe zhvillimin e tij, gjënë e parë që dallon është gjuha. Me gjuhën e shkruar, sipas Samiut, fillon qytetërimi, me të ai shkon përpara dhe zhvillohet. „... zun'e shkruaninë gjuhënë e tyre, — thotë Samiu. — Kjo është gjurma e parë që bënë n'udhë të qytetërisë”.

Më tej, në luftën e tij të vështirë për liri dhe progres populli ynë kishte nevojë për një besim në drejtësinë e çështjes së tij dhe në mundësinë e fitores së saj. Prandaj Samiu për të ngjallur këtë besim, kur flet për qytetërimin e lashtë grek vë në dukje se kur grekët erdhën nga Azia gjetën një popullsi tjetër me një qytetërim më të lashtë, me një gjuhë më të pasur. Këta ishin ilirët, të parët e shqiptarëve. Por rrethanat e historisë bënë që ky popull i lashtë të bjerë nën zgjedhë dhe të mbetet prapa shumë popujve të tjerë. Veçse, shpjegon Samiu, kjo gjendje nuk është aspak pa shpresë, sepse, siç tregon historia, edhe popuj të tjerë kanë rënë poshtë dhe pastaj janë ngritur. Po kështu dhe Shqipëria, në bazë të kësaj ligjësie historike, medoemos do të ngrihet, medoemos do të fitojë lirinë dhe do të vihet në radhën e popujve të përparuar. Të gjitha këto i bëjnë artikujt e Samiut në gazetën „Drita” dhe më vonë në atë „Dituria” artikuj politikë dhe vetë gazetat — gazeta politike, organe të vërteta të lëvizjes çlirimtare shqiptare, kurse shkruesin e tyre, Samiun, udhëheqës dhe frymëzues të saj.

VI. STATISTI¹⁾ I SHQUAR I SHQIPËRISË

Lëvizjes çlirimtare shqiptare, luftës për një Shqipëri të lirë e të pavarur, Samiu nuk iu nda asnjëherë. Atë ai e ndoqi në çdo hap të zhvillimit të saj, në të gjitha kthesat dhe udhëkryqet e saj. Vepra e tij „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?“, vepra më e mirë e tij në gjuhën shqipe dhe përgjithësisht më e mira e të gjithë Rilindjes Kombëtare botuar në vitet e fundit të jetës së tij (1899) është dëshmia më e qartë, më vendimtare se interesi për atdheun dhe fatet e tij nuk kishte qenë çështje e një entuziazmi të rinisë, por një bindje themelore, së cilës i kishte mbetur besnik për tërë jetën, një bindje sa e menduar aq dhe e vuar. Me këtë vepër mendimi politik-shoqëror shqiptar shënonte një shkallë të re në rrugën e tij të rritjes dhe të pjekurisë, shprehje e qartë e vetë rritjes dhe e pjekurisë së lëvizjes çlirimtare shqiptare.

Vepra e Samiut „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?“ botohej në Bukuresht, jashtë kufijve të Perandorisë Osmane dhe pa emrin e autorit. Ishin që të dyja këto shenja kuptimplote. E para, jashtë

¹⁾ Termi statist nuk përdoret këtu në kuptimin e njeriut që drejton punët e shtetit por në kuptimin e mendimit politik, e njeriut që ka menduar për punët e shtetit e të kombit dhe ka treguar rrugët e shpëtimit dhe të forcimit të tyre.

perandorisë, donte të thoshte se libri në gjuhën shqipe brenda kufijve të perandorisë ishte i ndaluar. E dyta, pa emrin e autorit, se vepra që po botohej nuk ishte një diçka e pafajshme, por plot rreziqe për autorin e saj.

Botimi jashtë kufijve, botimi anonim apo me pseudonim është përgjithësisht karakteristik për atë mendim politik dhe shoqëror përparimtar që lind në kushtet e absolutizmit dhe të reaksionit politik. Sa mendimtarë e dijetarë përparimtarë të vendeve evropiane gjatë historisë kanë parë dyert e burgut, kanë marrë arratinë apo janë detyruar t'i botojnë veprat e tyre me lloj-lloj pseudonimesh! Një fat të tillë pati dhe Samiu ynë. Veprat e tij në gjuhën shqipe ai u detyrua t'i botojë jashtë perandorisë, veprën e tij „Shqipëria ç'ka qenë. . .” ta botojë pa emrin e tij, kurse vitet e fundit të jetës t'i kalojë i mbyllur në shtypi në gjendjen e një të burgosuri.


Kultura e re në gjuhën shqipe që po lindte dhe po zhvillohej nuk kalonte nëpër një fushë me lule, por nëpër rrëpira plot driza dhe gjemba. Autorët e saj punonin dhe krijonin në mes rreziqesh që në çdo hap vinin me pikëpyetje edhe vetë jetën. Në këto rrethana krijimi letrar-politik nuk ishte vetëm çështje talenti, por më tepër akoma çështje vendosmërie dhe guximi politik, të cilat Samiu i kishte me tepriçë. Ai ishte mendjendritur dhe i patrembur, përfaqësues tipik i atyre militantëve që kërkonte momenti aktual në të cilin ndodhej Shqipëria e asaj kohe.

Në fund të shekullit XIX, kur botohej „Shqipëria ç'ka qenë. . .”, kishte kaluar gati 30 vjet nga dita që Samiu kishte mbaruar shkollën dhe kishte marrë, si i thonë, rrugën e jetës. Vitet kalonin dhe dukej gjithnjë e më qartë se rruga e jetës e zgjedhur prej tij ishte ajo e një punëtori të palodhur të pendës dhe e një luftëtari të paepur të lirisë dhe të progresit shoqëror. Tani ai mund të shihte prapa dhe të gjente në jetën e tij një thesar të vërtetë krijimi letrar-shken-

cor dhe veprimtarie politike-patriotike. Për dhjetra vjet, nga dita në ditë, Samiu, në shtypin e drejtuar prej tij, kishte mbrojtur si luan të drejtat e popullit shqiptar, të kërcënuara nga lakmitë e qarqeve shoviniste dhe nga padrejtësitë e fuqive imperialiste. Për dhjetëra vjet, nga dita në ditë, në gazeta dhe në botime të tjera ai kishte mbrojtur dhe përhapur një tufë të tërë idesh, që ndriçonin mendjen e njerëzve dhe i frymëzonin në luftë për liri kombëtare dhe përparim material e moral. Për dhjetëra vjet, nga dita në ditë, ai ishte bërë organizuesi dhe frymëzuesi i një veprimtarie të gjerë në të mirë të çështjes shqiptare.

Çështja nuk ishte të shikoje prapa për t'u kënaqur me atë që ishte bërë, por të shikoje përpara për të gjetur se ç'mbetej akoma për të bërë. Lëvizja patriotike çlirimtare shqiptare, veçanërisht pas Lidhjes shqiptare të Prizrenit, ishte rritur aq shumë, ngjarjet që kishin të bënin me vetë qenien e Perandorisë osmane ishin rrokullisur me shpejtësi aq të madhe sa që tani kërkohej një platformë politike e qartë dhe e argumentuar mirë. Duheshin vepra ku të përgjithësohej përvoja e grumbulluar nga lëvizja patriotike çlirimtare shqiptare gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit dhe, duke u mbështetur aty, të paraqiteshin në një sistem idetë dhe qëndrimet që do të duhej të bëheshin udhërrëfyese në luftën për të tashmen dhe të ardhmen e Shqipërisë. Edhe në këtë rast - më i ndjeshëm ndaj kërkesave të momentit dhe më i aftë për t'u përgjigjur atyre si duhet u tregua Samiu me veprën e tij „Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë?”.

Me analizën që i bëri gjendjes së atëhershme si dhe raportit të forcave që vepronin në arenën politike dhe që, në një mënyrë a në një tjetër; ndikojnin në çështjen shqiptare, si dhe me konkluzionet që nxori për të tashmen dhe për të ardhmen e Shqipërisë, vepra e Samiut u bë traktati më i rëndësishëm



Vepra kryesore e Samiut: „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?” — botuar pa emrin e autorit, në Bukuresht më 1899

i mendimit politik dhe shoqëror të popullit tonë për atë kohë. Në asnjë vepër tjetër nuk ishin shpjeguar dhe argumentuar aq drejt dhe thellë situatat nëpër të cilat kalonte lufta çlirimtare e popullit shqiptar, si dhe detyrat aktuale që dilnin nga këto situata. Në asnjë vepër tjetër nuk ishte aq e fuqishme fryma demokratike dhe revolucionare. Vepra i përgjigjej më së miri detyrës që Samiu i kishte vënë vetes dhe që e shpallte që në titullin e veprës, të jepte „mendime për shpëtim të mëmëdheut nga rreziket që e kanë rethuarë”.

Realiteti shqiptar dhe detyrat e çlirimit të Shqipërisë

Siç e tregon dhe vetë titulli, vepra e Samiut është e ndarë në tri pjesë: e kaluara, e tashmja dhe e ardhshmja e Shqipërisë. Asnjëra nga këto nuk ka vlerë të pavarur. Çdonjëra lidhet me tjetrën dhe të gjitha së bashku synojnë një qëllim të vetëm: të zbulojnë dhe të argumentojnë kushtet historike shoqërore të brendshme dhe të jashtme, që e bëjnë të pashmangshme ringjalljen e Shqipërisë, pavarësinë e saj.

Ç'përfaqësonte realiteti shoqëror shqiptar në atë kohë? Në disa vija të trasha, por të hequra me siguri, nga dorë mjeshtëri, Samiu jep tablonë e jetës së popullit në atë kohë, një jetë plot vuajtje dhe plagë të rënda. Shqiptari, shpjegon Samiu, është keq e mos më keq, i varfër sa s'ka ku të vejë më, „lakuriq me një këmishë”, që s'ka ku ta zerë qeni! „Vete zaptieja e tahsildari e ngre shkopin e i rreh, duke thirurë: pagoni! E ku të gjej i ziu që të paguanjë? Atëherë i shesinë kanë, dhinë, qetë edhe gjer në qeramidhet të shtëpisë. Shqipëtarit të hajë dru për të paguarë. O ç'e madhe e keqe”).

¹⁾ Citimet janë nxjerrë nga „Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet?”, Tiranë, 1962.

Varfërisë i shtohet një gjëmë tjetër akoma më e rëndë, shërbimi ushtarak në të mirë të perandorisë, që i rrëmbente vendit forcën e gjallë punëtore dhe që, për të interesuarit kthehej në një katastrofë jetësore. „...E merr për tre vjet, — shkruan Samiu, — e mban dhjetë vjet nën armë, larg mëmëdheut të tij, edhe qysh? Lakuriq, t'urëtë, të sëmurë, të varfër... Ushtari shqiptarë në mos vdektë në luftë vdes nga sëmundja, nga të pangrënët e të pamveshurit. Nga ata që venë në ushtri, pakë kthehen në shtëpitë e tyre”. Kjo tablo e gjendjes së popullit nuk flet, por bërtet se një jetë e tillë është e padurueshme, se kështu nuk mund të vazhdojë më.

A kishte ndonjë fije drite, a dukej ndonjë rrugë shpëtimi nga kjo gjendje, duke mbetur Shqipëria në kuadrin e Perandorisë Osmane? Asnjë fije drite, asnjë rrugë shpëtimi. Gjithkund errësi. Gjithkund pa rrugëdalje. „Për udhët paguajnë veçan, — shkruan Samiu, — udhë s'ka; lumenjtë mbytinë fushat; ethetë, që shpiken nga këto baltëra, bëjnë botënë të jenë gjithnjë të sëmurë e të dobëtë, të mos punojnë dot e të vdesin nga sëmundja e nga uriya, kështu, një varfëri e madhe, e keqe e ka mbuluar gjithë Shqipërinë”, sepse qeveria, e cila në parim duhej t'i rregullonte këto punë, në të vërtetë nuk mendon, veçse si të mbledhë taksa dhe ushtarë.

Qeveria dhe pushteti ekzistues në fuqi, thekson Samiu, duke numëruar më tej plagët e rënda të popullit, nuk është në gjendje të sigurojë të drejtat elementare të çdo qytetari — të drejtën e jetës dhe të drejtën e asaj cope pasurie me të cilën mban gjallë jetën. „Hyn kusari dhe e vjedh, hyn armiku dhe e vret”. Dhe gjëra më paradoksale, vëren Samiu, është se qeveritarët jo vetëm që s'bëjnë gjë për të mbrojtur pasurinë dhe jetën e shqiptarit, por hyjnë në marrëveshje me ata që e plaçisin popullin, „Qeveritari shpeshherë bashkohet me hajdunë për të rrjepur shqiptarët”.

Plagët, të cilave u vë gishtin Samiu, nuk janë të thjeshta. Ato janë njëra më e rëndë se tjetra dhe që të gjitha vdekjeprurëse për organizimin shoqëror dhe për jetën e qytetarëve që përbëjnë këtë organizëm. Ato kanë emra të ndryshëm — varfëri, padituri, pasiguri, paqeverisje, por kanë një burim të vetëm — robërinë, zgjedhën e huaj. „Shqipëtarëtë, — shkruan Samiu, — janë robër, të pushtuar dhe t'unjurë, të shkelurë e të shpërndarë shumë më tepër se të tjerë kombe të Turqisë”.

Analiza e Samiut përmban në vetvete dhe zgjidhjen, tregon të vetmen rrugë të mundshme të shpëtimit. Në qoftë se robëria është burimi i të gjitha të këqijave, atëherë liria do të jetë shpëtimi prej tyre; në qoftë se qeveritarët turq dhe pushteti i tyre nuk bëjnë gjë për të shëruar plagët, por vetë i gjenerojnë këto, atëherë përmbysja e tyre, vënia në vend të tyre të qeveritarëve shqiptarë është shpëtimi.

Perandoria Osmane një i vdekur që duhet varrosur sa më parë

Situatat nuk krijohen dhe as zhvillohen nën veprimin e një force të vetme shoqërore me një kah të vetëm, por nën atë të disa forcave shoqërore me kahe të ndryshme, kontradiktore. Ato janë shprehje e një raporti të caktuar forcash përparimtare dhe reaksionare, rezultante e ndeshjes, e luftës midis tyre. Prandaj, të flisje për pavarësinë e Shqipërisë, të zbuloje kushtet e realizimit të saj do të thoshte të analizoje forcat shoqërore që qëndronin përballë njëra-tjetrës, të kuptoje drejtimit e veprimit të tyre, si dhe shkallën e efikasitetit të këtij veprimi.

Forca shoqërore, që qëndronte përballë popullit shqiptar në luftën e tij për liri dhe pavarësi, ishte Perandoria Osmane me pushtetin e saj të zgjedhës dhe të shtypjes. Nuk mund të bëhej fjalë për luftën çlirimtare të popullit shqiptar pa marrë parasysh kë-

të forcë, pa hetuar shkallën e fuqisë dhe të efikasitetit të saj. Kjo ishte vendimtare për situatën e dhënë. Prandaj Samiu një pjesë të madhe të veprës së tij ia kushton kësaj analize.

Vepra e Samiut „Shqipëria ç'ka qënë...” është një „*de profundis*” e Perandorisë Osmane, është një lajmërim vdekjeje për të. Veçse një lajmërim vdekjeje i veçantë, ku nuk duket asnjë notë hidhërimi apo keqardhjeje, por që, për më tepër, tingëllon si një lajm i mirë, si një sihariq për popullin shqiptar. „Turqia — shpjegon Samiu — as mund të rrojë paskëtaj, as di, as do të rronjë, edhe as duhet të rronjë. Ky është një njeri i vdekur. Sado ta duamë një të vdekurë duhet ta vëmë në dhjet”. Dhe më poshtë: „Turqia me këtë udhë që ka zënë në Evropë e ka jetën fort të shkurtër”.

Në këtë konkluzion kaq të prerë, në këtë dënim me vdekje pa të drejtë apeli Samiun e sillte analiza e gjendjes reale politike dhe shoqërore të vetë Perandorisë Osmane. Nuk ishte ndonjë sekret se Perandoria Osmane, apo si i thoshin në atë kohë „i sëmuri i Bosforit” ishte për vdekje, se të gjitha forcat që vepronin si brenda ashtu dhe jashtë saj e çonin në mënyrë të pashmangshme drejt greminës. Kjo nuk mund të ishte aq më tepër sekret për Samiun, i cili jetonte në qendrën e kësaj perandorie dhe si njeri me një horizont të gjerë teorik e politik që ishte, nuk e kishte të vështirë të dinte gjendjen e vërtetë të punëve.

Në këtë konkluzion e sillte Samiun jo vetëm analiza objektive e situatës, por edhe pozita e tij subjektive. Analizat e situatave shoqërore kalojnë nëpërmes interesave materiale të atyre që i bëjnë ato. Janë këto interesa që vënë vulën e tyre edhe në konkluzionet përkatëse. Samiu e analizonte situatën me sytë e patriotit shqiptar, që nuk mund të pajtohej me sundimin dhe zgjedhën e popullit dhe të atdheut të vet prej Perandorisë Osmane. Ai e analizonte situatën me sytë e demokratit, që nuk mund të pajtohej me absolutizmin despotik të Perandorisë Osmane. Kjo analizë e

çoi Samiun në konkluzionin e prerë të shpallur pa asnjë fije dyshimi se Perandoria Osmane është e destinuar të shkatërrohet, se s'ka forcë që të mund ta shpëtojë.

Aktivistët nga kampi i reaksionit perandorak e shtronin problemin se ç'pallativ duhet gjetur për ta mbajtur në jetë këtë të sëmurë për vdekje, ç'stenga duhen vërë që të mos bjerë gërmadhash kjo ndërtesë e shkatërruar në themel. Bile dhe nga kampi i opozitës brenda perandorisë kishte aktivistë që, duke hequr dorë nga absolutizmi i sulltanit, nuk hiqnin aspak dorë nga vetë perandoria. Ndryshe prej tyre Samiu e shtronte problemin në mënyrë radikale: ç'duhet bërë që të shpejtohet përmbyjsja e perandorisë, që ajo të kryhet në mënyrën më rrënjësore për të mirën e popujve të shtypur prej saj, si dhe për atë të vetë popullit turk? Sipas Samiut, Perandoria Osmane jo vetëm objektivist nuk do të rrojë, por dhe subjektivist nuk duhet të rrojë. Këtë qëndrim të prerë ndaj perandorisë Samiu e jep më së miri me figurën e të vdekurit që njerëzit e afërt, sado që ta duan, shpejtojnë ta heqin nga shtëpia dhe ta shtien sa më parë në dhe.

Shqiptarët duhet ta kenë pushkën plot

Pushteti i klasave reaksionare si dhe ai i kombeve shtypës nuk varroset aq thjesht e qetë sa varrosen njerëzit. Ai reziston me një forcë të madhe. Reaksioni sado i kalbur që të jetë, nuk bie vetvetiu, po s'pati një forcë që ta shtyjë. Rolin e përmbyësist të reaksionit, të varrmihësit të tij e luan dhuna, veprimtaria revolucionare e klasave përparimtare dhe e popujve të shtypur. Këtë të vërtetë të shkencës shoqërore mbron dhe Samiu, i cili thekson se „e vetmja udhë e shpëtimit është t'i japë një shqelm të shëndoshë këtij tradhëtari, që kërkon ta mbytnjë, ta dërgojë atë në fund të detit dhe ta shpëtojë veten prej

tij". „...Shqiptarët duhet t'i marrin atë që duan me pahir, t'i kërkojnë me fjalë, por të kenë dhe pushkën plot”.

Porosia e Samiut „... të kenë dhe pushkën plot” ishte në traditën e popullit shqiptar, ajo ishte një sugjerim i përvojës së tij shekullore. Në historinë e tij, fjala e fundit i ka mbetur gjithnjë pushkës. Arsyen që nuk e ka gjetur dhe që nuk mund ta gjente te pushtuesit dhe lakmuesit e tokave të tij, ai e ka gjetur vetëm në qëndresën e armatosur.

Porosia e Samiut është gjithashtu një sugjerim i logjikës së brendshme të evolucionit social. Asgjë progresive në shoqëritë të ndara në klasa antagoniste nuk është bërë pa dhunë, asnjë problem i madh në jetën e popujve të shtypur dhe nën zgjedhë nuk është zgjidhur pa veprimin e saj.

Ideja e përdorimit të forcës është nga më të rëndësishmet në botëkuptimin e popujve të pushtuar që luftojnë për çlirimin e tyre, siç është ajo nga më të rëndësishmet dhe në botëkuptimin e klasave të shfrytëzuara që luftojnë për emancipimin e tyre. Prandaj, nuk mund të mos e theksojmë veçanërisht këtë ide si një meritë të Samiut dhe të të gjithë ideologjisë çlirimtare shqiptare të asaj kohe.

Të bashkohen shqiptarët gjithë sa janë

I udhëhequr nga ideja e forcës së armatosur si kusht i çlirimit kombëtar, Samiu, në një pjesë tjetër të madhe të veprës së tij, përpiqet të gjejë në realitetin shqiptar atë forcë që do t'i japë shkëlmin dhe do ta dërgojë në fund të detit perandorinë.

Pyetjes „ç'duhet bërë?” Samiu i përgjigjet qartë dhe prerë: shqiptarët „duhet të lidhin fjalë midis tyre, të bashkohen gjithë sa janë, të apën e të marrin besë burrërisht, të qëndrojnë në fjalë të patundur dhe të kërkojnë të drejtën e tyre nga Turqia dhe nga

Evropa". Më poshtë Samiu bën thirrjen kategorike: „zihuni me të dy duart në besët, në lidhjet, në bashkimt”.

Në bashkimin e popullit shqiptar, në një bashkim sa më të gjerë, mundësisht të të gjithëve „sa janë e tek janë”, Samiu sheh forcën që do të jetë në gjendje të realizojë të drejtat e popullit shqiptar dhe do t'i lejojë atij të dalë qoftë përballë Turqisë, qoftë përballë shovinistëve fqinjë, qoftë përballë Evropës. Samiu bëhet kështu zëdhënës dhe luftëtar i njërës prej ideve themelore dhe objektivave qëndrore të të gjithë ideologjisë dhe lëvizjes çlirimtare të kohës — idesë së unitetit kombëtar. Në bashkimin e popullit shqiptar ai gjente forcën, në të ai shihte shpëtimin.

A mund të flitej për bashkim kombëtar dhe, ç'është më e rëndësishmja, a mund të realizohej një bashkim i tillë në rrethanat e shoqërisë shqiptare të atëhershme, e cila nga pikëpamja klasore nuk ishte monolite, por e ndarë në feudale dhe në fshatarë, në tregtarë të mëdhenj dhe në të vegjël, në të pasur dhe në të varfër? Mos shkonte kjo kundër logjikës së antagonismave klasore dhe të luftës midis klasave?

Ideja e çlirimit kombëtar e lejonte një unitet të tillë dhe jo vetëm e lejonte, por krijonte të gjitha mundësitë për realizimin e tij. Në të vërtetë, çlirimi kombëtar, në përgjithësi, është në interes të të gjitha shtresave shoqërore të një vendi.

Jo vetëm klasat shfrytëzuese i realizojnë më mirë interesat e tyre ekonomike në kushtet e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare, por edhe klasat e shfrytëzuara mund të organizohen dhe të luftojnë më mirë për interesat e tyre në kushtet e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare. Tjetër çështje është se shpesh klasat reaktionare, të tmerruar nga popujt, të verbuara nga interesat e tyre të ngushta klasore marrin rrugën e tradhtisë kombëtare dhe bashkohen me armiqtë pushtues të vendit të tyre.

Ideja e unitetit që mbron Samiu, thirrja e tij për bashkim drejtuar gjithë shqiptarëve „sa janë e tek janë” është teorikisht e argumentuar, politikisht e justifikuar.

Gjithë shqiptarët, myslimanë, katolikë, ortodoksë janë vëllezër

Pengesa kryesore në rrugën e bashkimit kombëtar ishte ndarja fetare. Dasia fetare, e sjellë në mes të popullit tonë dhe e mbajtur gjallë nga pushtuesit dhe kleri reaksionar ishte treguar një monedhë e e fortë në duart e tyre. Pas saj ishte kapur vazhdimisht pushteti i pushtuesit, pas saj kishin filluar të kapehin akoma më me forcë dhe më me brutalitet qarqet shoviniste të vendeve fqinje që kishin synime grabitqare ndaj vendit tonë. Prandaj, patriotët shqiptarë dhe gjithë ata që mendonin dhe luftonin për unitetin kombëtar, teshun e arsyetimeve të tyre, bile dhe të frymëzimeve të tyre, e drejtonin kundër dallimeve dhe përçarjes fetare. Idenë e unitetit kombëtar pa dallim feje, idenë e epërsisë së interesit kombëtar mbi atë fetar me një qartësi dhe bukuri të rrallë e kishte shprehur Pashko Vasa.

*„Çoniu o shqiptarë prej gjumit — çoniu,
Të gjithë si vëllezër një besë shtrëngoni
E mos shikoni kisha e xhamia.
Feja e shqyptarit është shqyptaria”.*

Atë që e kishte skalitur në vargjet e tij Pashko Vasa e rimerрте edhe Samiu siç e rimorën edhe Naim Frashëri, Jani Vretoja dhe ideologë të tjerë të Rilindjes sonë Kombëtare. „Mos vështroni besë e fe, — mëson Samiu, — mylmanë e katolikë, ortodoksë, gjithë shqiptarë, sa janë dhe tek janë, janë vëllezër”.

Natyrisht uniteti pavarësisht nga feja nuk ishte aq lehtë të realizohej sa e thoshte logjika e thjeshtë. Pengesat këtu ishin të mëdha të natyrës, ideologjike dhe të natyrës politike.

Për shkak të me radhë feja kishte nënshtruar të gjithë mënyrën e trajtimit dhe të shpjegimit të botës. Njerëzit fitonin ndërgjegje për vetveten dhe për të tjerët nëpërmjet fesë. Edhe interesat më tokësore, më larg fesë, që të kuptoheshin, duhej të shpreheshin me gjuhën e fesë, me argumentet e saj. Nuk është për t'u çuditur që në këto rrethana shqiptarët të dallonin veten më tepër në bazë të fesë se sa në atë të kombësisë.

Ndryshe nga ndjenja fetare, ndjenja kombëtare dhe, në përputhje me këtë, parimi kombëtar i vlerësimit të vetes dhe të jetës shoqërore nuk kishte pasur të gjithë kohën që të përpunohej dhe të rrënjosej në ndërgjegjen e shqiptarëve. Aq më tepër vendin këtu ajo nuk e gjente bosh, por të zënë nga një ndjenjë dhe parim i lashtë, siç ishte ndjenja dhe parimi fetar. Kjo e ndërlikonte problemin dhe nuk e bënte aq të thjeshtë sa mund të dukej në aspektin e parë apo sa mund të duket sot.

Por këtu nuk duhet ekzagjeruar. Megjithëse e re dhe pak e përpunuar në krahasim me fenë, ndjenja kombëtare i kishte të gjitha shanset që të përparonte dhe të zinte rrënjë në ndërgjegjen e shqiptarëve për arsyen e thjeshtë se ajo, ndryshe nga feja dhe në kundërshtim me të, u përgjigjej interesave të tyre më jetësore. Shqiptarët shkonin në mënyrë të natyrshme drejt idealit kombëtar. Kjo prirje realizohej akoma më lehtë kur propagandistë të idealit kombëtar në radhët e shqiptarëve ishin poetë të tillë si Naim Frashëri dhe Pashko Vasa, mendimtarë të tillë si Sami Frashëri dhe Jani Vretoja, për të mos përmendur veçse më të shquarët prej tyre.

Më tepër se ideologjike vështirësitë që pengonin konfirmimin e ndjenjës dhe të parimit kombëtar,

ishin politike. Në mbrojtje të parimit fetar, të dasive e grindjeve fetare ishte pushteti i pushtuesit, i gjithë aparati i tij politiko-ideologjik. Politikës shkombëtarizuese, politikës së dasive dhe grindjeve fetare kishin filluar t'i bënin jehonë dhe ta mbronin monarkitë shoviniste fqinje. Propaganda dhe veprimtaria e shovinistëve fqinjë në këtë fushë nuk ishte më pak e egër se ajo e pushtetit osman. Sado paradoksale që mund të duket, por është fakt se në këtë luftë shovinistët fqinjë kishin të gjithë ndihmën dhe përkrahjen e pushtetit të pushtuesve. Atë që ua ndalonin shqiptarëve në vendin e tyre — botimet në gjuhën shqipe, shkollat në gjuhën shqipe — pushtuesit osmanë ua lejonin shovinistëve fqinjë. Këtë e vë në dukje me keqardhje dhe me indignatë Samiu: „Grekët kanë një shok, — shkruan ai, — Tyrkun, i cili ndih grekër dhe patrikannën e Fanarit”.

Ndërsa pushtuesit osmanë dhe shovinistët fqinjë bënin lirisht propagandën dhe punën antikombëtare, ideologët dhe aktivistët e lëvizjes çlirimtare detyroheshin të zhvillonin veprimtarinë e tyre kombëtare ilegalisht, me kokë në torbë! Ndërsa të parët kishin në dispozicionin e tyre pará, shkolla, revista xhami e kisha, të dytët s'kishin gati asgjë. Këta mezi mundën të hapin ndonjë shkollë në dhjetvjeçarët e fundit të shekullit XIX, kurse veprat e tyre i botonin jashtë Perandorisë Osmane dhe i futnin ilegalisht në Shqipëri.

Por mungesat që kishte në mjetet materiale të ndikimit ideja kombëtare i kompensonte me drejtësinë e saj, me faktin se ajo shprehte atë që kërkonin vetë interesat e popullit. Forca e një ideje dhe, rrjedhimisht, mundësitë e përhapjes së saj nuk varen aq shumë nga mjetet materiale që vihen në dispozicion të propagandimit të saj sesa nga drejtësia e saj. Këtë të vërtetë sociologjike e njihte më së miri dhe Samiu. Në veprën e tij „Shqipëria ç'ka qënë...” bile dhe para saj në fjalët e urta ai vinte në dukje se idetë

e reja nuk ka forcë që t'i ndalë, se ato përhapen me një shpejtësi aq më të madhe sa më shumë rezistencë që të ndeshin. Një ide e tillë e re, një ide që shprehte kërkesat e zhvillimit progresiv, ishte ideja kombëtare e shqiptare, prandaj dhe fitorja do të ishte e saj. Kjo ishte bindja e Samiut. Këtë bindje ai mundohej ta përhapte dhe ta fuste në ndërgjegjen e shqiptarëve.

Në përpjekjet e tij për unitetin dhe bashkimin kombëtar, Samiu nuk e mohon fenë si dogmë, si botëkuptim. Ai nuk arsyeton në këtë mënyrë: meqë feja pengon bashkimin kombëtar dhe me këtë ajo bën lojën e armikut, atëherë ç'na duhet feja, ta hedhim poshtë. Ai ndjek një rrugë tjetër që e diktonin rrethanat e atëhershme dhe që e kanë ndjekur të gjithë rilindasit e tjerë para dhe pas tij. Ai nuk hedh poshtë fenë si dogmë, por kërkon që ajo të heshtë, kur është çështja për bashkimin kombëtar, kërkon që vendin e parë dhe të pakontestuar ta ketë ideja kombëtare, të cilës duhet t'i binden t'i nënshtrohen të gjitha ndjenjat dhe bindjet e tjera, duke përfshirë dhe ato fetare. „Shqipëtari, — shkruan Samiu, — është shqiptar para se të jetë mysliman a i krishterë”. Për t'i dhënë forcë bindëse më të madhe mendimit të tij, Samiu atë që kërkon ta arrijë e quan tashmë të arritur, dëshirën e tij e merr për realitet. Shqiptari, shprehet në mënyrë kategorike Samiu, „vë kombësinë para besës”.

Në këtë qëndrim të Samiut, të drejtat e fesë cungoheshin dhe kjo nuk mund të mos sillte në dobësimin e saj. Prandaj lufta e Samiut dhe e rilindasve për çlirim kombëtar ishte, në një farë mase, dhe një luftë kundër fesë. Nga gjithë betejat ideologjike dhe praktike që po të zhvilloheshin në emër të unitetit kombëtar dhe të çlirimit kombëtar feja do të dilte e dobësuar dhe e zvogëluar, por sigurisht ende e pamposhtur. Lufta për çlirimin kombëtar, në kushtet kur prona private nuk preket dhe privilegjet klasore

ruhen, nuk kërkon mohimin e fesë, nuk çon në ateizëm. Në ateizëm çon një përvojë tjetër më radikale, përvoja e luftës për çlirimin shoqëror dhe emancipimin e plotë të punonjësve nga zgjedha materiale dhe shpirtërore e klasave shfrytëzuese. Është e kuptueshme se qëndrimi i Samiut ndaj fesë historikisht është i justifikuar dhe objektivistisht përparimtar.

Një ide, që të zërë vend dhe të përhapet, nuk mjafton vetëm të shpallet. Duhet që ajo dhe të argumentohet. Për ta bërë më bindëse kërkesën e tij që feja të mos bëhet pengesë për bashkimin kombëtar, që shqiptari kombësinë ta vërë para besës, Samiu kujton historinë e popullit shqiptar dhe bën krahasimin e saj me atë të popujve të tjerë. Ai vëren se populli shqiptar me të vërtetë është i ndarë në fe të ndryshme, por ai asnjëherë në historinë e tij, ndryshe nga shumë popuj të tjerë, nuk ka luftuar dhe nuk është gri dur për motive fetare. Netë të Shën Bartolomeut shqiptarët nuk kanë ditur se ç'janë. „Shqiptari, — shkruan Samiu, — nuk njih grindjet e fesë dhe luftërat e përgjakshme fetare që kanë njohur popujt e Lindjes dhe të Perëndimit”.

Samiu vetëm i vëren këto tipare të veçanta të zhvillimit të historisë së popullit tonë, por nuk i shpjegon. Fetë që ekzistonin, në Shqipëri ishin një produkt importi, një element imponimi, një faktor shoqëruës i pushtimit dhe në ndihmë të tij. Kjo është dhe arsyeja që populli ynë ruante në thellësinë e shpirtit mosbesimin ndaj tyre dhe nuk ka marrë rrugën e gjakderdhjes vëllazërore drejt së cilës ato e shtynin.

Tipari i veçantë i zhvillimit historik të vendit tonë, mungesa e gjakderdhjes fetare, që konstaton Samiu, merrte një rëndësi të veçantë për çështjen kombëtare. Shqiptarët nuk janë grindur dhe nuk kanë luftuar asnjëherë midis tyre për punë feje, pse duhet të grinden dhe të luftojnë sot, kur u duhet më tepër se kurrë të jenë të bashkuar dhe në një mendje? Argumenti ishte bindës. Samiu me të drejtë e

vinte këtë në dukje dhe e pasuronte kështu arsenalin ideologjik të luftës për çlirimin kombëtar.

Realizimin e unitetit kombëtar Samiu nuk e sheh thjesht si një pacifist, nuk mendon ta arrijë me lutje, por nëpërmjet luftës politike. Ai, para se të jetë propagandist, është luftëtar dhe, si i tillë, u nënshtrohet rregullave të luftës politike. Në emër të unitetit kombëtar ai kritikon dhe dënon pushtetin osman dhe veprimtarinë shoviniste. Në emër të tij ai kritikon dhe dënon edhe ata shqiptarë që bëjnë lodrën e armikut. „Ai shqiptar, — shkruan ai, — që le vëllezërit e tij, duhet të vështrohet si armik dhe jo si shqiptar”. Në një vend tjetër këtë e shpreh akoma më qartë: „Kush të na qëndronjë përpara e të na ndalonjë në këtë udhë të shënjtuarë, ta shtyjme, ta shkelim e të shkojmë tutje!”. Është fakt se një popull, që lufton për çlirimin e tij, detyrohet të luftojë jo vetëm kundër pushtuesve, por edhe kundër atyre bashkëqytetarëve të tij, që degjenerojnë dhe bëhen vegla të pushtuesve. Kësaj lufte i shmanget as Samiu, i cili paralajmëronte shqiptarët për këtë rrezik dhe për nevojën e kësaj lufte.

Uniteti kombëtar nuk mund të vinte vetvetiu, as të realizohej vetëm nëpërmjet luftës ideologjike. Ai kërkonte dhe një organizim të shëndoshë. Nuk mjafton që njerëzit të jenë në një mendje, duhet dhe të përpiqen e të luftojnë në një front. Pa një organizim përkatës, kjo nuk mund të bëhet. Idetë materializohen dhe e tregojnë të gjithë forcën e tyre nëpërmjet organizimit të njerëzve, të klasave, të popujve. Kësaj logjike i përmbahet edhe Samiu. Atje ku flet për unitetin kombëtar, ai e vazhdon arsyetimin më tej dhe shtron nevojën e krijimit të një organizate të të gjithë popullit apo, siç e quan ai, nevojën e krijimit të një lidhjeje. „Të bëjmë, — shkruan ai, — një lidhje a një bashkim që të pushtojë të gjithë Shqipërinë”.

Si do të bëhej kjo lidhje, ç'formë do të merrte ajo, ç'rregulla do ta drejtonin jetën e saj? Për të gjitha këto Samiu nuk thotë gjë në veprën e tij. Ai nuk thotë gjë, ndoshta sepse e mendonte këtë punë pak a shumë në frymën e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si dhe të atyre të Lidhjes së Pejës më 1899 dhe nën prizmin e përvojës së tyre. Pikërisht nën ndikimin e këtyre ngjarjeve. Samiu, kësaj organizate të ardhme të popullit shqiptar, ia vinte emrin „lidhje”. Gjithnjë nën ndikimin e këtre ngjarjeve, kësaj lidhjeje ai i jepte jo vetëm funksionet e organizimit të popullit shqiptar, por edhe ato të pushtetit, të qeverisjes. „Lidhja, — shkruan Samiu, — të qëndrojë dhe të mbajë vënd qeverie në Shqipëri”. Kjo është po ajo ide për të cilën Samiu me aq entuziazëm e vinte në dijeni De Radën më 1881. „Lidhja, shkruante në këtë kohë Samiu, mori emrin e kuvernos së përdorme¹⁾ edhe përzuri kuvernatorëtë turq nga gjithë vilaet'i Kosovësë dhe nga Prizreni, nga Gjakova, nga Tetova, nga Dibra etj”.

Unitet pa dallim feje, i materializuar në një organizatë apo lidhje politike, që duhej të udhëhiqte luftën e popullit shqiptar dhe që në zjarrin e luftës duhej të shndërrohej në një qeveri të pavarur — këto ishin elementet më të rëndësishme, që duhej të përbënin, sipas Samiut, përmbajtjen e lëvizjes shqiptare. Kjo ishte perspektiva drejt së cilës ai i ftonte shqiptarët, një perspektivë e qartë dhe e gjerë.

Shpëtimi i Shqipërisë është në dorë të shqiptarëve

Të gjitha të dhënat mbi të cilat mbështetej Samiu për zgjidhjen e problemit të çlirimit kombëtar, e gjithë perspektiva që ai i çelte, çonin në mënyrë

¹⁾ Qeveri e përkohshme.

të natyrshme në një konkluzion të vetëm, në konkluzionin se forca që do të ishte në gjendje të zgjidhte të gjitha këto detyra dhe të çlironte Shqipërinë ishte populli shqiptar. Ai dhe askush tjetër do të ishte autori i çlirimit të tij. Këtë ai e shpallte në mënyrë të qartë dhe të prerë: „Shpëtimi a humbja e Shqipërisë është në dorë të shqipëtarëve”. Këtë ai mundohet ta argumentonte në faqe të tëra të veprës „Shqipëria ç’ka qënë...”.

Shumë shtete kishin dalë në hartën e Evropës nga diktati dhe vullneti i fuqive të mëdha, nga loja e kontradiktave midis tyre. Gjithnjë nga kjo lojë shumë shtete të tjera ishin bërë dhe ishin çbërë, ishin zmadhuar apo ishin zvogëluar. Në lojën e „diplomacisë së madhe”, të drejtat e popujve katandiseshin shpesh në monedhë shkëmbimi.

Për t’u bindur për këtë të vërtetë, nuk duhej shkuar shumë larg, mjafton të hidhe vështrimin dhe të shihje se ç’bëhej me fqinjët përçark. Qafqet shoviniste të vendeve të ndryshme ballkanike ishin lidhur me njëri-njëri apo me tjetrën fuqi të madhe, kishin hyrë në sferën e influencave të tyre dhe, me ndihmën e tyre, synonin të zmadhoheshin në dëm të shoqi-shoqit.

Bile, që në hapat e saj të parë, veçanërisht gjatë ngjarjeve të lidhura me Kongresin e Berlinit dhe vendimet e tij, lëvizja kombëtare shqiptare u ndesh me diktatin e fuqive të mëdha si dhe me lakmitë e shteteve ballkanike që ishin lidhur me to. Ndeshja ishte brutale. Populli ynë në pësimet e tij merrte një mësim të mirë politik, mësimin se shpëtimin nuk duhej ta priste nga të tjerët, por vetëm nga vetvetja.

Këtë mësim e formulonte dhe e shpjegonte Samiu në veprën e tij; për këtë kërkonte ai t’i bënte shqiptarët të ndërgjegjshëm. Samiu e shihte gjendjen e marrëdhënieve midis shteteve kapitaliste pa syza, pa pikën e iluzionit. Ai i hynte asaj në thelb dhe, me

një realizëm të rrallë, zbulonte natyrën e vërtetë, natyrën prej egërsire të pangopur të shteteve kapitaliste. „Në Kombësi, — shkruan ai, — s'ka miqësi, si s'ka në lodretë, cilido vëhtron të fitonjë vetë e të hajë shoknë. Kombet janë si peshqit që hanë njëri-tjetrin. Mjerë kush është i dobët!“. Përfundimi i Samiut „mjerë kush është i dobët“ nuk ishte një thirrje për mëshirë, nuk ishte nënshtrim apo pajtim me gjendjen, por një britmë zemërimi kundër parimeve prej ujku që drejtonin politikën e jashtme të shteteve borgjeze të Evropës dhe një mësim politik për bashkëatdhetarët e tij.

Në këto rethana për popujt, sipas Samiut, vlen po ai rregull që vlen dhe për njerëzit. Popujt si dhe njerëzit kanë atë çmim që i japin vetvetes, çmim, i cili nuk buron nga dëshirat e tyre, por nga fuqia dhe aftësia e tyre për vetëmbrojtje dhe vetëkonfirmim. „Njeriu, po të jetë i lik dhe i dobët, — mëson Samiu, — të gjithë i hipin sipër, jo vetëm armiqtë, por edhe miqtë“. Ai e vazhdon këtë ide dhe e jep në një figurë që stigmatizon si duhet parimet prej ujku që sundojnë jetën në shoqërinë borgjeze dhe marrëdhëniet midis shteteve borgjeze: „Armiku do të të marrë lëkurën dhe miku robën“.

Kjo situatë e kishte në vetvete një konkluzion, të cilin shpejtonte ta bënte dhe vetë Samiu. Për t'i bërë ballë armikut dhe për t'u mbajtur dorën dhe miqve „ne, — shkruan Samiu, — duhet ta mendojmë mirë punën tonë e të përpiqemi vetë për punë të vet, se në këtë jetë secili përpiqet për vete“.

Mësimi politik i „përpjekjeve të secilit për vete“ që argumentonte Samiu në veprën e tij, kishte rëndësi jetike për popullin shqiptar. Sa më thellë të kuptohej ai nga shqiptarët, sa më mirë të realizohej ai në jetë aq më e sigurt do të ishte dhe vetë çështja e çlirimit kombëtar dhe e shpëtimit të Shqipërisë.

Mësimi politik i Samiut i „përpjekjeve për vetë” e tregoi të gjithë vështirësinë dhe vlerën e vet në tallazet e luftës së popullit shqiptar për liri dhe pavarësi.

Ai që lufton për të drejtën është dy herë trim

Armata e fuqishme, që zotëron një ushtri kur hiqhet në luftë, është arma ideologjike, është bindja në drejtësinë e luftës së saj. Prandaj, sa herë që një klasë shoqërore, një popull ose një shtet fillon luftën, gjëja e parë që ia bën është të provojë drejtësinë e saj, të bindë për këtë forcat njerëzore që do të hedhë në luftë.

Samiu, si udhëheqës dhe organizator i luftës çlirimtare të popullit tonë, nuk mund të linte mënjatë çështjen e natyrës së saj të vërtetë dhe e bënte këtë në mënyrë krejt të ndërgjegjshme, i bindur se forca dhe pathyeshmëria e një lëvizjeje shoqërore ose e një lufte shoqërore qëndron në drejtësinë e saj. „Ay që lufton për një të drejtë është dy herë trim; e drejta i jep një forcë dhe një fuqi që s’e le kurrë të mundetë, por e bën njeriun të muntajnë dhjetë!” Ky është një konkretizim shumë i bukur, i marrë në një kontekst të caktuar historik, i parimit të rëndësishëm të shkencës shoqërore, sipas të cilit „idetë bëhen forcë materiale, kur ato përvetësohen nga masat.”

Samiu nuk e kënaqte shtruarja e përgjithshme e problemit se drejtësia përbën forcë. Ajo që i duhej atij ishte të provonte se kjo drejtësi ishte në anën e popullit shqiptar dhe se, rrjedhimisht, ky ishte i pathyeshëm në luftën e tij për liri dhe mëmëdhe. „Nuk ka më të shëntëruar të drejtë, — shkruan Samiu, — se kombësia, gjuha e mëmëdheu për një komb”.

Përpjekjet për të argumentuar drejtësinë e çështjes shqiptare, lufta për të formuar dhe farkëtuar

ndërgjegjën kombëtare të popullit shqiptar nuk bëheshin për herë të parë nga Samiu. Në to kishin provuar forcat me dhjetëra shkrimtarë patriotë, si Naum Veqilharxhi, Pashko Vasa, Jani Vretoja, Naim Frashëri. Samiu në këtë çështje ishte më tepër një vazhdues se një pionier. Por një vazhdues në kuptimin më të mirë të fjalës, një mendimtar, që, duke u mbështetur në shpatullat e paraardhësve dhe të bashkkoheëve, shih-te më larg se ta dhe sillte elemente të reja në zgjidhjen e problemit të shtruar. Vepra e Samiut „Shqipëria ç’ka qënë...” ishte kateqizmi i kombësisë shqiptare, traktati më i rëndësishëm i problemit shqiptar për kohën e vet. Në të janë mbledhur të gjitha të dhënat dhe argumentet themelore, që provojnë se ka një komb shqiptar që jeton dhe që, në mënyrë të pandalshme, shkon drejt lirisë dhe pavarësisë së tij.

Shqiptarët — një komb i lashtë

Provën e parë dhe më të rëndësishme të ekzistencës së kombit shqiptar, sigurinë e rilindjes së tij të pashmangshme, Samiu e shihte në historinë e tij. Kësaj çështjeje ai i kushtonte dhe njëerën prej tri pjesëve të librit të tij.

Një komb nuk mund të lindë papritur, as mund të krijohet artificialisht. Elementet që e përbëjnë kërkojnë shekuj që të formohen. Kombi merr buri-met e tij në histori.

Me historinë e fillon analizën Samiu. Në të ai gjen lashtësinë e popullsisë shqiptare. „Shqiptarët, — shkruan ai, — janë një komb i lashtë që vjen nga pellazgët”. Hipoteza pellazgjike nuk ishte një shpikje e Samiut. Ajo ishte hedhur nga shkencëtarë të shquar evropianë dhe ishte kapur pastaj dhe për- vetësuar nga gjithë Rilindja Shqiptare. Shkenca historike atëherë idenë pellazgjike nuk e shpjegonte me të dhëna të sakta. Ajo kishte mbetur në nivelin e

hipotezës. Për rilindasit dhe Samiun argumentimi shkencor i hipotezës pellazgjike nuk kishte ndonjë rëndësi të veçantë. Ata e shihnin çështjen më shumë si politikanë sesa si shkencëtarë. Atyre nuk u premtonte koha t'i përvisheshin punës dhe të hynin në studime dhe në analiza të hollësishme për të parë sa e vërtetë ishte hipoteza pellazgjike. Ata e merrnin këtë si të provuar, e shpallnin me bindje si një provë në të mirë të lashtësisë së popullit shqiptar, duke ua lënë brezave të ardhshëm ta hetonin këtë çështje më thellë dhe të gjenin argumentet në mbrojtje të saj.

Populli shqiptar — një popull i pathyeshëm

Historia e një kombi nuk është vetëm lashtësia e tij. Ajo është dhe jeta e tij, janë peripecitë nëpërmes të cilave ai është detyruar të kalojë gjatë shekujve, janë rreziqet, që i është dashur të kapërcejë në luftën për të mbrojtur veten dhe për të përparuar në rrugën e zhvillimit, janë veprat e mëdha materiale dhe kulturore, që kanë krijuar bijtë e tij më të mirë dhe ua kanë lënë trashëgim pasardhësve. Me këtë mbahet gjallë dhe ushqehet krenaria e një kombi, që nuk e le një komb të bjerë, që i shtyn bijtë e tij ta ruajnë dhe ta ngrenë lart e më lart pasurinë që u kanë lënë të parët.

Në një perspektivë të tillë e shihte Samiu historinë e Shqipërisë dhe zbulonte në të vlera, të cilat i bëjnë nder çdo kombi. Ajo që tërheq vëmendjen e tij në radhën e vlerave dhe që mundohet ta nxjerrë në pah është aftësia e popullit shqiptar për t'u qëndruar agresorëve dhe për të ruajtur identitetin e tij edhe në kushtet më të vështira.

Në përvojën shumëshekullore historike të popullit tonë, në historinë e tij plot rrebeshe Samiu zbulonte dy karakteristika: së pari, se populli shqiptar nuk është trembur asnjëherë dhe i ka rezistuar çdo

lloj agresori, sado i fuqishëm që të ketë qenë ai. Samiu, në të mirë të kësaj teze, përmendte rastin e Ilirisë dhe të Epirit, dmth të Shqipërisë, që i qëndruan Aleksandrit të madh, i cili nuk mundi t'i shtinte plotësisht në dorë, atë të Teutës, mbretëresha e Ilirisë dhe Gencit, bir i saj, që u qëndruan kaq kohë burrërisht romakëve; atë të Skënderbeut, që, në krye të popullit shqiptar, u qëndroi për 25 vjet rresht pushtuesve turq.

Së dyti, se populli shqiptar, ndonëse i mundur, nuk e ka humbur asnjëherë identitetin e tij, se ai nëpërmjet kohëve të egra, ka ditur të ruajë gjuhën, si dhe veçori të tjera esenciale kombëtare. Për shqiptarët në kohën e romakëve Samiu shkruan: „shqiptarët, sado q'u muntne e u vranë, nuk u poshtuan e s'u bënë robër”; kurse për shqiptarët në kohën e pushtimit osman ai shkruan: „shqiptarët e kanë mbajtur gjuhën e kombërinë e tyre jo me shkronja, as me dituri, as me qytetari, por vetëm me dliri, me të qënë gjithnjë vetëm e më vete, me të mos përzjerë me të tjerë e me të mos kallurë të huaj në vendet e tyre”.

Të dy karakteristikat, që zbulonte Samiu në historinë e popullit shqiptar dhe që ai i theksonte në mënyrë të veçantë, sillnin me vete konkluzionin, i cili, për Samiun dhe për gjendjen e Shqipërisë në atë kohë kishte rëndësinë vendimtare: një popull, që nëpërmasë kaq tallazesh, nuk është mposhtur përfundimisht dhe ka ditur të ruajë identitetin e tij, është i pathyeshëm. Ai ka të drejtën e ekzistencës si komb më vete si dhe mundësinë për ta realizuar këtë të drejtë.

Me gjuhën mbahet gjallë kombi

Një nga tiparet që përbën kombin, ajo që i bashkon njerëzit në një tërësi të vetme kombëtare dhe që i dallon ata nga tërësitë e tjera kombëtare është

gjuha. Çdo komb ka gjuhën e vet. Nëpërmjet saj ai merr ndërgjegje për vetveten. Sa kohë që një komb ruan gjuhën, ai i ka të gjitha mundësitë të mbahet gjallë dhe t'u qëndrojë rrebesheve që mund ta kërcënojnë.

Rëndësia e madhe që merrte gjuha për fatet e kombit e kishte nxjerrë atë në plan të parë, e kish-te vënë në qendër të agjitacionit politik dhe të veprimit revolucionar të të gjithë lëvizjes patriotike çlirimtare shqiptare të shekullit XIX. Rreth gjuhës së shkruar shqipe dhe përhapjes së saj ishin zhvilluar dhe zhvilloheshin beteja të ashpra, të cilat nuk kufizohehin në planin kulturor, gjuha si mjet kulture dhe arsimit, por kalonin menjëherë dhe vazhdimisht në planin politik, gjuha si mjet i afirmimit të kombit shqiptar. Nëpërmes betejash të vërteta politike, nëpërmes pengesash, vështirësish dhe ndjenjash të çdo lloji të nxjerra nga pushtuesit osmanë dhe shovinistët fqinjë, rilindasit shqiptarë e kishin mbrojtur çështjen e gjuhës shqipe dhe e kishin çuar përpara në shumë drejtime: në përgatitjen e alfabetit, në hartimin e abetareve dhe gramatikave, në keizimin e revistave dhe gazetave, në çeljen e shkollave në gjuhën shqipe. Nëpërmjet punës së palodhur, nëpërmjet talentit dhe guximit të pashoq të brezave të tërë të rilindasve, të Naum Veqilharxhit, Zef Jubanit, Pashko Vasës, Jani Vretos, Naim Frashërit, Pandeli Sotirit, Koto Hoxhit, Petro Luarasit, Kristo Negovanit gjuha shqipe njihte një jetë të re, një lulëzim të panjohur më parë.

Por ai që ngrihet mbi të gjithë këta emra, ai që me erudicionin e tij, me energjinë e tij, me patriotizmin e tij ka sunduar gjithë lëvizjen politike për shkrimin e gjuhës shqipe dhe përhapjen e saj është Sami Frashëri. Ai organizoi dhe udhëhoqi „Shoqërinë e Stambollit për shkrimin e shkronjzave shqipe”, ai përgatiti dhe botoi abetaren dhe gramatikën shqip më të mirë të kohës, ai u bë iniciatori dhe frymëzuesi

i botimit të librave dhe të revistave në gjuhën shqipe, ai ishte në themel të organizimit të shkollës së parë shqipe. Gjuha shqipe i detyrohet shumë Sami Frashërit si një lëvrues dhe propagandist i palodhur. Vepra „Shqipëria ç'ka qënë...” e botuar në vitet e fundit të jetës është një vazhdim dhe një kurorëzim i luftës së gjatë, të pandërprerë asnjëherë, që kishte zhvilluar Samiu për gjuhën shqipe dhe çështjen kombëtare shqiptare.

Samiu, qysh në faqet e para të librit, e thekson dhe pastaj e përsërit në faqe të tëra si një aksiomë të të gjithë lëvizjes çlirimtare kombëtare se pa gjuhë s'ka komb, pa gjuhë shqipe s'ka Shqipëri, se me të lidhet jeta apo shuarja e kombit shqiptar. „Shënja e kombësisë, — shkruan Samiu, — është gjuha, çdo komb mbahet me gjuhët”, dhe në një faqe tjetër: „S'mund të ketë Shqipëri pa shqipëtarë, s'mund të ketë shqipëtar pa gjuhë shqipe, pa shkronja shqipe e pa shkolla...”. Fushën e lavrimit dhe të përhapjes së gjuhës shqipe ai e shihte si një nga fushat kryesore ku lëvizja çlirimtare shqiptare duhet të tregonte të gjithë gjallërinë e saj dhe t'u shkaktonte disfatën armiqve të saj”. „Mrodhësi e shkronjave shqip, — shkruan Samiu, — është vdekje për armikët e kombësisë sonë”.

Në luftën për afirmimin dhe lartësimin e gjuhës shqipe Samiu vë në dukje se ajo është një gjuhë e lashtë, një gjuhë që zë fill në thellësinë e shekujve dhe që, për këtë, mund të krahasohet me gjuhë të tilla të lashta si greqishtja dhe latinishtja. Në këtë plan arsyetimi Samiu thekson se gjuhën e tij të lashtë populli shqiptar e ka ruajtur dhe e ka nxjerrë të paprekur nëpërmes peripecive dhe rreziqeve të panumërtëta që i rezervoi atij historia. Në lashtësinë e saj Samiu shihte një titull krenarie për gjuhën shqipe. Në ruajtjen e saj të paprekur gjatë tallazeve të shekujve ai shihte një shenjë vitaliteti të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar që e fliste. Samiu shkruan plot bindje se „shqiptarët flasin një nga më të vjetërat e më

të bukuratë gjuhë të dheut", se „shqipja gjuha jonë... është e gjallë e flitetë edhe sot si në kohët e pellazgëve”.

Autorët, që kanë redaktuar botimin e vitit 1962 të veprës së Samiut, vërejnë se „ky pohim i Sami Frashërit është i tepëruar, mbasi me kalimin e kohës gjuhët zhvillohen... Nuk mund të thuhet se shqipja flitet sot si në kohën e ilirëve dhe, më pak akoma, si në kohën e pellazgëve”. Po të merret pohimi i Samiut në kuptimin literal vërejtja është me vend, por po të merret ai si një theksim i lashtësisë së gjuhës shqipe, i vitalitetit të saj, e vërteta është në anën e Samiut. Zmadhimi, hiperbolizimi është një metodë gjerësisht e përdorur nga shkrimtarët apo propagandistët për të vënë në dukje atë që është karakteristike për një fenomen apo për një situatë të dhënë. Këtë bën dhe Samiu për të treguar më mirë lashtësinë e gjuhës shqipe. Nga ana tjetër, s'ka sesi të dyshohet që Samiu nuk e njihte evolucionin e gjuhëve, kur dihet se ai në studimin e tij „Gjuha — lindja, zhvillimi dhe dekadencia e saj” dhe në studime të tjera është mbrojtës i parimit evolucionist të gjuhëve dhe me këtë parim është munduar të shpjegojë shumë probleme të gjuhësisë. „Gjuhët, — shpjegon aty Samiu, — kanë jetën e tyre. Dhe gjuha, ashtu si njeriu, lind, jeton e vdes”. Këtë parim ai e shpall më tej akoma më qartë: „...bile gjuha ndryshon aq shumë gjatë shekujve sa na bëhet të mos e njohim”.

Gjuha shqipe, megjithëse e lashtë, në atë kohë ishte e pashkruar dhe e palëvruar sa duhet. Në këtë Samiu me të drejtë shihte rrezikun më të madh për gjuhën shqipe dhe për popullin shqiptar. Gjuha mbahej me shkronja, shpjegon Samiu, dhe arrin në përfundimin se „një gjuhë e pashkruar s'mund të qëndrojë shumë kohë e paprishurë”. Ai u kujton shqiptarëve se ato kushte historike, që u lejuan atyre të ruanin gjuhën gjatë shekujve, janë duke u zhdukur. Me zhvillimin e kapitalizmit populli ynë do s'do duhet të dilte nga izolimi mesjetar dhe të hynte në

kontakt me popujt e tjerë dhe vështirë se gjuha e tij, duke mbetur e pashkruar dhe duke mos u bërë vegël e diturisë dhe e shkencës, do të mund t'i bënte ballë presionit të gjuhëve të tjera.

Për më tepër, rreziku i humbjes së gjuhës shqipe nuk ishte një rrezik i mundshëm, por një rrezik real, një e keqe e ditës. Nuk ishte e fshehtë për asnjëri, aq më pak për Samiun, se shovinistët „të parën e punës kanë të na bëjnë të harrojmë gjuhën tonë, të mësojmë të tyrenë”. Shovinistët grekë, paralajmëronte Samiu, po bëjnë çmos që t'ia arrijnë këtij qëllimi duke vepruar „në nj'anë nga Athina me shkolla, me mësonjës, me libra, me shëronjës dhe me shumë gjëra të tjera edhe me të holla të tepëra dhe me nj'anë tjetër nga Konstantinopoja me anët të patrikësisë, të dhespotëve, të priftërinjve të kishës, duke përdorur aforismonë e të dëbuarët nga kisha...”. Prandaj mjeti më i mirë, mëson Samiu, për t'u bërë ballë orvatjeve asimiluese dhe likuidatore të këtyre armiqve dhe për të afirmuar kombësinë shqiptare është përhapja e gjuhës së shkruar shqipe.

Pse kishte mbetur gjuha shqipe e pashkruar dhe e palëvruar? Pse nuk ishte bërë ajo një gjuhë diturie dhe shkence? Mos vallë e kishte fajin për këtë vetë gjuha? Pyetjes së fundit Samiu i përgjigjet në mënyrë negative. Këtu nuk është faji i vetë gjuhës, por në radhë të parë, yni, i shqiptarëve, „në ka mbetur gjuha shqip e pashkruarë, — thekson Samiu, — s'ka mbetur se është gjuhë e ligë e e metë, po vetëm se s'jemi kujdesur ne ta shkruajmë. S'na ka faj gjuha, faji është i yni”.

Pohimi i Samiut se „i gjithë faji është i yni” ishte deri diku i thjeshtësuar, por politikisht i drejtë dhe shumë me vend. Ishte i thjeshtësuar, sepse faji nuk ishte i shqiptarëve, por kryesisht i një kompleksi të tërë rrethanash të pafavorshme, nëpër të cilat ishte zhvilluar historia jonë. Politikisht ishte i drejtë dhe

shumë me vend, sepse nuk ishte koha e arsyetimeve akademike apo ajo e ankimeve ndaj padrejtësive të historisë, por ajo e veprimit imediat në mbrojtje dhe përhapje të gjuhës, iniciator dhe autor i të cilit mund të ishte vetëm populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij më të mirë.

Pohimi i Samiut se për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe gjithçka varet nga ne, mbështetet gjithashtu në përvojën 20-vjeçare të punës dhe të luftës së patriotëve shqiptarë në këtë fushë. Sukseset e kësaj pune ishin të mëdha, vlera e kësaj përvoje dukej në shumë drejtime. Ajo provonte, së pari, se gjuha shqipe mund të shkruhet fare mirë; së dyti, se ajo mund të mësohet dhe të përvetësohet më lehtë dhe më shpejt se shumë gjuhë të tjera; së treti (kjo e gëzonte mbi të gjitha Samiun), me gjuhën shqipe mund të shprehen ndjenjat më të holla dhe konceptet më abstrakte, ose e thënë kjo më thjesht, me të mund të mësohen të gjitha dituritë. „Shqipja, — shkruante Samiu, — sot nuk është një gjuhë e pashkruarë si që njëzet vjet më parë; sot ajo është një gjuhë që shkruhet e kërkohet, edhe nga më të bukurat. Ndonjë gjuhë s'këndohet aqë lehtë e aqë mirë sa shqipja”.

Në formimin e tij ideofilozofik Samiu ishte bir i shekullit të dritave. Në planin e përgjithshëm social ai i përmbahej parimit se shpëtimi i shoqërisë, përparimi i njerëzimit qëndron në përhapjen e diturisë dhe në përsosjen morale të njerëzve. Ky është koncepti i përgjithshëm sociologjik që qëndron në themel të të gjithë punës së Samiut për krijimin e Enciklopedisë së tij të famshme, për hartimin e serisë së broshurave për popullarizimin e njohurive shkencore, për formulimin dhe propagandimin e atyre mijëra aforizmave dhe fjalëve të urta, që janë një margaritar i mendjes së tij të ndritur dhe i botëkuptimit të tij përparimtar. Është gjithnjë ky koncepti i përgjithshëm sociologjik si dhe kërkesa e emancipimit kultu-

ror dhe politik që buronte prej tij që e nxirrte Samiun në mënyrë të natyrshme në problemin e gjuhës shqipe dhe të shkrimit të saj.

Gjuha është mjeti i parë dhe i pazëvendësueshëm i zhvillimit mendor dhe shpirtëror të një populli. As që mund të bëhet fjalë për përhapjen e diturive në një popull dhe për zhvillimin e tij shpirtëror, kur nuk i lejohet të përdorë gjuhën e tij amëtare, kur atij i mbyllet dhe atë pak shkolla fillore që ka. Samiu plot zjarr i bën thirrje popullit shqiptar që të shkundë „gjumin e mefshtësisë dhe të paditurisë”, se ndryshe „jemi të humburë”. Kuptohet vetvetiu se ai, po me atë zjarr, do të bëjë thirrje dhe do të kërkojë krijimin e mjetit të këtij zhvillimi — gjuhës së shkruar shqip.

Përpjekjet e Samuit për krijimin e gjuhës së shkruar shqipe kanë pra në themelin e tyre dy stimuj të fuqishëm, që ishin që të dy jetikë për popullin shqiptar, atë të afirmimit të ndërgjegjës kombëtare dhe atë të zhvillimit të tij kulturor.

Nevoja e farkëtimit të një ndërgjegjeje kombëtare dhe e përhapjes së diturive në popullin shqiptar që kishin që të dyja një vegël të vetme, gjuhën, kanë qenë të dy arsyet kryesore që e kanë bërë Samiun aq të ndjeshëm ndaj gjuhës dhe problemeve të saj. Ato e kanë shtyrë të merret në themel me problemet e gjuhës dhe të tregojë atje, më tepër se kudo gjetiu, të gjithë talentin e tij. Përveç kontributit të tij në përpunimin e gjuhës së shkruar shqipe, Samiu, me studimet e tij dhe me fjalorët e tij, ka hyrë në historinë e shkencës si një teoricien i gjuhës përgjithësisht dhe si krijues i gjuhës së sotme letrare turke, veçanërisht. Të mos kishte qenë Samiu një patriot kaq i flaktë i vendit të tij, vështirë se do të ishte bërë një shkencëtar aq i shquar i gjuhës dhe i problemeve lidhur me të.

Nuk duam gjënë e tjetrit, por gjënë tonë s'e lëmë

Kombi formohet vetëm si rezultat i marrëdhënieve të vazhdueshme dhe të rregullta, si rezultat i jetës së përbashkët të njerëzve, brez pas brezi, për shekuj me radhë. Kusht themelor i marrëdhënieve të vazhdueshme dhe i jetës së përbashkët të njerëzve, krahas gjuhës së përbashkët, është dhe territori i përbashkët. Një komb, që të ekzistojë dhe të zhvillohet, ka nevojë për një territor të caktuar. Një komb pa një territor nuk mund të mendohet

Kur në rend të ditës doli çështja e pavarësisë kombëtare, së bashku me këtë, në rend të ditës doli dhe çështja e territorit në të cilin shtrihet kombësia shqiptare dhe për të cilin duhej kërkuar pavarësia.

Në çështjen e territorit të Shqipërisë, në atë të përcaktimit të tij, Samiu mendon dhe vepron si një burrë shteti, përgjegjës për fatet e kombit të vet. Me tokën amëtare nuk mund të luhet, ajo është e shenjtë. „Nuk duam gjënë e tjetrit, — shkruan Samiu, — por s'duam të lëmë dhe gjënë tonë e të drejtën sheshit të na i rrëmbejnë me pahir”. Parulla e Samiut „gjënë e tjetrit s'e duam, gjënë tonë s'e lëmë”, është parulla e një patrioti të vërtetë të vendit të tij. Nuk mund të mos e admirojmë Samiun për këtë sensibilitet të jashtëzakonshëm që tregon ndaj tokës amëtare dhe fateve të saj, për shembullin e lartë të patriotizmit dhe të qytetërisë që na jep ai me këtë qëndrim.

Por ky problem jetik nuk ishte i lehtë për t'u zgjidhur, përcaktimi i kufinjve të Shqipërisë nuk ishte i thjeshtë. Romakët me pushtimet e tyre, barbarët me dyndjet e tyre, otomanët me organizimet dhe riorganizimet territoriale, që kishin bërë gjatë pesëqind vjetëve të zgjedhës së tyre si dhe me zhvendosjen dhe përzierjen e popullsisë e kishin ngatërruar në kulm këtë problem. Kësaj ngatërrese të historisë i shtohet dhe ngatërresat

që sillnin me qëllim shovinistët fqinjë, të cilët synonin të zmadhoheshin në dëm të njëri-tjetrit dhe, në radhë të parë, në dëm të Shqipërisë dhe të territoreve të saj.

Duhej zhgatërruar lëmshi i ngatërruar nga historia, duheshin demaskuar pretendimet e shovinistëve fqinjë dhe të nxirrej në shesh e vërteta, të tregohesh se ç'i takonte Shqipërisë. Rrezikun e pretendimeve të tyre si dhe nevojën për të hedhur sa më shumë qartësi në çështjen e territorit të Shqipërisë, Samiu e kishte ndjerë qysh në vitet 70-të të shekullit XIX. Qysh atëherë, në faqet e gazetës së tij „Zëdhënësi i Lindjes” ai kërkonte që „... arnautllëku të përmblihet në një vilajet të ndarë nga sllavët dhe grekët...”.

Në fund të shekullit ky rrezik që parandiente dhe paralajmëronte Samiu, ishte kristalizuar më tepër, por dhe vizioni i tij rreth Shqipërisë dhe pavarësisë së saj ishte bërë më i qartë. „Duhet, — shkruan Samiu plot shqetësim për fatet e tokave shqiptare, — një orë e më parë të ndahet Shqipëria e të dihetë që ku e gjer ku është”.

Në përcaktimin e territorit shqiptar dhe të kufijve të tij Samiu u përmbahet dy kriterëve, kriterit historik dhe atij etnik. I udhëhequr nga kriteri historik Samiu Shqipëri quante gjithë territorin e banuar dikur nga ilirët dhe nga fiset e tjera jogreke — epirotasit dhe maqedonasit. Veçse Samiu, duke iu drejtuar historisë, ruan sensin historik dhe vëren që ky territor i lashtë, kaq i gjërë, me kalimin e kohës ka ndërruar popullsi, ilirët janë tërhequr. Prandaj, Shqipëri do të quhet vetëm ai vend ku sot për sot rrinë shqiptarët. Me këtë ai kalon nga kriteri historik në atë etnik, duke ia nënshtruar të parin të dytit.

Por dhe zbatimi i kriterit etnik nuk ishte në të gjitha rastet i thjeshtë dhe i qartë. Kishte krahina ku popullsia ishte thjesht shqiptare, por kishte të tjera ku popullsia ishte e përzier, ku së bashku me shqiptarët jetonin dhe popullsi me kombësi tjetër

— greke, serbe, vllahe apo maqedonase. Samiu quan shqiptare ato krahina, siç ishin vilajetet e atëhershme, ku shqiptarët përbënin një tërësi kompakte dhe shumicën e popullsisë.

Shqiptarët kanë të gjitha ç'u duhen për të dalë më vete

Në përpjekjet dhe arsyetimet për afirmimin e kombit shqiptar dhe zgjimin e ndërgjegjës kombëtare të shqipëtarëve, Samiut nuk i shpëton dhe një element kaq i rëndësishëm i kombit siç është fizionomia psikike, tiparet kombëtare. Në tiparet kryesore të shqipëtarëve Samiu dallon, në radhë të parë, trimërinë, qëndresën e tyre. „Trimërinë e shqiptarit, — shkruan Samiu, — ... nuk e themi vetëm ne shqiptarët, por dhe anëmikëtë tanë s'e pshehinë dot, e thonë përherë”. Trimëria e shqipëtarëve shoqërohet, sipas Samiut, me zgjuarësinë e tyre natyrore, me aftësinë për të përparuar në shkollë dhe në dituritë dhe, në fund, me zotësinë e tyre në zanatet e ndryshme dhe në bujqësi e blegtori. Shqiptari është i zoti në luftë e në paqë, në mësim e prodhim. Në kapitullin ku Samiu zbulon meritat e shqipëtarëve nuk harron të flasë dhe për vlerën e grave të Shqipërisë. „Shqiptarkat aq të hijëshme sa dhe të nderçime më tepër se burrat e tyre edhe, po thua, aqë trime sa edhe ata”.

Të gjitha këto, lashtësinë e popullit shqiptar, bukurinë e gjuhës së tij, madhështinë e natyrës së tij, trimërinë, mençurinë dhe zotërinë e tyre në çdo punë si dhe gratë e tyre të hijëshme, të nderëshme dhe trime, i analizon dhe i thekson për të nxjerrë konkluzionin qëndror të të gjithë veprës së tij: Shqiptarët kanë të gjitha ç'u duhen për të dalë më vete si komb dhe për të vajtur mbarë. Tiparet e kombit tonë, që dallonte Samiu, lidheshin dhe me marrëdhëniet ekonomike, në thelbin e tyre kapitalist, që

kishin filluar të lindin dhe të kristalizoheshin në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit XIX. Interesat e atyre forcave sociale që qëndronin prapa këtyre marrëdhënieve përbënin përmbajtjen e çështjes kombëtare shqiptare. Ato i jepnin një nxitje dhe e shtynin përpara lëvizjen çlirimtare kombëtare.

Me këto analiza dhe konkluzione Samiu zgjonte te populli i vet një ndërgjegje, ndërgjegjen kombëtare, frymëzonte një dinjitet, dinjitetin kombëtar, tregonte një rrugë, rrugën e luftës dhe të shpëtimit. Këto e bëjnë „Shqipëria ç'ka qenë..” një vepër të kulturës sonë dhe autorin e saj një emër gjithnjë të nderuar.

Drejt një qeverie mëmëdhetare

Në qoftë se provohej se ekziston një komb shqiptar, se populli shqiptar ka një atdhe të tijin, Shqipërinë, siç bënte Samiu në veprën e tij, atëherë si korolerë dilte se ky komb, kjo Shqipëri, ka të drejtën e lirisë dhe të pavarësisë.

Në kushtet e atëhershme liria dhe pavarësia kombëtare thjesht donte të thoshte që pushteti, qeverisja e vendit të kalonte nga aparati i pushtuesve në një aparat kombëtar. Çështja e pushtetit, e vetëqeverisjes bëhej çështje themelore.

Në periudhat revolucionare, që kërkojnë kalimin e pushtetit nga një klasë në tjetrën; problemet e pushtetit zënë avnskenën e studimeve sociologjike dhe të veprave teorike. Që të gjithë mendimtarët që përgatitën ideologjikisht përmbysjen e feudalizmit, Hobsi, Loku, Spinoza, Rusoi një vend kryesor të arsye-timeve të tyre u kanë kushtuar problemeve të pushtetit, të origjinës dhe të natyrës së tij. Që të gjithë këta, në një mënyrë apo në një tjetër, shkurorëzuan idenë e origjinës hyjnore të pushtetit dhe argumentuan atë të origjinës njerëzore të tij, të origjinës kontraktuale

midis pushtetmbajtësit dhe popullit. Nëpërmjet kësaj ideje ata vinin në kërkesën praktike që pushteti duhet të kalonte në duart e zotit të tij të vërtetë, në duart e popullit dhe, sa kohë që borgjezia në atë kohë dilte si përfaqësuesja e popullit, në duart e borgjezisë.

Probleme të kësaj natyre para Samiut dhe ideologëve të çlirimt kombëtar nuk dilnin për arsye se, së pari, këto konsideroheshin si teorikisht të zgjidhura, dhe, së dyti, se këto, në kushtet e Shqipërisë së asaj kohe, shtroheshin më thjesht. Çështja nuk ishte të zbulojë se ç'është pushteti dhe nga vjen ai, por të tregojë se pushtetmbajtësit janë të huaj, janë të ardhur me pahir dhe e ushtrojnë atë në kundërshtim me interesat më jetike të popullit. Kjo e vërtetë, që përbënte gjithë thelbin e problemit, ishte më e lehtë për t'u shpjeguar dhe më e thjeshtë për t'u kuptuar nga populli shqiptar. Kësaj vije i përmbahet Samiu në veprën e tij „Shqipëria ç'ka qenë...” „A do ta ngrënë shqiptarët zënë dhe të kërkojnë të drejtat e tyre apo do të përpiqen të mbajnë tiraninë e tyrqëve mbi kryet e tyre dhe të tjerëve kombe? Këtu është puna, kjo është gjithë çështja”. Dhe në një vend tjetër: „Ne ç'kemi me ta? (me tyrqit). A mos erdhmë me ta? Jo, kurrë! Ne sjemi as tyrq, as të ardhur nga shkretëtirat e Azisë. Ne jemi m'i vjetri komb i Evropës; kemi të drejtë në dhet të Evropësë më tepër se çdo komp”. E thënë pa asnjë dykuptim, në mënyrë të prerë, të kuptueshme për këdo që i dhimbsej sado pak liria dhe e mira e atdheut; tyrqit janë pushtues, janë të ardhur, prandaj duhet të largohen dhe t'ia lënë vendin zotit të vërtetë — shqiptarëve.

Kalimi nga arsyetimet abstrakte në masat konkrete është një nga kërkesat e çdo udhëheqjeje në kohë përmbysjesh dhe revolucionesh. Këtë bën dhe Samiu në çdo faqe të veprës së tij. Nga arsyetimi historik se populli shqiptar ka qenë dhe është zot në shekuj i Shqipërisë, kurse tyrqit janë të ardhur dhe pushtues, Samiu kalon në kërkesën praktike që

gjërat të vihen në vendin e tyre, që secili të mbajë atë që i takon.

Qëllimi i vetëm i shqiptarëve, mëson Samiu, duhet të jetë ruajtja e Shqipërisë dhe kjo do të arrihet nëpërmes vendosjes së një „qeverie mëmëdhetare, të një qeverie që të punojë pas nevojës e pas të drejtave të shqiptarëve. Një qeveri shqiptare me sy hapurë e jo qeveri e huaj e verbërë, si kjo q'është sot. Të jetë një qeveri si duhetë, pa le të ketë ç'emër të dojë”.

Kur klasat reaksionare apo shtetet robëruese kërcënohen në sundimin e tyre, atëherë në mbrojtje të tyre ato nxjerrin „përvojën” e tyre në pushtet dhe përhapin idenë se vetëm ato janë në gjendje të drejtojnë, kurse populli nuk është pjekur akoma për një gjë të tillë. Këtë pretendonin feudalët kur fshatarët ishin ngritur dhe u kërkonin lirinë dhe tokën: fshatarët nuk janë pjekur për lirinë dhe nuk do të dinë ta administrojnë! Këtë kanë pretenduar klasat reaksionare sa herë dhe kudo që masat popullore janë ngritur për lirinë dhe të drejtat e tyre: masat popullore nuk janë pjekur akoma për lirinë dhe të drejtat e tyre! Këtë e pretendonin ndaj shqiptarëve qoftë pushtuesit otomanë, qoftë pretendentët e tjerë për territoret e Shqipërisë. Samiu s'le asgjë nga i gjithë ky pretendim dhe, me arsyetimet e tij, provon se populli shqiptar ka edhe të drejtën të jetë zot i vendit të tij, edhe mundësinë që ai ta administrojë si duhet dhe ta futë në rrugën e përparimit. „Shqipëtarët, — shkruan Samiu, — janë të zgjuarë e të mënçëm, kanë nxënie të madhe për qytetëri e për çdo farë diturije; janë trima e ushtarë të çquarë”. Ai nxjerr konkluzionin që duhet të ngrinte lart zemrat e shqiptarëve dhe t'u hapte perspektiva në luftën e tyre: „shqipëtarët kanë gjithshka që duhetë të ketë një komb për të vajturë mbarë”.

Ndonjërit mund t'i ngjallë pikëpyetje një pohim që bën Samiu në veprën e tij që shqipëtarët të kenë qeverinë e tyre, por që kjo qeveri sot për sot të jetë

nën Turqinë. Me të drejtë mund të bëhet pyetja: si është e mundur që një mbrojtës i tillë i lirisë dhe i pavarësisë së Shqipërisë të kërkojë të qëndrojë akoma nën Turqinë? Mos kemi të bëjmë me një patriot të moderuar dhe të lëkundur që mbetet në mes të rrugës? Një konkluzion i tillë do të ishte i shpejtuar dhe i pathemeltë.

Kërkesa e Samiut që qeveria kombëtare shqiptare të jetë sot për sot nën Turqinë është një mënyrë të thëni apo një tjetër thënie e idesë së autonomisë që kishte zënë rrënjë në lëvizjen çlirimtare qysh para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe që kishte prapa saj një përvojë të caktuar dhe në historinë e kombeve të tjerë të Ballkanit. Siç dihet, qoftë rumunët, qoftë bullgarët, qoftë serbët arritën në pavarësinë e tyre duke kaluar nëpër autonominë, jo si një pikëmbërritje, por si një fillim, si një stacion për të arritur në liri dhe pavarësi. Fjala „sot për sot” që fut Samiu në këtë frazë është plot kuptim dhe tregon më së miri qëllimin e tij të fundit.

Së dyti, Samiu nuk ushqente qoftë dhe iluzionin më të vogël se Perandoria Osmane do të mund të mbahej për shumë kohë. Ditët ajo i kishte të numëruara, prandaj për shqiptarët, sipas mendimit të Samiut, nuk kishte ndonjë rëndësi të madhe, do të ishte qeveria e tyre më vete apo në ndonjë mënyrë a në një tjetër e lidhur me Turqinë. Puna tregon, — shkruan Samiu, — se Tyrqia, në këtë udhë që ka zënë, nuk rron dot edhe shumë kohë; pa le që n’Evropë e ka jetënë të shkurtërë”.

Samiu as që ushqente ndonjë iluzion për gjallërimin e mëtejshëm të Perandorisë Osmane dhe, ç’është më e rëndësishmja, as që e dëshironte një gjë të tillë. Më tepër ai dëshironte dhe paralajmëronte të kundërtën. „Turqit, — shkruante Samiu, — do të humbasin dhe duhet të humbasin, që të shpëtojnë njerëzia syresh”. „Por dhe sikur të ngjallej kjo mbretëri e të rronte edhe ca kohë, Shqipëria prapë

do të mos mundtte të ronte se ngjallje e Tyrqis është vdekj' e Shqipërisë". Do të ishte një guxim i madh, për të mos thënë më tepër, të dyshohej për inkonsekuencë një mendimtar si Samiu, i cili e shtron çështjen aq prerë saqë s'lejon as fijen e dyshimit: „ose Tyrqia ose Shqipëria”, „ngjallje e Tyrqisë është vdekje e Shqipërisë”. Kur është fjala për të arritur në qeverinë mëmëdhetare, ai thotë se „me hir Tyrqia s'u ka për të dhënë gjë”, prandaj „ata duhet të kenë edhe pushkënë plot”. Tregojnë se Samiu, aq shumë ishte i bindur për greminën e shpejtë të Perandorisë Osmane, saqë këtë lajm e priste nga dita në ditë dhe në çdo çast.

Më në fund, gjithë plani që jep Samiu për punët që do të kryejë dhe detyrat që do të zgjidhë qeveria e ardhme nuk le asnjë dyshim rreth çështjes se si e kuptonte Samiu qeverinë mëmëdhetare nën Turqinë, se cila ishte perspektiva drejt të cilës ai e thërriste popullin shqiptar. „Kjo qeveri, — ngul këmbë Samiu, — duhet të punojë pas nevojës së Shqipërisë dhe pas të drejtave të shqiptarëve”.

Nga ana tjetër, në arsyetimet e tij rreth qeverisë së ardhme dhe veprimtarisë së saj Samiu nuk thotë asgjë se si do të ndërtohen marrëdhëniet e saj me Turqinë, se ç'të drejta do të ketë mbi të Turqia dhe ç'detyrime do të ketë ajo ndaj Turqisë. Nuk thotë asgjë për arsyen e thjeshtë se ai nuk e shihte seriozisht këtë perspektivë, kurse të gjitha masat e propozuara ishin të një natyre të tillë, që kërkonin një vend të lirë dhe të pavarur me një qeveri më vete, me ligje më vete, me ushtri më vete, me monedhë më vete.

Nuk kemi nevojë për princa që të na pinë gjakun

Arsyetimi i Samiut ishte i pushtuar kryesisht nga nevojat e jetës, nga detyrat e ditës së lëvizjes çlirimtare shqiptare. Kështu i bindur se çështja e qeverisë ishte

çështje e një të ardhmje jo të largët, Samiu, në analizat dhe arsyetimet e tij, një vend të rëndësishëm i kush-ton formës që do të marrë kjo qeveri mëmëdhetare. Me fjalë të tjera, si do të jetë kjo qeveri, si do të organizohet ajo në mënyrë që t'u përgjigjet më mirë interesave të popullit shqiptar?

Samiu nuk do të shkëputet nga trualli kombëtar. Modelin e qeverisjes së ardhshme ai e kërkon në historinë e popullit tonë. Ai niset nga bindja se pushtimi osman ka qenë për popullin shqiptar një ndërprerje fatale e procesit historik dhe se gjithë çështja është të rikthehem atje ku u ndërpre dhe që aty të ecim përpara. Kështu, duke kërkuar në historinë e popullit tonë, Samiu ndeshet në një dëshmi të gjeografit të lashtë grek, Strabon, sipas të cilit të parët tanë, ilirët, kishin mbi krye disa këshilla që ai i quan plakoni (pleqësi, sipas Samiut) që qeverisnin dhe gjykonin të gjithë punët në vend. Samiu i jep të gjithë preferencën kësaj forme të lashtë qeverisjeje dhe mendon se ajo i përgjigjet më mirë interesave dhe psikologjisë së popullit shqiptar.

Historia të jep më tepër material për të menduar dhe për të nxjerrë konkluzione sesa modele të gatshme për t'i kopjuar. Prandaj vështirë se mund të na bëjë për vete ideja e Samiut që në Shqipëri të vendosej ajo formë qeverisjeje që kishte ekzistuar dy mijë e ca vjet më parë. Kjo do të thoshte të mos përfillje këtë evolucion dymijëvjeçar, që kishte sjellë marrëdhënie të reja midis njerëzve dhe që do të kërkonte patjetër edhe forma të reja të organizimit të pushtetit dhe të qeverisjes. Por nga ana tjetër, s'ka sesi të mos çmojmë përpjekjet e Samiut për të zbuluar dhe për të vlerësuar traditën kombëtare në këtë fushë kaq delikate dhe të rëndësishme, siç është ajo e organizimit të pushtetit. Aq më tepër s'ka sesi të mos çmojmë që, në emër të kësaj tradite, ai hedh poshtë me vendosmëri idenë e vendosjes në krye të pushtetit të një princi apo të një mbreti.

Shekulli XVIII, shekulli i borgjezisë, për disa vende kryesore të Evropës, kishte sjellë në diskreditimin e idesë së monarkisë dhe në shkurorëzimin, bile dhe në gjyotinimin e monarkut. Rusoi ishte ati shpirtëror i përmbysjes së monarkisë absolute në emër të sovranitetit të popullit. Roberspieri dhe jakobinasit u bënë tuesit legalë të testamentit të Rusoit. Por me këtë, monarkia nuk kishte vdekur në shumë vende të Evropës, bile për një kohë ishte ringjallur edhe në vetë Francën. Borgjezia, që kishte marrë pushtetin dhe po konsolidonte pozitën e saj, nuk shihte ndonjë gjë të keqe në monarkinë dhe shpesh kërkonte mbrojtjen e saj. Kurse në Perandorinë Osmane monarkia prej shekujsh ishte e vetmja mënyrë qeverisjeje.

Samiu së bashku me Naimin në shkrimet e tyre e kishin pohuar më se një herë se demokracia është rruga e zhvillimit të një vendi. Prandaj, tani që organizimi i pushtetit shtetëror shtrohej për Shqipërinë si çështje e një perspektive të afërt, Samiu i përmbahet kësaj pozite ideore dhe hedh poshtë çdo lloj ideje për një mbret, qoftë vendës, qoftë të huaj që të qeveriste Shqipërinë.

Në këtë pozitë të Samiut një rol po aq të rëndësishëm duhet të ketë luajtur edhe përvoja historike negative e Perandorisë Osmane, dëshmitar i përditshëm i së cilës ai ka qenë. I gjithë botëkuptimi i tij demokratik e sillte Samiun kundër botëkuptimit të sulltanit, e gjithë veprimtaria e tij kombëtare nuk mund të pajtohej me të. Prandaj, s'ka sesi Samiu të mos mbajë një qëndrim të prerë negativ ndaj monarkisë, që i kishte sjellë kaq të këqija Shqipërisë dhe që e kishte çuar në pragun e greminës edhe vetë Turqinë.

Në idenë demokratike, antimonarkike të organizimit të ardhshëm shtetëror të Shqipërisë Samiu kishte ardhur që në të ritë e tij. Qysh në vitin 1881, në letrën e famshme që i shkruante De Radës, Samiu shprehej në mënyrë të prerë dhe të qartë kundër mo-

narkisë. Këtë ide demokratike, që ishte ide e jetës së tij njëlloj si ajo e çlirimit kombëtar, Samiu e ruajti për 18 vjet dhe, në rrethanat ku ngjarjet rrokulliseshin me të shpejtë dhe çonin drejt greminës së Perandorisë Osmane, ai nxori përsëri dhe e bëri një nga idetë udhëheqëse lidhur me Shqipërinë dhe të ardhmen e saj.

Nuk mund të mos vihet në dukje se zhvillimi i mëtejshëm i ngjarjeve në Shqipëri tregoi se sa e themeltë ishte ndruajtja dhe frika e Samiut se mos në Shqipëri vjen në fron një mbret i huaj (siç ishte rasti i princ Vidit më 1914), apo një mbret vendës (siç ishte rasti i mbretit Zog 1924-1939). Përvoja historike tregoi gjithashtu se sa të drejtë kishte Samiu, kur paralajmëronte, se princërit apo mbretërit, në qoftë se do të vijnë në krye të pushtetit, „do të na rrjepin e do të na pinë gjakun”. Vërtetimi që i bëri historia pozitës së drejtë dhe përparimtare të Samiut është çmimi më i mirë që mund të presë një mendimtar për idetë dhe qëndrimet e tij.

Drejt formës përfaqësuese të qeverimit

Nuk dihet se sa i përgjigjet organizimit shtetëror të ilirëve ideja që ka Samiu për pleqësinë, por ajo që mund të thuhet me siguri është se në përmbajtjen e saj ai fut idenë e formës përfaqësuese të qeverimit, e cila kishte lindur në kushtet e luftës së borgjezisë kundër formës monarkike absolute të qeverimit dhe që në shumë vende kapitaliste kishte marrë të drejtën e qytetarisë.

Qoftë nga struktura, qoftë nga funksionimi i tij, pushteti i ardhshëm, siç e përfytyronte Samiu, nuk ndryshonte shumë nga struktura dhe funksionimi që vepronte në mjaft vende kapitaliste. Kështu, në krye të pushtetit Samiu ve një këshillë të pleqësisë, të përbërë nga 15 veta (një për secilën nga 15 nëndarjet

administrative të Shqipërisë në ardhshme), e cila do të kryente pak a shumë funksionet e presidentit dhe pikërisht të emëronte dhe të shkaktonte qeverinë, të supervizonte vendimet e saj kryesore.

Nën këshillin e pleqësisë apo përkrah tij do të veprojë një organ tjetër i lartë, që Samiu e quan këshillë e përgjithshme, e përbërë nga 100 përfaqësues, një për çdo 20.000 banorë, e cila do të kryente pak e shumë funksionet e parlamentit dhe pikërisht të aprovonte buxhetin, ligjet e parlamentit dhe të gjitha punët e mëdha të qeverisë do të merrnin formën e prerë kur të kalonin dhe në këshillën e pleqësisë.

E lidhur me këto dy organe të larta dhe nën mbikqyrjen e tyre do të krijohet dhe do të punojë organi i tretë i lartë i shtetit, qeveria si organ ekzekutiv.

Një element i rëndësishëm i formës përfaqësuese të qeverimit është zgjedhshmëria. Në këtë parim mbështetet dhe Samiu, i cili mendon se që të gjitha organet e larta, qoftë këshilli i pleqësisë, qoftë këshilli i përgjithshëm, duhet të jenë të zgjedhura.

Kur është fjala për përmbysjen e pushtetit të pushtuesit dhe zhdukjen e zgjedhës së tij Samiu është radikal. Ai zien e buçet kundër administratës osmane dhe si rrugë racionale për shkatërrimin e saj propozon grykën e pushkës. Por, kur ai kalon në organizimin e pushtetit të ri mëmëdhetar, radikalizimin e le sado pak dhe i hap rrugën moderimit. Ky moderim duket në përjashtimin apo më saktë, në kufizimin që i bën popullit në organizimin e pushtetit dhe qeverisjen e vendit. Ata që do të zgjedhin, sipas Samiut, duhet të kenë të paktën një shtëpi apo një arë apo një pasuri tjetër ekuivalente. Kështu që mbetej jashtë zgjedhjeve një pjesë e madhe e popullit shqiptar, që një pasuri të tillë nuk e kishte. Përveç kësaj, ata që do të zgjedhin duhet të kenë dalë nga një shkollë dhe të dinë të shkruajnë e të këndojnë. Me këtë cens praktikisht

mbetëj jashtë zgjedhjeve pjesa dërmuese e popullit shqiptar, i cili, në kushtet e regjimit të pushtimit, ishte pa mësim dhe pa shkollë. Për pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet Samiu nuk thotë asnjë fjalë, por kuptohet vetvetiu se ato përjashtohen prej tyre qoftë dhe për arsyen e analfabetizmit të tyre. Samiu ishte i nderë i gjithi drejt së ardhmes dhe po të merret parasysh perspektiva, po të kujtohet si e përfytyronte ai Shqipërinë e ardhshme me shkolla në të katër anët e vendit, ku të shkonin njëlloj si djemtë dhe vajzat, atëhere cenzi i arsimit nuk ka një karakter aq të kufizuar sa mund të duket aty për aty.

Cenzet dhe kufizimet ishin akoma më të mëdha për ata që kishin të drejtë të zgjidheshin. Përveç pa-surisë, që në këtë rast duhet të ishte më e madhe, ata që do të zgjidheshin duhet „të kenë mbaruar një shkollë të dytë të lartë”. Njerëz të tillë në Shqipërinë e asaj kohe numëroheshin me gisht dhe, natyrisht, ishin që të gjithë të dalë nga shtresat më të pasura. Pushteti që do të dilte në këtë mënyrë, do të ishte një pushtet aristokratik. Këtë e përmbajnë në mënyrë implicite cenzet elektorale që vë Samiu, këtë e thotë ai në mënyrë eksplisite: „ata që do të zgjidhenë për Këshillë të Pleqësisë do të jenë nga parësia...”.

Të gjitha këto cenze dhe kufizime kanë kuptimin dhe përmbajtjen e tyre klasore, por ato në asnjë mënyrë nuk e bëjnë Samiun një mendimtar që nuk merrte parasysh popullin. Masat e gjera popullore janë të pranishme në botëkuptimin dhe në veprimtarinë politike të Samiut: në emër të njerëzve të thjeshtë, në emër të fshatarëve dhe të zejtarëve që pësojnë nga politika e administratës osmane, ai ngrihej e dëno-nte pushtimin dhe kërkonte lirinë e pavarësinë.

Masat e gjera në botëkuptimin e Samiut nuk janë vetëm faktorë shoqërorë pasivë, që vuajnë e shtypen dhe që kanë nevojë t'u jepet dora dhe të shpëtohen. Ata figurojnë në të edhe si faktorë shoqërorë aktivë, si faktorë që me luftën dhe përpjekjet e tyre do të

çlirojnë atdheun e tyre. Ideja e Samiut e kryengritjes së armatosur, kërkesa e tij që të mbahet pushka plot, që liria dhe pavarësia të fitohen me çdo kusht në mos me hir, me pahir, presupozon patjetër popullin dhe rolin e tij aktiv. Kryengritja e armatosur, lufta çlirimtare kundër pushtuesit nuk mund të jetë vepër e njëqind e dyqind vetëve, por ajo e masave të gjera, vepër e popullit. Në fund të fundit çdo kryengritje e armatosur, çdo luftë çlirimtare është një luftë popullore, tjetër çështje është se kush i gëzon frutet e fitores dhe të çlirimit.

Shqipëria — një vend i zhvilluar industrial

Edhe Shqipërinë ekonomike ashtu si atë politike Samiu e përfytyronte në bazë të modelit evropian. Shumë nga iniciativat dhe realizimet që përfaqësonin progresin material të vendeve kapitaliste të Evropës Samiu i ëndërronte t'i shihte dhe në Shqipëri. Kështu, iniciativat kryesore të qeverisë së ardhshme mëmëdhëtare do të ishin ndërtimi i udhëve dhe i hekurudhave që do t'i binin Shqipërisë kryq e tërthor, çelja e skelës së Durrësit dhe të disa skelave të tjera, krijimi i një shoqërie anijesh, të cilat të gjitha së bashku do të përbënin transportin e Shqipërisë dhe mbështetjen e zhvillimit të tregtisë dhe të industrisë.

Në zhvillimin industrial mendja i shkon Samiut në shfrytëzimin e atyre lëndëve me të cilat është e pasur Shqipëria. I nisur nga kjo ide ai kërkon që të zhvillohet në radhë të parë industria e drurit, që do të merret me përpunimin e drurit të pyjeve tona dhe industria minerale, që do të merret me kërkimin dhe nxjerrjen e mineraleve kudo që gjenden në Shqipëri. Kurse për zhvillimin bujqësor, Samiu zgjidhte rrugën e tharjes dhe të irrigimit të fushave të Shqipërisë, që përmbyteshin nga lumenjtë e ndryshëm, duke filluar me fushën e madhe dhe të pasur të Myzeqesë.

Të gjitha këto iniciativa, që Samiu i vinte në bazë të veprimtarisë së qeverisë së ardhshme, flasin për guximin e mendimit të tij dhe për drejtësinë e gjykirnit të tij.

Planet ekonomike të Samiut marrin dimensione akoma më të mëdha, po të sillet ndër mend se ç'përfaqësonte Shqipëria e sash kohe, një vend i varfër dhe i braktisur. Guximi i planeve të Samiut kishte në bazën e tij erudicionin dhe përgatitjen e tij teorike. Por më tepër ai buronte nga dëshira fisnike e Samiut për t'i parë „shqiptarët të jetojnë si në parajsë”.

Drejtësinë e një ideje apo të një plani shpesh e vërtetojnë argumentet që përdoren në të mirë të tyre; por kryeargumenti në këtë fushë mbetet praktika.

Samiu e mendonte punën thjesht. Prapambetja e përgjithshme ekonomike e Shqipërisë buron nga zgjedha osmane dhe nga administrata shtetërore anti-kombëtare. Mjafton që të zhduket kjo zgjedhë, mjafton që të hiqet kjo pengesë, që të mirat të burojnë si lumë mbi Shqipërinë. Mirëpo doli se puna nuk ishte aq e thjeshtë sa e përfytyronte ai. Vizioni i thjeshtësuar që ai kishte për zhvillimin e Shqipërisë së lirë nuk përputhej me logjikën objektive të historisë.

Kultura dhe arsimit — e ardhmja e Shqipërisë

Dituritë, njohja e natyrës dhe e shoqërisë, kanë qenë gjithnjë pjesë përbërëse e jetës njerëzore dhe e progresit historik të shoqërisë. Sa më lart që ngrihet shoqëria në shkallën e progresit aq më intensiv bëhet përparimi i diturive, aq më i madh dhe roli i tyre në këtë progres.

Roli i madh i diturive në progresin material dhe moral të shoqërisë, i parë ky në sfondin e obskurantizimit mesjetar, solli në jetë iluminizmin që u bë bëtëkuptimi sundues i të gjithë inteligjencës përparimtare të shekullit XVIII në Evropë.



Naimi dhe Samiu (Janinë, 1868)

Iluminizmi evropian gjeti një jehonë të gjerë dhe në mendjet e mendimtarëve përparimtarë të popullit tonë si Samiu e të tjerë. Nevoja e zhdukjes e obskurantizmit fetar dhe e injorancës së përgjithshme që sundonte në vend, e shoqëruar me nevojën urgjente të afirmimit të popullit tonë si komb më vete nëpërmjet arsimit në gjuhën amtare, kanë qenë ato që i kanë dhënë orientimin iluminist mendimit përparimtar shqiptar të kohës. Nën ndikimin e botëkuptimit iluminist Samiu përpunoi perspektivën kulturo-arsimore të Shqipërisë së ardhshme të lirë, perspektivë kjo prioritare, e gjerë dhe demokratike.

Perspektivë prioritare: Ndër të gjitha detyrat që do t'i dalin Shqipërisë menjëherë pas Çlirimit, ajo nga e cila duhej filluar dhe për të cilën duhej treguar kujdesi më i madh, sipas porosisë së Samiut, është dituria. Për të gjykuar për rëndësinë dhe drejtësinë e këtij prioriteti nuk është nevoja të ndalemi në arsyetime të gjata.

Perspektivë e gjerë: Shqipërinë e ardhshme Samiu e përfytyronte dhe e ëndërronte të mbushur me shkolla që nga qytetet deri në fshatrat më të largëta, deri në të gjitha fshatrat, siç thotë vetë Samiu, me shkolla nga të gjitha kategoritë — të përgjithshme, për ushtrinë, për marinën, për metalet, për pyjet, për bujqësinë dhe për mjeshtëri të tjera të veçanta, me shkolla të të gjitha niveleve, tetëvjeçare (shkolla të dyta, siç i quan Samiu) të mesme (shkolla të treta) deri në universitet (gjithmësimë). Në planet e tij arsimore-kulturore Samiu nuk harron dhe organizime të tilla të larta dhe të kualifikuara për përhapjen dhe zhvillimin e dijes dhe të kulturës si Akademia e Shkencave (Këshilli i diturisë), Shoqata shkencore, muze arkeologjikë dhe të shkencave natyrore, revista shkencore, biblioteka të mëdha.

Perspektivë demokratike: arsimin dhe dituritë Samiu në planet e tij nuk i shihte si privilegje të një

shtrese apo të një klase, por si ushqim shpirtëror për të gjithë, — arsim i detyrueshëm për të gjithë fëmijët nga 7-13 vjeç, që do të jetë në dispozicion të të gjitha shtresave pavarësisht nga gjendja ekonomike, mësimi do të jetë pa ndonjë pagesë dhe jo vetëm për djemtë, por edhe për vajzat.

Lufta për çlirimin kombëtar dhe thelbi i saj klasor

Në shoqëritë e ndara në klasa, çdo lëvizje shoqërore buron nga interesi i një klase të caktuar dhe çon në forcimin e pozitive të kësaj klase. Nuk bën përjashtim këtu as lëvizja çlirimtare kombëtare shqiptare.

Një ndërgjegje aq të qartë, se nacionalizmi është i lidhur me interesat e borgjezisë, te Samiu nuk e gjejmë. Ai i drejtohet popullit në emër të çlirimit të Atdheut dhe të shpëtimit të kombit, pa shpjeguar se ç'procese ekonomike do të gjejnë fushë të lirë zhvillimi dhe ç'klasa shoqërore do të përfitojnë prej tij. Por në mënyrë të pandërgjegjshme përmbajtja social-ekonomike borgjeze e çlirimit kombëtar është e pranishme në arsyetimet e Samiut.

Kur Samiu ngrihej kundër taksave të rënda që nxirrte administrata turke nga shqiptarët, këtë ai e bënte në emër të popullit, në emër të fshatarëve që vuanin prej tyre, por këtu flet dhe interesi ekonomik i borgjezisë që kërkonte që mbivlera të mos shkante në xhepat e klasave sunduese turke, por të mbetej në xhepat e saj.

Kur Samiu ngrihej kundër politikës së administratës turke, që rrëmbente nga Shqipëria ç'të mundte dhe nuk bënte as më të voglin investim në vend, këtë ai e bënte në emër të popullit, por këtu flet përsëri interesi ekonomik i borgjezisë, të cilën kjo mungesë

e afarizmit e mbyste që në vezë dhe nuk i jepte kurrfarë mundësie zhvillimi.

Kur, më në fund, Samiu ngrihej kundër paqeverisjes, kundër mungesës së sigurisë që sundonte në vend, kundër aleancës së „qeveritarëve me hajdutët për të rrjepur shqiptarët e nderçëm”, këtë ai e bën përsëri në emër të popullit, që më tepër se kushdo vuante nga paqeverisja por këtu flet përsëri interesi i borgjezisë, e cila, për zhvillimin e saj ka nevojë për një minimum sigurie. Ajo kërkon siguri si për investimin e kapitaleve të saj, ashtu edhe për rrugët e tregtisë që do të detyrohet të marrë qarkullimi i mallrave të saj. Siguria është një nga kërkesat e para të çdo shoqërie borgjeze. Siç ka theksuar Marks i siguria është koncepti më i lartë social i shoqërisë qytetare (d.m.th. borgjeze). Gjithë shoqëria, sipas këtij koncepti nuk ekziston veçse për t'i siguruar çdo anëtar të saj paqeshmërinë e personit, të të drejtave të tij dhe të pronës së tij.

Nën prizmin e kësaj ideje të Marksit, Engelsi ka studiuar realitetin shoqëror të Perandorisë Osmane dhe vëren se kaosi dhe pasiguria që sillte me vete sundimi turk pengonte zhvillimin kapitalist, se në kushtet e këtij sundimi, nuk ekzistonte kushti i parë themelor për realizimet borgjeze: sigurimi i personit të tregtarit dhe i pronës së tij.

Edhe masat që propozon Samiu për organizimin politik të Shqipërisë së lirë dhe për zhvillimin e saj ekonomik dhe kulturor në thelbin e tyre janë masa që kërkonte zhvillimi kapitalist i vendit dhe që çonin në forcimin e këtij zhvillimi. Kështu, në planin politik forma e organizimit të pushtetit, që propozon Samiu, si dhe cenzet dhe kufizimet në mënyrë të pashmangshme do të sillnin në krye të pushtetit përfaqësuesit e borgjezisë. Në planin ekonomik kërkesat e tij për ndërtimin e udhëve dhe të hekurudhave, për krijimin e industrive të ndryshme janë kërkesa që nuk mund të realizoheshin në asnjë mënyrë në kushtet

e rendit feudal, por që kërkonin një rend të ri shoqëror, rendin kapitalist. Më në fund, në planin kulturor, kërkesat e tij për arsim e kulturë, për përhapjen e tyre në masat, buronin dhe këto nga nevojat e zhvillimit kapitalist të vendit. Për të organizuar veprimtarinë e saj prodhuese borgjezia ka nevojë për punëtorë që të jenë të lirë nga zgjedha feudale, por dhe të kenë një minimum arsimi dhe kulture në mënyrë që të vënë në lëvizje veglat e ndërlikuara në prodhimin kapitalist. Është e vërtetë se porositë e Samiut për arsim dhe kulturë në dispozicion të të gjithë popullit dhe në dobi të tij shkonin shumë larg dhe parashikonin dhe realizime, të cilat vetë borgjezia as nuk është në gjendje, as nuk dëshiron t'i realizojë. Ato dilnin nga kuadri i mundësive objektive dhe subjektive të klasës borgjeze dhe të rendit kapitalist.

Karakterit borgjez i proceseve ekonomike shoqërore, të cilëve çlirimi kombëtar do t'u hapte rrugë të gjerë zhvillimi, nuk e detyronte borgjezinë të mbyllej në guaskën e vet, nuk e ndalonte që kërkesat e saj t'i bënte në emër të popullit dhe të dilte si përfaqësuesja e tij. Në kushtet kur klasa punëtore sapo ka filluar të lindë dhe të formohet, një fenomen i tillë është i mundshëm, bile dhe i pashmangshëm. Në të vërtetë, nga mungesa e lirisë vuante jo vetëm borgjezia, por i gjithë populli. Taksat e rënda, arbitrariteti i administratës osmane, mundimet në ushtri dhe në luftë në shërbim të perandorisë, pengesat në përdorimin e gjuhës amtare, ndalimi i shkollave, mohimi i të drejtave më elementare përbënin një lëmsh të tillë plagësh dhe kontradiktash që preknin më rëndë se këdo tjetër masat e gjera popullore. Kështu, së bashku me borgjezinë në sheshin e luftës për çlirimin kombëtar dalin dhe masat e gjera të popullit. Kjo i jepte mundësi borgjezisë shqiptare që po lindte t'i mbulonte interesat e saj klasore politike dhe ekonomike me parulla popullore dhe të dilte me thirrje të përgjithshme për çlirimin e Atdheut dhe shpëtimin e kombit.

Thirrjet e përgjithshme për çlirimin e Atdheut dhe shpëtimin e kombit buronin edhe nga një rrezik tjetër real që kërcënonte popullin tonë në kohën kur Samiu përgatiste dhe shkruante veprën e tij, nga rreziku i shteteve fqinjë, të cilët synonin të aneksonin territoret shqiptare dhe të asgjësonin popullin tonë si komb më vete. Pretendimet e monarkive shoviniste fqinje ishin një rrezik për dekje për popullin tonë, por në të njëjtën kohë dhe një shkollë tjetër e madhe e nacionalizmit, një ferment i fuqishëm i ndërgjegjes kombëtare. Samiu e përdori atë për t'i zgjuar shqiptarët dhe për t'i hedhur në luftën çlirimtare.

Po të arsyetohet thjesht, mund të bëhet një pyetje e tillë: mos bie vlera e Samiut si mendimtar demokrat dhe revolucionar sa kohë që ai me idetë dhe orientimet e tij ndihmon procesin e zhvillimit kapitalist të shoqërisë (të zhvillimit evropian, „të kthehet Shqipëria në një Zvicër të dytë”, siç e përfytyronte Samiu), një zhvillim, i cili shoqërohet me shtypjen dhe shfrytëzimin e masave popullore, si dhe me një varg kontraditash të rënda shoqërore?

E parë në thelb, një pyetje e tillë është pa vend ose, në qoftë se bëhet, nuk mund të ketë veçse një përgjigje negative. Samiu është një mendimtar demokrat dhe revolucionar. Po të analizohet problemi në kuadrin e zhvillimit objektiv të shoqërisë del se gjëndja e atëhershme e Shqipërisë alternativë tjetër zhvillimi progresiv përveç atij kapitalist, nuk jepte. Prandaj, çdo mendimtar përparimtar nuk mund të kërkonte veçse një zhvillim të tillë.

Pyetja ka një përgjigje negative aq më tepër po të analizohet problemi në kuadrin subjektiv, në kuadrin e vetëndërgjegjës së Samiut. Në ndërgjegjen e Samiut lufta për çlirimin kombëtar ishte një luftë e shenjtë, një luftë për interesat më jetike të popullit. I dhënë i tëri pas idesë së çlirimit kombëtar Samiut i shpëtonin nga vështrimi dhe kuptimi i drejtë pro-

ceset ekonomike që do të zhvilloheshin pas çlirimit si dhe kontradiktat shoqërore që do të lindnin në bazë të tyre. Përkundrazi, ai ishte sinqerisht i bindur se liria kombëtare do ta bënte Shqipërinë një vend të lulëzuar, „një nga më të ndrituarët e një nga më të qytetëruarët kombe të Evropës” ku „shqipëtarët do të rojnë si në parajsë”.

Shpjegimin e plotë të pyetjes së shtuar më lart na e jep Lenini në arsyetimin që bën rreth iluministëve rusë dhe iluministëve në përgjegjësi: „... Skaldini, — shkruan Lenini, — është borgjez... Duhet të vërejmë se shumë herë tek ne kjo fjalë kuptohet shtrembër, në mënyrë të ngushtë dhe antihistorike, duke e lidhur atë (pa bërë një dallim midis epokave historike) me mbrojtjen egoiste të interesave të pakicës. Nuk duhet harruar, se në kohën kur shkruanin iluministët e shekullit XVIII (të cilët opinioni i përgjithshëm i quan si udhëheqës të borgjezisë), kur shkruanin iluministët tanë të vjetëve 1840-1870, të gjitha çështjet shoqërore përmblihdeshin në luftën kundër bujkërobërisë dhe mbeturinave të saj. Marrëdhëniet e reja ekonomiko-shoqërore dhe kontradiktat e tyre në atë kohë ishin akoma në gjendje embrionale. Prandaj në atë kohë ideologët e borgjezisë nuk frymëzoheshin nga ndonjë interes egoist; përkundrazi si në Perëndim ashtu edhe në Rusi ata besonin sinqerisht në mirëqenien e përgjithshme dhe e donin sinqerisht atë, sinqerisht nuk i shihnin (pjesërisht nuk kishin akoma mundësi t'i shihnin) kontradiktat në rendin që po lindte nga rendi feudal”¹⁾).

Manual atdhedashurie dhe patriotizmi

Në veprimtarinë historike njerëzit nuk kanë gjithnjë një fatin të korrin atë që kanë mbjellë, nuk arrijnë

¹⁾ Lenin, *Veprat*, vëll. 2, f. 591.

gjithnjë në të gjallë të tyre të njohin gëzimin e fitores dhe të marrin shpërblimin e mundësive dhe të vuajtjeve. Por kjo nuk i ka ndaluar njerëzit përparimtarë dhe revolucionarë që të mos mbjellin dhe të mos luftojnë. I tillë ishte dhe Sami Frashëri. Ai, pa ndjerë asnjëherë lodhjen dhe dekurajmin, ka mbjellë farën e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare, farë, e cila shumë shpejt, ndonëse pas vdekjes së Samiut, dha frutet e saj të mrekullueshme — Shqipërinë e lirë dhe të pavarur.

Vepra e Samiut u prit me entuziazëm, siç e meritonte, nga të gjithë shqiptarët patriotë e lirisdashës. Jehona e saj i kapërceu kufijtë e lëvizjes çlirimtare shqiptare. „Shqipëria ç'ka qënë...” shpejt u përkthye në gjuhë të ndryshme të Ballkanit dhe të Evropës: në turqisht dhe në greqisht në Sofie, në gjermanisht në Vjenë dhe Leipzig, në frengjisht dhe në italisht në Bukuresht. Një përkthim të veprës në greqisht ka dhënë dhe Fan S. Noli në Egjipt më 1903. Kurse nga kampi tjetër, nga ai i reaksionit dhe i despotizmit, vepra e Samiut u prit me nervozizëm dhe me një inat të papërmbajtur. Kur kjo u botua në turqisht shtypi reaksionar i Stambollit shkruante për Samiun si për „një tradhtar, që e kemi mbajtur në gjirin tonë”.

Vepra e Samiut „Shqipëria ç'ka qënë...” edhe sot e kësaj dite ruan vlerën e saj si një dokument historik, si një dëshmi e përpjekjeve dhe e shqetësimeve të një brezi të tërë patriotësh dhe mendimtarësh në një epokë vendimtare për formimin e Shqipërisë dhe të ardhmen e saj.

VII. ENCIKLOPEDIA — THESAR I PASHTERSHËM DITURIE

Në krijimtarinë e Samiut dallohen qartë njëra nga tjera dy vepra — njëra në gjuhën shqipe, për të cilën u fol më sipër, dhe një tjetër, shumë më e gjerë, në gjuhën turke. Samiu është autori i enciklopedisë së famshme turke, „Fjalori i përgjithshëm i historisë dhe i gjeografisë” në gjashtë vëllime me rreth pesë mijë faqe, që e filloi më 1889 dhe e mbaroi më 1898, i fjalorit të gjuhës turke (1900) dhe fjalorëve turqisht — frengjisht (1882), dhe frengjisht — turqisht 1898, i fjalorit të gjuhës turke (1900) dhe fjalorëve mbi probleme të rëndësishëm natyrore dhe sociale si p.sh. „Qielli”, „Toka”, „Njeriu”, „Gratë”, „Mitologjia”, „Qytetërimi islam”, „Gjuha”, „Fjalë të urta” etj. Ky numërim i shkurtër dhe jo i plotë i veprës së Samiut në gjuhën turke, që arrin në 60 e ca vepra, jep masën e personalitetit krijues të tij — një personalitet poliedrik, një mendje enciklopedike dhe gati universale. Ai ishte viga i mendimit, vigan i punës dhe i guximit krijues. Për të përballuar një vëllim kaq të madh krijimi dhe botimi, duhej përveç talentit dhe erudicionit, dhe një aftësi e veçantë pune dhe një guxim i rrallë për të kapërcyer lloj-lloj pengesash. Kjo punë e madhe krijuese, që s’njohu asnjëherë pushim, ia hëngri pak nga pak jetën, e çoi para kohe në varr por e bëri të pavde-

kshëm. Ai la pas një monument të tillë mendimi dhe krijimi para të cilit koha është e pafuqishme.

Edhe në jetën politike të Samiut, njëlloj si në krijimtarinë e tij, dallohen qartë njëra nga tjetra dy veprimtari — njëra në të mirë të çlirimit dhe të pa-varësisë së Shqipërisë, tjetra në kuadrin e problemeve politike dhe sociale që qëndronin para Perandorisë Osmane.

Dy vepra krijuese, dy veprimtari politike, që dallohen nga njëra-tjetra, por që nuk e kundërshtojnë njëra-tjetrën. Përkundrazi, ato janë të lidhura midis tyre, njëra plotëson dhe ndihmon tjetrën. Si vepra në shqip ashtu dhe ajo në turqisht janë përpjekje teoriko-propagandistike për t'i hapur rrugën një tendence të vetme — tendencës progresive të shkatërrimit të despotizmit dhe absolutizmit të sulltanit, pasojë e drejtëpërdrejtë e së cilës duhej të ishte çlirimi dhe dalja më vete e Shqipërisë si dhe e gjithë vendeve të tjera të robëruara. Jeta dhe vepra e Samiut nuk ishte aspak e dyzuar, por një dhe e vetme, konsekuente dhe besnike e një vije progresive, patriotike, çlirimtare dhe revolucionare.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX gjendja e Perandorisë Osmane, dikur tmerri i Evropës, ishte bërë e vajtueshme në të gjitha drejtimet — politik, ekonomik, kulturor, administrativ, ushtarak. Kjo ndihej aq më fort kur bëhej krahasimi me fuqitë e mëdha të Evropës, që tani i qëndronin përballë dhe bile i diktonin vullnetin e tyre. Reformat që kishte bërë në vitet 30-të të shekullit XIX pushteti ekzistues, për të dalë nga gjendja, e që njihen me emrin e Tanzimatit, ishin treguar një paliativ i pafuqishëm dhe i paefektshëm. Ato e kishin lënë përsëri pa përgjigje pyetjen: si do t'i vejë halli kësaj perandorie, si do të ecet më tej? „I sëmuri i Bosforit”, të cilit Samiu, si patriot i atdheut të tij të robëruar dhe si demokrat, i dëshironte vdekjen dhe greminën, kishte

nevojë jo për reforma si atë të Tanzimati, por për operacione të thella. Pyetjen „si do t'i vejë halli perandorisë?” e shtroi edhe një herë, këtë radhë në trajtë gati tragjike, disfata e Turqisë në Luftën Ruso-Turke të vitit 1878 dhe traktati i Shën-Stefanit që e pasoi.

Këtë alternativë — o të hiqte dorë nga gjithë ai trashëgim i rëndë i perandorisë së dikurshme, o të gremisej e të shkatërrohej nën barrën e tij dhe të presionit të lakmive të jashtme — e ndienin, e kuptonin që të gjitha forcat sociale, por reagonin në mënyrë diametralisht të kundërt. Oborri perandorak, gjithë vjetërsia feudale që ishte lidhur me të dhe në krye të së cilës ishte sulltani, nuk donte kurrsesi të pajtohej me perspektivën e ndryshimeve rrënjësore; së këndejmi terrorizmi i Abdyl Hamitit II, imobilizimi i tij politik dhe social që nuk bënte tjetër veçse e trashte sëmundjen dhe shpejtonte shpartallimin përfundimtar të Perandorisë Osmane.

Përballë sulltanit dhe forcave të reaksionit qëndronin forcat përparimtare, realiste që luftonin për ndryshime rrënjësore, me pasojat kryesore: përmbysja e absolutizmit të sulltanit, zhdukja e feudalizmit, dezagregimi i perandorisë. Në këto forca përparimtare bënin pjesë Samiu dhe të gjithë patriotët shqiptarë, për të cilët ishte e qartë se çlirimi i Shqipërisë dhe përparimi i saj, kalonte nëpërmjet zhdukjes së absolutizmit të sulltanit dhe sundimit të tij despotik.

Analiza dhe vlerësimi i veprës së gjerë të Samiut në gjuhën turke nuk është çështje e një studimi të përgjithshëm si i yni, por i një apo dhe i disa studimeve themelore. Por dhe në një studim të tillë të përgjithshëm disa vlerësime mund të bëhen, disa vija mund të hiqen.

Zhdukja e absolutizmit të sulltanit, përmbysja e perandorsë kishte si kusht paraprak rishikimin e të gjitha ideve të reja, që do të ndriçonin mendjet e njerëzve dhe do t'i përgatisnin ato për ndryshimet e

pritime ekonomike, politike dhe sociale. Këto ide nuk mund të mbeteshn në rrethin e një numri të vogël njerëzish; ato duhet ta thyenin këtë rreth dhe të pushtonin masa më të gjera. Në qoftë se rendi i vjetëruar feudal nuk kishte nevojë për njerëz të ndriçuar dhe me arsim, rendi i ri shoqëror kapitalist që duhej t'i zinte vëndin kishte nevojë për një numër shumë më të madh njerëzish të ndriçuar, me dije të sakta mbi natyrën dhe mbi ato procese materiale, që kushtëzojnë prodhimin kapitalist. Sistemi i ri shoqëror kishte, pra, nevojë për ide dhe dije të tjera nga ato ekzistuese, kishte gjithashtu nevojë që këto të bëheshin pronë e e një numri më të madh njerëzish. Kjo mund të realizohej me vepra të veçanta, mund të realizohej akoma më mirë me një enciklopedi, që lejon dhe jep mundësi për një rishikim, rivlerësim dhe propagandim global të ideve dhe dijeve në përmasa të vogla, të përshtatshme për t'u përvetësuar. Kjo detyrë historiko-shoqërore dhe aspak dëshira për të treguar erudicion apo ndonjë konsideratë materiale nga e cila mund të jetë nisur botuesi i saj, tregtari armen Mirhan, ka qenë ajo që e ka vënë në lëvizje Samiun dhe që e ka nxitur t'i përveshëj punës kolosale, të kapërcente pengesat akoma më kolosale për të hartuar enciklopedinë e tij të famshme, për të shkruar ato 5000 faqe mbi çështje nga me të ndryshme të historisë, gjeografisë e filozofisë. Në këtë botim Samiu e tregoi edhe një herë se ishte shqiptar dhe se duhej punuar për Shqipërinë. Enciklopedia e tij është klot artikuj dhe njohuri mbi historinë dhe gjeografinë e Shqipërisë, mbi ngjarje, njerëz dhe vende të saj. Emrat e shquar të historisë së Shqipërisë që nga fillimet e saj deri në ditët kur botohej Enciklopedia, qytetet, malet, lumenjtë e Shqipërisë, nga më të mëdhenjtë deri në më të vegjëlit, zënë një vëllim aq të madh sa që në një farë kuptimi ajo mund të quhet Enciklopedia e botës historike dhe gjeografike shqiptare brenda Enciklopedisë së përgjithshme. Njohuritë që jepte Samiu mbi Shqipërinë nuk

kishin vlerë thjesht informative. Ato e kalonin këtë kuadër dhe merrnin vlerë politike aktuale. E merrnin këtë vlerë për ngrohtësinë dhe pasionin me të cilin shkruante Samiu për çdo gjë që ishte shqiptare. E merrnin gjithashtu këtë vlerë, sepse u kujtonin shqiptarëve historinë e tyre të lashtë dhe njerëzit e tyre të shquar si Skënderbeu e të tjerë, sepse u mësonin se ç'është Shqipëria, cilat janë qytetet e saj, që ku dhe deri ku ajo shtrihet. Nëpërmjet Enciklopedisë Samiu bënte po atë që bënte e gjithë Rilindja jonë Kombëtare, mbronte dhe propagandonte të njëjtat ide dhe qëndrime si lashtësinë e popullit tonë, trimërinë e tij, aftësitë e tij të rralla, bukurinë e viseve të ndryshme të Shqipërisë, përkatësinë shiptare të plot vendeve dhe qyteteve që lakmoheshin nga shovinistët.

Enciklopedia e Samiut në botën osmane të shekullit XIX nga emri dhe nga qëllimi të kujton enciklopedinë e Didëroit në Francën e shekullit XVIII. Do të ishte një thjeshtësim i palejueshëm të vihet shenja e barazimit midis të dy enciklopedive dhe të dy personaliteteve shkencore që i kanë drejtuar. Megjithatë disa pika të rëndësishme kontakti mund të gjendeshin, të cilat do të hidhnin një dritë suplementare mbi Enciklopedinë e Samiut dhe vendin e saj.

Ashtu si Enciklopedia e Didëroit dhe ajo e Samiut dilte në një kohë kur shoqëria feudale osmane njëjloj si shoqëria feudale franceze e atëhershme ishte në një krizë të rëndë, e cila mund të zgjidhej vetëm me shkatërrimin e rendit ekzistues feudal. Si Didëroi dhe Samiu me Enciklopedinë e tij synonte të armatoste rininë e mësuar përparimtare me një botëkuptim të ri dhe me një minimum dijesh për t'i përgatitur dhe për t'i frymëzuar për ndryshimet rrënjësore shoqërore politike që kërkonte koha.

Ashtu si Didëroi në Francë dhe Samiu në Perandorinë Osmane duhej të kapërcente pengesa dhe vështirësi kolosale, që shumë vetë mund t'i dekurojonin. Vështirësitë ishin të karakterit krijues. Duhe-

shin përgatitur materiale për probleme nga sferat më të ndryshme të dijeve dhe brenda një kohe të shkurtër. Vështirësitë krijuese, më tepër se kushdo tjetër, i njihte vetë autori. Në parthënien e Enciklopedisë ai njofton lexuesin: „për të arritur një shkallë të plotë njohurie për çdo çështje... u përpoqa, pa marrë parasysh asnjë vështirësi dhe sakrificë, të gërmoj qindra libra..., të bredh bibliotekë më bibliotekë, të nxjerr të dhëna nga libra të mbuluar me pluhur, të ngrena nga krimbat, me gërma të fshira”¹⁾). Zakonisht në fillim të punës për hartimin e veprave të tilla si Enciklopedia, vështirësitë duken më të pakta sesa janë në të vërtetë. Ato fillojnë të dalin dhe të shumohen në rrugë e sipër. Samiu diti t'i kapërcejë vështirësitë e panumërta të karakterit krijues dhe ta mbarojë me sukses botimin e Enciklopedisë, duke filluar me vëllimin e parë më 1889 dhe duke mbaruar me vëllimin e gjashtë e të fundit më 1898. Vështirësitë ishin dhe të karakterit politik. Njëpërmjet vëllimeve të Enciklopedisë Samiu ku drejtpërdrejt e ku tërthorazi, shpërndante një mori idesh e njohurish që ishin të reja për veshët e qytetarëve të Perandorisë Osmane të përgjumur; ato bile tingëllonin sfiduese dhe kërcënuese për të gjithë mënyrën tradicionale të të menduarit dhe të të ndjerit. Pushtetet ekzistuese absolutiste nuk mund të lejonin të kalonin pa pasoja të rënda për autorin e tyre idetë patriotike, liberale dhe antikonformiste që përhapte Samiu në vëllimet e Enciklopedisë së tij. Njësoj si Didëroi, Samiu njohu privacionin, ndjekjet, deri burgimin shtëpijak në fund të jetës së tij. Në qoftë se Samiu nuk u tremb, nuk ktheu rrugë dhe as u ndal, por e çoi deri në fund botimin e Enciklopedisë së tij kjo është një provë më tepër që tregon se sa i gjerë ishte erudicioni i tij, sa të qëndrueshme bindjet

¹⁾ Sh. Sami Frashëri, *Kamus ul alam*, parathënie. vëll. I, Istambull, 1889.

sa i fuqishëm karakteri i tij. Para një heroizmi të tillë shkencor dhe një guximi të tillë politik nuk mbetet veçse të shprehësh admirimin.

Por duke vënë në dukje këto pika kontakti relative me Enciklopedinë e Didëroit nuk mund të mos vihen në dukje dhe plot dallime, të përcaktuara nga koha dhe vendi. Ndërsa Didëroi theksin e vinte në shkencat, artet, zejet, Samiu e vinte atë në historinë dhe gjeografinë përgjithësisht, në historinë dhe gjeografinë e Shqipërisë veçanërisht. Samiu, me aftësitë që kishte, mund të çante në çdo fushë të diturisë njerëzore të kohës. Në qoftë se vëmendjen ai e drejtoi në historinë dhe gjeografinë, kjo nuk ndodhi rastësisht apo për ndonjë arsye të dorës së dytë, por për arsye të thella dhe të rëndësishme. Një nga këto arsye të thella është se popullit shqiptar historia dhe gjeografia i duheshin më tepër se çdo dituri tjetër. Me historinë dhe të dhënat e saj do të provohej ekzistenca e kombit shqiptar, si një komb më vete, me një të kaluar të lavdishme si dhe e drejta dhe aftësia e tij për të dalë i lirë dhe i pavarur. Me gjeografinë dhe të dhënat e saj do të tregohej se ç'territore i përkisnin Shqipërisë dhe sa pa baza ishin pretendimet e monarkive shoviniste. Këtë bënte dhe Naimi me veprën e tij poetike që është plot motive historike dhe gjeografike me tendencë të theksuar patriotike, pa folur për një vepër tërësisht historike të tij, siç është „Historia e Skënderbeut”. Këtë bënte dhe Pashko Vasa me veprën e tij „E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët” një pjesë e së cilës është histori. Në qoftë se natyra të ndryshme krijuese si Samiu, Naimi dhe Pashko Vasa trajtojnë të njëjtin subjekt dhe në bazë të të njëjtës tendencë, kjo do të thotë se këtu nuk është fjala për preferencë personale, por për një kërkesë të rëndësishme shoqërore, në shërbim të së cilës ata ishin vënë me jetën dhe veprën e tyre.

Që në të gjallë të tij Samiu njohu vlerën dhe madhësinë e veprës së tij. Të gjithë njerëzit për-

parimtarë të kohës së tij flisnin me entuziazëm për Enciklopedinë, e quanin atë vepër madhështore me të cilën Samiu i ngriti vetes një monument lavdie që do të qëndrojë për jetë më këmbë. Edhe sot që autori i saj, mendjendrituri dhe i palodhuri Sami, nuk është më, Enciklopedia e tij jeton dhe është gjallë. Ajo jeton dhe është gjallë për kontributin e pamohueshëm që ajo dha në përhapjen e dijeve dhe në formimin e ndërgjegjës kombëtare dhe antiperandorake, si dhe për informacionin e gjerë dhe të saktë që ajo bart në vetvete, vlera e të cilit s'ka të humbur.

Historia ruan për jetë emrat e atyre që çajnë rrugë të reja në dije dhe në shkenca. Një rrugë e re ishte krijimi i Enciklopedisë. Ai e krijoi këtë me një autoritet të tillë që i siguroi vetes një emër që koha nuk ka fuqi ta shuajë. Na mbushen zemrat plot krenari kur kujtojmë se ky emër është ai i një biri të popullit shqitar, i Sami Frashërit tonë.

VIII. FJALËT E URTA — NJË MBROJTJE TJETËR E BOTËKUPTIMIT PATRIOTIK DHE ÇLIRIMTAR

Në vitin 1870 Samiu filloi botimin e një varg veprash në gjuhën turqisht me karakter shkencor divulgativ nën titullin e përgjithshëm „biblioteka e xhepit”. Vetëm brenda një viti, më 1879, ai hartoi dhe nxori në dritë si broshura të veçanta studimet „Qielli”, „Toka”, „Njeriu”, „Gratë”, „Qytetërimi islam”, „Mitet”, që u pasuan me „Tregime zbavitëse” (1883), „Përsëri njeriu” (1885), „Gjuha” (1886), etj. Këto studime flasin për erudicionin e gjerë që kishte arritur Samiu në shkenca të ndryshme natyrore dhe shoqërore. Por botimi i shtatë studimeve brenda një viti, secili me një vëllim prej 100-120 faqesh flet edhe për një diçka akoma më interesante, për aftësinë kolosale të punës dhe talentin e rallë të shkrimit që zotëronte autori i tyre. Erudicioni kaq i gjërë, aftësia kaq e madhe e punës dhe talenti kaq i rallë i shkrimit paralajmëronin me siguri të Samiu autorin e ardhshëm të veprave më themelore dhe më voluminoze siç do të jenë „Enciklopedia” apo „Fjalori i përgjithshëm i historisë dhe i gjeografisë” si dhe fjalorët e ndryshëm gjuhësorë.

Me vepërzat shkencore popullore Samiu do të ndjekë ato synime që do t'i verë vetes më vonë me Enciklopedinë e tij — të përhapë në masat njohuri të drejta shkencore mbi pjesë të tilla të botës si Toka, Qielli, njeriu, që zenë një vend aq të rëndësishëm në botëkuptimin e njeriut dhe rreth të cilave feja dhe ideologjia sunduese obskurantiste përhapte lloj-lloj prrallash për të mashtruar masat dhe për t'i mbajtur ato në gjumë të rëndë. Kurse vepërza e tij mbi gjuhën, tregon se tashmë ishin përcaktuar interesat shkencore të Samiut për këtë dituri kaq interesante dhe të ndërlikuar, siç është gjuha, në të cilën ai do të ngrihej në maja të paarritura deri atëhere dhe për shumë vjete më vonë nga shkenca gjuhësore turke.

Një interes të veçantë në serinë e librave të bibliotekës së xhepit paraqet libri me fjalë të urta dhe aforizma, botuar më 1879-1880, ku Samiu ka mundur të grumbullojë rreth 3000 syresh. Nga të tri mijat vetëm një pjesë, gati gjysma janë krijim i drejtëpërdrejtë i Samiut. Të tjerat janë adaptim apo përkthim nga autorë të lashtë dhe autorë të kohës, nga mendimtarë të lindjes dhe të perëndimit. Sigurisht për vlerësimin e plotë të veprës ka rëndësi të dihet ç'është e vetë Samiut dhe ç'është e të tjerëve. Por ajo që do të kishte më rëndësi në planin e ideve është brendia e vetë fjalëve të urta, kuptimi dhe tendencioziteti i tyre social. E parë në këtë vështrim, nën vështrimin e brendisë së tyre, vepra e Samiut e fjalëve të urta është krijim; ajo mban vulën e personalitetit të tij. Edhe fjalët e urta janë arenë lufte e moraleve, botëkuptimeve, ideologjive të kundërta shoqërore. Edhe në to ndeshet lideologjia përparimtare që ka besim te njeriu dhe në aftësitë e tij për t'u ngritur gjithnjë më lart drejt një bote më të mirë materiale e morale. dhe ideologjia reaksionare që e ul dhe e poshtëron njeriun, që del në mbrojtje të forcave të vjetra shoqërore dhe predikon pamundësinë e shoqërisë për çfarëdolloj progresi. Kjo luftë ideologjish, që vihet re dhe

në fushën e fjalëve të urta, lejon zgjedhjen, presupozon preferenca. Dhe pikërisht në këto zgjedhje, në këto preferenca shfaqet dhe personaliteti i Samiut, këtu duket krijimi i tij.

Porositë dhe mësimet që dalin prej fjalëve të urta të thëna apo të grumbulluara nga Samiu janë si një përmbledhje e të gjithë veprës së tij, si një kuintesencë e idealeve të të gjithë jetës së ti. Prej tyre ngrihet një thirrje e fuqishme për përsosjen e njeriut dhe progresin e shoqërisë nëpërmjet lirisë, diturisë, punës, virtytit. Në analizë selektive, një theksim i disa prej ideve që bien më tepër në sy nga gjithë ajo pasuri e mençurisë kudo në botë, të grumbulluar nga Samiu në shumicën e fjalëve të tij të urta do të tregojë sesa lart ishte ngritur ai mbi ambientin e tij, se me ç'sy atdhetari dhe revolucionari e shihte ai të ardhmen e njeriut, të shoqërisë dhe të vetë Shqipërisë.

Vlera e parë rreth së cilës rrotullon Samiu të gjitha vlerat e tij të tjera si planetët rreth Diellit, ajo vlerë, në emër të të cilës pranohen apo hidhen poshtë të tjerat është atdheu, dashuria për të. Temën e atdheut Samiu e sheh nga disa aspekte, të cilat, po t'i mbledhësh së bashku japin një ide se nga ç'patriotizëm i kulluar frymëzohej Samiu, ç'atdhedashuri të zjarhtë kërkonte ai të shihte në mendjen dhe në sjelljen e çdo shqiptari. Në grumbullin e të gjitha ndjenjave që përbëjnë qenien psikologjike të njeriut ia ngre lart dashurinë për atdhe. „Sendet më të shtrenjtë në botë janë nderi dhe atdheu. Ata që për interes personal kanë marrë nëpër këmbë dashurinë e atdheut kanë shkelur njëkohësisht dhe nderin e tyre”!) (1454). Prandaj kriteri i vlerësimit të një njeriu është qëndrimi që ai mban ndaj atdheut. „Atdhetarizmi tregon vlerën e një njeriu”. (661).

!) Të gjitha fjalët e urta të cituara janë marrë nga një përkthimi i tyre që ruhet në arkivin e Institutit të Historisë. Përmbri vihet numri rendor që mban secila fjalë e urtë.

Atdhedashuria është për Samiun jo vetëm ai virtyt që zbkuron dhe lartëson njeriun por dhe ajo ndjenjë e fuqishme që e ndihmon të jetojë e të luftojë, që i lejon të mposhtë çdo pengesë e vështirësi në rrugën e tij. Asaj nuk mund t'i dalë asgjë përpara dhe t'i kundërvihet. „Ajo si një fuqi e mrekullueshme, — thotë plot frymëzim Samiu, — del fituese mbi gjithshka”. (68) Ajo është si ai topi „që shemb kësh-tjellat më të forta”.

Atdheu dhe populli janë në një korelacion të tillë që çdo gjymtim i njërit sjell dhe gjymtimin e tjetrit. Në qoftë se është e vërtetë se s'ka atdhe pa njerëz, është po aq e vërtetë se atdheu është kushti primar i jetës së popullit, është ai kusht pa të cilin jeta e tij është e metë dhe s'ka mundësi të lulëzojë e të zhvillohet si duhet. Këtë e thotë Samiu në fjalët: „pasuria dhe trupi ynë është prodhimi i asaj toke që quhet atdhe”, se për atdheun duhet dhënë gjithçka, se për të mirën dhe shpëtimin e tij nuk duhet kursyer asgjë — as pasuria, as jeta. „Sa i pavlefshëm është ai njeri që nuk bën fli për atdheun të mirën që atdheu i ka falë” (1607) d.m.th. pasurinë dhe jetën. Samiu nuk është si ata mendimtarë soditës që vetëm flasin për bukurinë e atdheut dhe për vlerën e tij, që vetëm rënkojnë dhe ankohen kur ai është në të keq. Përkundrazi, ai mëson se atdhedashuria është një ndjenjë aktive, se ajo lind dhe mbahet gjallë me punë dhe përpjekje në të mirë të atdheut. Atdhedashuria nuk provohet me fjalë, por me vepra. „Atdhetari, — thotë Samiu, — e tregon me vepra”. Kush nuk derdh një pikë gjaku për tokë të vet, — vëren ai, — kush nuk jep asnjë qindar për të, ai s'ka të drejtë as të varrosët në të. Se këto nuk ishin deklarata të thjeshta, fjalë të hedhura në erë, por të ndjera thellë dhe të thëna me seriozitetin më të madh, këtë e provoi Samiu me të gjithë jetën e tij, që ka qenë jeta e një punëtori të palodhur të pendës, e një luftëtari të paepur për çlirimin e Shqipërisë dhe emancipimin politik, ekono-

mik dhe ideologjik të saj. Para jetës së rahatshme të ofiqeve dhe të pasurisë që i premtonte zotësia e tij, po të vihej ajo në shërbim të Sulltanit, Samiu preferoi jetën e luftëtarit, e atij që shkon kundër rrymës. Me jetën dhe qëndrimin e tij ai tregoi se lumturia dhe nderi nuk qëndrojnë në jetën mesquine, në rehatinë e ngushtë, por në rrugën e gjerë të punës dhe të luftës për çlirimin e atdheut dhe shpëtimin e Shqipërisë. Ai kishte atë kuptim të lumturisë që kanë pasur të gjithë revolucionarët e mëdhenj, të gjithë luftëtarët e progresit kundër reaksionit dhe zgjedhës sociale dhe kombëtare. Për idetë dhe qëndrimet e tij Samiu njohu skamjen, izolimin, shtrëngimin, burgimin. Sulltani nuk e shihte me sy të mirë. Po të sjellim ndër mend se ky sulltan që nuk e shihte me sy të mirë ishte gjakitari dhe despoti Abdyl Hamidi II, atëherë kuptohet se ç'jetë plot shqetësim dhe alarm kalonte Samiu. Në vitet e fundit të jetës ai ishte i detyruar të mos dilte nga shtëpia, bile edhe kur (në këtë kohë) martoi vajzën e tij nuk u lejua t'i shkelte njeri për vizitë.

Edhe shëndetin Samiu nuk e kishte aq të mirë për të përballuar punën dhe përpjekjet që duhet të bënte çdo ditë. Që më 15 prill të vitit 1876, në një letër që Abdyl i shkruante Samiut, Naimi bënte këtë shtesë me dorë të tij: „Kujdes, kujdes, kujdes për trupin... Trupat tanë janë të dobët, të dobët, të dobët. Duhet t'i ruajmë mirë”.¹⁾ Megjithëkëtë të tre vëllezërit, Abdyl, Samiu, Naimi nuk e kursyen veten. As shëndeti i lig, as ndjekjet e pushtetit despotik të sulltanit nuk i bënë ata të trembeshin dhe të ndërronin vendimin e marrë. Rruga që zgjodhën i çoi para kohe në varr, pa kaluar asnjëri kufirin e 55 vjetëve.

Në fjalët e tij të urta për atdheun Samiu mbetet në vlerësime të përgjithshme, nuk hyn në hollësi konkrete për të treguar se për cilin atdhe është fjala,

¹⁾ Citohet sipas letrës që ruhet në arkivin e Institutit të Historisë.

për atdheun shqiptar apo për ndonjë atdhe tjetër. Por po të merret parasysh se ai që shkruante këto fjalë dhe jepte këto porosi ishte një shqiptar dhe një shqiptar jo dosido, por një shqiptar i ndërgjegjshëm që qëndronte në ballë të luftës për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar, pa ndonjë vështirësi mund të arrihet në përfundimin se në to është fjala për atdheun shqiptar, për Shqipërinë. Edhe në rastin e fjalëve të tij të urta Samiu nuk bën punë iluministi, nuk ulet e shkruan për të kënaqur kureshtjen e vet dhe të tjerëve, por për t'u dhënë një mësim që u duhej njerëzve për jetën e tyre. Por ai që kishte nevojë për një mësim të tillë atdhedashurie, atij që i duhej më tepër se tjetërkujt ndërgjegjja kombëtare ishte populli shqiptar, një popull me atdhe të robëruar dhe të kërcënuar nga shumë anë, një popull që ishte në luftë dhe në kërkim të çlirimit të tij. Këtu nuk është pa rëndësi të theksohet se gjuha turke në të cilën jepeshin këto porosi, për arsyet që dihen, nuk ishte e panjohur për shumë shqiptarë. Atë e kuptonte e gjithë rinia e mësuar shqiptare e asaj kohe.

Në porositë e Samiut rreth atdhedashurisë nuk është e huaj dhe përvoja e vet Perandorisë Osmane. Perandoria ishte ai realitet që u kundërvijë aspiratave të popullit tonë për liri dhe pavarësi dhe që s'kishte si të mos merrej parasysh. Për një kuptim të drejtë të atdheut kishte nevojë dhe vetë shoqëria turke që vuante nga despotizmi i sulltanit; ai u duhej dhe vetë shtresave përparimtare turke që luftonin kundër këtij despotizmi. Në këtë plan marrin një rëndësi të veçantë fjalët e Samiut: „i lirë është ai që nuk është në robëri dhe nuk robëron kërkend” (1965). Me këtë aforizëm Samiu u thoshte turqve se liria nuk është kërkesë e kohës vetëm për shqiptarët dhe popujt e tjerë të robëruar, por dhe për vetë ata, të cilët nuk janë të lirë sa kohë që robërojnë të tjerët, sa kohë që jetojnë nën një regjim despotik. Një zgjerim i tillë i frontit të lirisë ishte i natyrshëm për

Samiun në të cilin bashkëjetonte patrioti dhe demokrati dhe që me të drejtë përpiquej ta lidhte luftën e popullit shqiptar për liri me atë të popujve të tjerë dhe të vetë popullit turk. Vetëm revolucionarët e vërtetë mund të ngrihen në një kuptim kaq të gjerë të lirisë, të jenë kundër çfarëdolloj shtypjeje dhe ta bëjnë lirinë e të tjerëve kusht të lirisë së vet.

Duke iu përmbajtur kësaj logjike, duke dashur të zgjerojë frontin e lirisë dhe të ngrejë në luftë për të dhe popullin turk, Samiu zbulon një dialektikë interesante, dialektikën sipas të cilës kombet robëruese, duke u fryrë në kuriz të të tjerëve, në të njëjtën kohë dobësohen. Klasat reaksionare, duke e futur kombin e tyre në rrugën e pushtimeve, i bëjnë një shërbim të keq dhe vetë çështjes së kombit dhe të atdheut të vet dhe shpeshherë e çojnë në katastrofë. „Një shtet, — thoshte Samiu duke arsyetuar në këtë drejtim, — rrëzohet nga dëshira për të pushtuar shumë vende” (756). Ky mësim i Samiut ishte një paralajmërim si për Perandorinë Osmane ashtu dhe për shtetet ballkanike fqinje të Shqipërisë, që me të dalë në dritë kishin marrë rrugën shoviniste të pushtimit

Sa intrasigjent dhe i papajtueshëm është Samiu ndaj kombeve robëruese, aq dashamirës dhe i gjerë është ai ndaj kombeve të robëruara dhe të papërfillura. Për Samiun nuk ka kombe të afta, që janë krijuar vetëm për të sunduar dhe kombe të paafta, që meritojnë vetëm të sundohen. Që të gjitha kombet, pa përjashtim, kanë vlerë dhe meritojnë respekt. „Çdo të bukur” (586). Nuk ishte e thjeshtë ta shpallje këtë botërisht në kryeqytetin e një perandorie, ideologjia sunduese e së cilës justifikonte përbuzjen e kombeve të shtypura, shkeljen e dinjitetit dhe të të drejtave të tyre. Në një lartësi të tillë ai u ngrit si përfaqësues i ndërgjegjshëm i një kombi të robëruar siç ishte kombi ynë.

Në formën e tyre lakonike, në trajtën e tyre të kursyer, shumë fjalë të urta të Samiut janë një thirrje e zjarrtë për liri dhe një argumentim i fitores së saj të pashmangshme. Në to është thelbi i teorive përparimtare që kanë bërë epokë në historinë e mendimit politik dhe shoqëror të shekujve XVII e XVIII. Argumenti natyror i Rusoit është kryesori edhe në fjalët e urta të Samiut. „Në fjalorin e natyrës, — shkruan Samiu, — nuk ekziston fjala robëri” (1282). „Njeriu prej natyre ka lindur i lirë, inteligjent, i qytetëruar. Kush i zotëron këto tri cilësi ai është njeri i vërtetë” (2720). Kuptimi i këtyre fjalëve është i qartë: robëria është e kundërnatyrshme. Ajo është uzurpim i një të drejte të madhe të njeriut të dhuruar nga natyra. Ato kanë në vetvete dhe konkluzionin se liria do të vijë patjetër, sepse natyra nuk duron gjatë të dhunohen ligjet e saj, ajo në fund të fundit bën të sajën.

Në qoftë se mund të pranohen tërësisht konkluzionet që dalin nga teoria natyrore e lirisë, nuk mund të pranohet vetë teoria. Njeriu, i dalë nga natyra është në thelbin e tij një qenie shoqërore dhe liria si dhe të gjitha dukuritë e tjera shoqërore nuk mund të shpjegohen veçse nëpërmjet shoqërisë dhe ligjeve të saj dhe jo nëpërmjet natyrës dhe ligjeve natyrore. Njeriu me të vërtetë ka dalë nga natyra dhe ka hyrë në histori si një qenie e lirë në kuptimin se mbi të nuk rëndonte kurrfarë zgjedhe shoqërore, kurrfarë shfrytëzimi të njeriut nga njeriu. Por kjo ishte një liri që vlente shumë pak, pavarësisht nga përfytyrimet idilike të Rusoit a të ndonjë tjetri, për arsye të thjeshtë se njeriu primitiv ishte skllav i forcave të verbëta dhe të egra të natyrës. Ai ishte, sipas fjalëve të Leninit, „i mbytur deri në fyt nga vështirësitë e ekzistencës, nga vështirësitë e luftës me natyrën”.¹⁾ Liria e njeriut është rezultat i gjithë zhvillimit të historisë botërore.

¹⁾ Lenin, *Veprat*, vëll 5, f. 118.

Ajo mund të arrihet me zhdukjen e pronës private, me kalimin në shoqërinë socialiste, që është, sipas fjalëve të Engelsit, një kërcim nga mbretëria e domoshmërisë në atë të lirisë.

Koha në të cilën jetonte Samiu dhe për të cilën ai shkruante ishte koha që kërkonte një ndjenjë të lartë përgjegjësie para të mirës së përbashkët, koha kur secili duhet të bënte diçka dhe të gjente vendim në luftën dhe në përpjekjet e përgjithshme për shpëtimin e atdheut. Pa përpjekjet e përbashkëta, pa kontributin e secilit në çështjen e përbashkët të luftës për çlirimin e atdheut kjo detyrë nuk mund të nxirrej mbanë. Për këtë është i ndërgjegjshëm Samiu, i cili jep një varg porosish: „E mira më e madhe, — mëson ai, — është e mira e përbashkët” (763), „para interesit të përgjithshëm shuhen ato të veçantat” (1106). Këtu qëndron, sipas Samiut, dhe misioni i njeriut në botë. „Njeriu, — thotë ai, — është një flakë e natyrës për të ndritur jo vetëm veten, por më tepër njerëzimin. Ai që nuk i ka sjellë ndonjë dobi njerëzimit është njëlloj si të jetë si të mos jetë” (2736). Duke vazhduar në këtë rrugë arsyetimi qëndrimin ndaj interesit të përgjithshëm ai e bën kriter për vlerësimin e njerëzve. Në përpjekjet për interesin e përgjithshëm, në aftësinë për t’u shërbyer të tjerëve, shoqërisë, botës, qëndron virtyti. „Njerëz të mëdhenj janë ata që lënë pas vepra të mëdha. Vepra të mëdha janë ato që u kanë sjellë dobi të mëdha njerëzve” (1749). Jashtë përpjekjeve për interesin e përgjithshëm është vesi, është përbuzja, është rënia e njeriut. „Më i përbuzuri është ai që nuk i bën shërbim botës” (884).

Por t’i shërbesh botës, të përpiqesh për të tjerët, të luftosh për të mirën e përgjithshme në sistemet ku sundojnë klasat reaksionare nuk është gjithnjë e lehtë dhe pa rreziqe. Nuk është e lehtë, sepse kjo

kërkon që të heqësh dorë nga interesat vetjake, të dalësh në kundërshtim me atë që është parimi jetësor i shoqërisë së pronës private e ngritur e gjitha në bazë të egoizmit dhe të mohimit të interesit të përgjithshëm. Nuk është pa rreziqe, sepse si rregull, interesi i përgjithshëm, progresi shoqëror shkon në kundërshtim me interesat e klasave reaksionare në fuqi, që ruajnë me xhelozi privilegjet e tyre dhe janë gati të vënë në veprim ndjekjet më çnjerëzore, terrorin më të egër për të ruajtur pushtetin e tyre. Në këto kushte ata që luftojnë për të mirën e përgjithshme, për progresin shoqëror e pësojnë dhe shpesh e pësojnë rëndë. Kjo ishte aq më tepër e vërtetë kur shtrohej problemi në terma më konkrete, kur vihej ai në një terren më real, në atë të Perandorisë Osmane, ku ligjin e bënte arbitrarizmi e terrori dhe një fat tragjik ndiqte këdo që ngrinte krye mbi atë të sulltanit, këdo që kërkonte liri, emancipim social apo kombëtar. Këtë s'kishte si të mos e kishte të qartë Samiu që jetonte në këtë botë terrori dhe intrige, që e kishte provuar mbi shpinën e të vëllait, Abdylit, dhe të vetes ndjekjen, padrejtësinë, dhunën. Por këtë Samiu e thotë jo për t'i trembur njerëzit, jo për t'i bërë që të kthehen prapa, por për t'u dhënë guxim, në vendimin e marrë. „Ai që don t'i shërbejë njerëzimit, — thotë Samiu, — nuk trembet nga fati i keq” (608). Bile fati i keq i bën më të qëndrueshëm në rrugën e zgjedhur. „Fatkeqësia i than rrënjët idealit të dobët, kurse i ushqen dhe i forcon idealet e larta” (1972).

Një komponente tjetër e rëndësishme e njeriut dhe e personalitetit njerëzor për Samiun është dituria, arsimi, edukata. Dituria sjell në jetë dhe ushqen atdhedashurinë dhe të dyja së bashku e shtyjnë njeriun përpara, e mësojnë atë të punojë për të mirën e tij dhe të shoqërisë. Ky koncept iluminist, aq i afërt për mendimin përparimtar të shekujve XVII e XVIII, nuk e lejoi Samiun të shohë më thellë në me-

kanizmin shoqëror dhe të zbulojë atë forcë vendimtare që vë në lëvizje njerëzit dhe shpie përpara shoqërinë, siç është lufta e klasave. Bindjen në rolin vendimtar të diturisë të cilës Samiu i është përmbajtur në mënyrë konsekuente, e shpreh dhe në fjalët e urta „Argëtimi m'i mirë për njeriun, — thotë ai, — është studimi dhe shoku m'i mirë libri” (154). Valorizimi i jetës bëhet nëpërmjet diturisë, prandaj, këshillon ai, „kujdesi i njeriut duhet të përqëndrohet që në çdo moshë ta stolisë veten me dije: fëmija do të mësojë, i riu do ta vërë në praktikë atë që ka mësuar, plaku do të mësojë të tjerët” (14). Diturisë Samiu i njeh dhe një rol të veçantë, atë që të lidhë një brez me tjetrin, të transmetojë përvojën e një kohe në tjetrën dhe me këtë të ndihmojë përparimin e përgjithshëm. „Anijet — thotë ai, — lidhin kontinentet, librat çojnë idetë nga një shekull në tjetrin” (983). Si iluminist konsekuent Samiu i njeh diturisë dhe rolin e zgjimit dhe të përsosjes morale të njerëzve. „Për t'i përmirësuar njerëzit duhet më parë t'i zgjosh ata. Të metat dhe gabimet rrjedhin vetëm nga injoranca” (1829).

Në fjalët e urta të Samiut dhe përgjithësisht në kuptimin që ai i jepte rolit dhe rëndësisë së dijes ka vend për vërejtje parimore. Por është një diçka për të cilën nuk mund të ketë vërejtje dhe kjo diçka është se në kushtet në të cilat ndodhej atdheu ynë atëhere thirrja për dituri dhe mësim ishte një thirrje patriotike dhe përparimtare, sepse përhapja e diturisë do të kërkonte shkrimin e gjuhës shqipe, hapjen dhe zgjerimin e shkollës shqipe, të cilat do t'i jepnin një shtytje të vërtetë gjithë lëvizjes çlirimtare shqiptare.

Dituria është e lidhur ngushtë me idetë që e përëjnë, prandaj ta kuptosh drejt atë do të thotë, midis të tjerash, të kuptosh dhe origjinën e ideve. „Idetë e mëdha, — sipas Samiut, — lindin nga shpirtat e mëdha” (685). Shjegimi është në thelbin e tij idealist dhe jo i drejtë. Sipas këtij koncepti idetë e kanë origjinën në shpirtin e njeriut. Ato mund të

lindin në çdo kohë, mjafton që të shfaqet një individ i pajisur me një shpirt përkatëse. Në të vërtetë pa mohuar rolin e individit, rolin e personalitetit të mendimtarit, duhet vërejtur se idetë nuk varen vetëm nga idividi, por nga një kompleks i tërë faktorësh materialo-historikë. Idetë e mëdha janë ato që i përgjigjen më mirë një kërkesë historike të madhe, që pasqyrojnë më mirë një tendencë të zhvillimit progresiv të shoqërisë apo ato në të cilat formohet dhe interpretohet më mirë një proces apo një ligj i natyrës. Prandaj, për hir të saktësisë, më i drejtë do të ishte pohimi sipas të cilit idetë e mëdha që kanë si burim kërkesat e zhvillimit historik të shoqërisë dhe përparimin e shkencave natyrore janë ato që formojnë shpirtërat e mëdhenj. Por në aforizma dhe në fjalë të tjera të urta Samiu është më afër të vërtetës shkencore reth problemit të burimit të ideve. „Është e pamundur, — thotë Samiu, — të ndash idetë nga interesat” (738). Dhe në një aforizëm tjetër: „kurrkush nuk i shërben një ideje që të jetë në kundërshtim me interesat e tij” (740). Idetë, pra, nuk qenkan produkte arbitrare të shpirtit të njeriut, por përcaktohen nga një botë që del jashtë tij dhe në të cilën fjalën vendmtare e kanë interesat material-klasore. Historia e ideve ka provuar atë që vëren Samiu se kanë qenë interesat material-klasore, ato që kanë sjellë në jetë idetë, që i kanë vënë ato në lëvizje, që kanë shkaktuar disfatën apo fitoren e tyre.

Klasat reaksionare, për të mbrojtur interesat e tyre, zakonisht vaktrojnë dhunën më të egër kundër ideve, burgosin autorët dhe propagandistët e tyre, ndalojnë dhe djegin librat që i përmbajnë. Megjithatë s'ka forcë që të pengojë përhapjen dhe triumfin e tyre. „Idetë, — vëren Samiu, — janë të pamposhtshme” (746). Në ndeshjen e ideve me çdo lloj pengese janë pengesat ato që mposhten dhe jo idetë: „Kur pengohet ideja, — vëren ai më tej, — ajo përllan çdo gjë që gjen përpara” (1810). Është kjo forcë

e ideve ajo që çimentos bashkimet politike të grupeve e të klasave shoqërore dhe që garanton suksesin e tyre. Prandaj ajo që ka rëndësi në çdo bashkim politik dhe në çdo veprimtari shoqërore është ideja që qëndron në themel të tyre. Qëndrimi parimor, besnikëria ndaj ideve është kushti i parë i suksesit të çdo veprimtarie shoqërore. „Bashkimi i ideve, — vëren Samiu me këtë rast, — është më i fortë se ai i kombeve” (685).

Të gjitha këtyre pohimeve të Samiut në thelbin e tyre përparimtare u mungon një element për të qenë plotësisht të drejta dhe për të mos lejuar dy kuptime. Në to nuk thuhet shprehimisht se për ç'ide është fjala, se cilat janë ato ide që përlajjnë çdo gjë që u del përpara, cili është ai bashkim idesh që është më i fuqishëm se bashkimi i kombeve. Këtë aftësi dhe vlerë nuk e kanë të gjitha idetë, por vetëm idetë përparimtare, vetëm ato që shprehin drejt proceset e zhvillimit historik të shoqërisë dhe perspektivat e tij dhe që, për këtë arsye, janë në gjendje të ngrënë peshë masat dhe t'i frymëzojnë ato. Megjithëkëtë është e qartë se në pohimet e Samiut fjala është për idetë e drejta e përparimtare, për idetë patriotike dhe demokratike që përbënin bindjet më të thella të vetë Samiut. Me pohimin e tij se idetë dalin mbanë mbi çdo pengesë Samiu donte të thoshte se çdo gjë që të bëjë sulltani e ka të humbur çështjen e tij. Kombet që jetojnë nën zgjedhën e tij dhe që luftojnë për shpëtimin e tyre, të frymëzuara nga idetë çlirimtare, në fund të fundit do të fitojnë. Nga lartësia në të cilën ishte ngritur në krye të luftës së popullit tonë për liri dhe pavarësi Samiu shihte më mirë greminën drejt të cilës në mënyrë të pashmangshme shkonte pushteti i sulltanit, në dukje i tmerrshëm, në thelb i kalbur.

Përpyekjet për të përhapur idetë patriotike, çlirimtare dhe demokratike e nxjerrin Samiun në kërkesën e lirisë së mendimit, e bëjnë atë një mbrojtës të tolerancës. „Liria, — mëson Samiu, — është ush-

qimi i shpirtit dhe i mendjes. Atje ku s'ka liri, shpirti dhe mendja vyshken porsì bima pa ujë". (1354). Kurse ana tjetër e medaljes së këtij problemi është se idetë nuk durojnë kurrfarë tiranie, se „tiraniam'e tmerrshme është ajo që ushtrohet mbi idetë" (705). Samiu bën dhe një farë anatomie të tiranisë, zbulon se ajo lind jo nga forca, por nga frika. „Tiraniam, — thotë ai, — lind nga frika" (709), „liria është jetë — tirania vdekje" (773). Nuk dimë nëse kishte guxim më të madh se të predikojë kaq qartë lirinë e mendimit të dënojë kaq hapur tiraninë në kohën e sundimit të sulltan Abdyl Hamitit II, tirania e të cilit ishte bërë proverbiale dhe s'njihte asnjë kufi.

Intolerenca vjen nga tirania. Ajo vjen dhe nga fanatizmi fetar. Samiu në emër të lirisë së mendimit nuk nguron të dalë edhe kundër fanatizmit fetar, të tregojë dëmin si dhe origjinën e dyshintë të tij. „Fanatizmi, — thotë ai, — është një përrallë që e ka shpikur mëria, e ka ushqyer frika, e ka ruajtur budallallëku" (59). Së bashku me fanatizmin Samiu bën një varg vërejtjesh therrëse për atë që e ushqen fanatizmi dhe e ka si kalë beteje — për fenë. Feja për Samiun është besim i njerëzve që e kanë humbur betejën mbi tokë dhe janë dorëzuar para vështirësive të jetës, — „njeriu vetëm kur mërzhitet mbi Tokë ngre kryet drejt Qiellit" (1141), si dhe i atyre që s'vlejnë kurrëgjë „e shumta e njerëzve që s'vlejnë kurrëgjë, — thotë më tej Samiu, — kapen pas fesë për të gjetur ngushëllim" (1374).

Me propagandimin e tolerancës, me dënimin e fanatizmit, Samiu bëhet mbrojtës dhe përhapës i atyre ideve, nën frymëzimin e të cilave në shekujt XVII e XVIII u shkallmua diktatura e kishës, u përmbysën fronat dhe dinasti. Njëpërmjet Samiut idetë e shekujve XVII e XVIII të Evropës, idetë iluministe antiabsolutiste dhe antiklerikale bënin hyrjen e tyre dhe në botën e mendimit politik e shoqëror përparimtar të kohës së tij. Toleranca dhe mohimi i fanatizmit i duhe-

shin popullit shqiptar për të luftuar, më mirë dasitë fetare, për të arritur më lehtë në bashkimin kombëtar. Njëlloj si popullit shqiptar, toleranca dhe mohimi i fanatizmit i duhej dhe vetë popullit turk që vuante nga absolutizmi dhe tirania e sulltanit dhe e klerit. Edhe në këtë rast patriotizmi dhe demokratizmi bashkëjetojnë te Samiu. Ai edhe në këtë rast tregohet i ndjeshëm si për problemet e mëdha që mundonin popullin shqiptar ashtu edhe për ato që mundonin vetë popullin turk.

Plot demokratizëm dhe konstatime të drejta janë një varg fjalësh të urta me subjekt punën. Njëpër-mjet tyre Samiu nxjerr në pah shumë vlera të punës dhe në radhë të parë më të rëndësishmen se me punë mbahet jeta e njeriut dhe e shoqërisë, se njëpër-mjet punës shprehet epërsia njerëzore mbi të gjithë botën tjetër. Jeta qëndron në punën, kurse, siç thotë Samiu „të ndenjurit pa punë nuk është jetë” (1722), vetë jeta është një rast për punë” (960). Puna është për njeriun një domosdoshmëri e tillë jetësore së cilës ai as nuk mund t'i shpëtojë, as duhet t'i shpëtojë. Nuk mund t'i shpëtojë, sepse pa punë nuk ka njeri, nuk ka jetë shoqërore; nuk duhet t'i shpëtojë, sepse puna i siguron njeriut lumturinë e vërtetë, atë lumturi autentike që duhet ai të kërkojë dhe të arrijë. „Puna është mjeti i lumturisë” (241); „njeriun nuk e lodh puna, por mërzia. Makina ndryshket jo kur lëviz, por kur nuk punon” (2799); „për njeriun punëtor vetë puna është kënaqësi” (261); „s'ka argëtim më të madh se puna” (1640). Këto fjalë të urta Samiu mund t'i ketë marrë nga mençuria popullore, ndonjë e ka marrë nga mendimtarë të tjerë, ndonjë mund ta ketë nxjerrë vetë. Por ana më me vlerë e tyre është se ato janë të shqiptuara nga një njeri, jeta e ndërgjegjshme e të cilit ka qenë në kuptimin më të mirë dhe më të plotë të fjalës një rast për punë, nga një njeri që ka punuar ditë për ditë, derisa mbylli sytë, në çdo rre-

thanë, edhe atëherë kur qielli i tij jetësor ishte plot re të errëta, duke provuar mundimin e punës, por dhe gëzimin e saj.

Në lartësimin e punës Samiun më tepër se përvoja e tij jetësore e shtytën synimet dhe kërkesat e progresit shoqëror që ndiqte ai me të gjitha mësimet dhe veprimtarinë e tij. S'ka element që ndihmon në çlirimin e njeriut, s'ka faktor që ndikon në zhvillimin e shoqërisë që të mos jetë i afërt për Samiun. Aq më tepër ishte i afërt një faktor i tillë siç është puna, vlera e së cilës duket pa ndonjë mundim të madh në atmosferën e dembelizmit, e mungesës së iniciativës, e imobilizimit që karakterizonte shoqërinë e atëhershme turke.

Por jo çdo lloj pune dhe jo në të gjitha rrethanat puna është lumturi. Ajo bëhet burim lumturie dhe i jep njeriut kënaqësi, kur njeriu i punës është i lirë, kur ai dhe shoqëria e tij i gëzon frytet e kësaj veprimtarie dhe jo të tjerët. Në ata sektorë të shoqërisë së atëhershme të Perandorisë Osmane, ku sundonte zgjedha feudale si dhe në ato të tjerët ku kishte filluar të dukej prona kapitaliste, këto kushte paraprake nuk ekzistonin. Njeriu i punës ishte vënë në një situatë të rëndë. Në punë ai mendohej dhe cfilitej fizikisht, sepse detyrohej të punonte tej forcave të tij; në punë ai mendohej dhe cfilitej moralisht, sepse detyrohej të zbatonte vullnetin e pronarëve parazitë dhe me punën e tij t'u krijonte këtyre një jetë luksi. Puna fiton të gjitha vlerat e saj moral-shoqërore, bëhet me të vërtetë burim gëzimi dhe kënaqësie, siç e kërkonte dhe e predikonte Samiu, kur hiqen nga mesi pronarët, kur zhduket prona private dhe në vend të saj vendoset prona shoqërore dhe njeriu i punës vetë i gëzon frytet e punës së tij. Këto kushte realizohen vetëm në shoqërinë socialiste që është shoqëria e punës dhe e njerëzve të punës, shoqëria ku puna me të vërtetë është burim gëzimi e lumturie, nderi dhe krenarie.

Për një konceptim kaq të gjerë të problemit, ambienti social në të cilin jetonte Samiu nuk ishte i përgatitur. Ideali socialist mbetej për të një ideal i largët. Veçse sensin social Samiu e kishte po aq të mprehtë sa sensin politik. Ky sens e shtynte në një drejtim demokratik, e bënte të merrte me vendosmëri anën e njerëzve të punës kundër shtypësve dhe parazitëve, të kuptonte se nuk është aq e lehtë të bëhet puna burim lumturie atje ku njerëzit e punës kanë mbi krye çifligarë, fajdexhinj, kapitalistë. Plot simpati për fshatarët Samiu thotë: „fshatarët me dru detyrohen të japin frutin e punës së tyre” (977). Plot përbuzje ai flet për pronarët dhe parazitët: „Ata që merren me gjëra të panevojshme apo ata që nuk punojnë fare. . . ushqehen me punën e punëtorëve të ngratë” (2782). Ata që jetojnë me punën e të tjerëve Samiu i quan njerëzit më të dëmshëm për shoqërinë njerëzore. „Njeriu i dëmshëm për shoqëri është ai që jeton me t'adhurat e një çifligu e që s'e punon vetë ose me kamatën e parave” (1667). A nuk ishte dhe vetë Samiu një i shfrytëzuar? Me punën dhe talentin e tij u pasurua botuesi armen Mirhan, kurse fajdexhinjtë nuk iu ndanë në të gjallë dhe në të vdekur. Pa e vënë mirë në dhé trupin e Samiut të vdekur, borxhlinjtë u sulën dhe e vunë në shitje shtëpinë dhe nxorrën në ankand plaçkat e saj. Kështu humbi dhe biblioteka e tij vetjake me më se 12 mijë vëllime.

Simpatinë për fshatarët e barinjët, besimin në mençurinë e tyre Samiu e shpreh gjithashtu si filozof e mendimtar. „Filozofët, — thotë ai, — nuk mërziten kurrë duke biseduar me fshatarët dhe barinjët, sepse në çdo fjalë të tyre ata mësojnë shumë gjëra” (1470). Atë ai e shpreh më në fund, si shkrimtar. Vepra e tij dramatike „Besa” në gjuhën turqisht dhe me subjekt shqiptar është shkruar tërë dashuri dhe simpati për fshatarët e thjeshtë dhe tërë urrejtje e dënim për bejlerët dhe qehallarët e tyre. Për Samiun në këtë dramë përfaqësuesit e bukurisë shqiptare,

BESA

DRAME NE GACTE PAMJE

SAMI BEJ FRASHËRI

Çiftuar nga Tyrolia
prej
AD A Ym KOLONIA

СОФІЯ

УЧЕБНО-ИЗДАТЕЛСКОЕ ПРЕДПРИЯТИЕ
КРИСТИЯН ЛАЗАР, Българско Издателство
1901

Një nga veprat e para të Sami Frashërit është drama „Besa”, shkruar turqisht më 1875, e cila u përkthye shqip më 1901

të virtyteve të larta të popullit tonë janë fshatarët, është Zyberi, bari nga Progonati, Merushja, e bija, Vahideja, e shoqja, kurse Demir beu dhe Selfoja, trimi i tij, janë ata që e mundojnë popullin dhe ia prishin jetën, janë të pabesë dhe të egër, janë personifikimi i vesit dhe i së keqes. Atë që e tha Samiu për punën dhe njerëzit e punës në fjalët e tij të urta apo në dramën e tij „Besa” e tha, apo më saktë, e këndoi Naimi në poemën e tij të famshme „Bagëti e bujqësi” që është një lartësim entuziast i punës, një himn i vërtetë i njerëzve të punës, fshatarëve dhe barinjve të fushave dhe të maleve të atdheut shqiptar.

Një dëshmi tjetër, ndoshta më kuptimplotja, e demokratizmit të Samiut dhe e armiqësisë së tij kundër çdo gjëje që shtypte njeriun dhe shkelte dinjitetin e tij është qëndrimi i Samiut ndaj gruas. Për këtë ai ka mbledhur apo shkruar plot fjalë të urta; për këtë ai ka hartuar një broshurë të tërë në serinë e tij të librave të xhepit „Gratë”. Samiu e sheh gruan jo si një qenie të papërfillur dhe pa vlerë, por si një qenie që ka një rol të pazëvendësueshëm në familje dhe në shoqëri. Brenda familjes ajo është shtylla e saj, jashtë familjes, në shoqëri, ajo luan një rol të madh nëpërmjet edukimit që u jep fëmijëve, qytetarëve të ardhshëm. „Një shtet i qytetëruar, — thotë ai, — mbështetet në edukatën e gruas”. Në një vend tjetër ai bën një pranim të rolit të grave akoma më të prerë dhe kategorik: „Qenia dhe lumtëria e botës qëndron në duar të grave” (149). Në një varg fjalësh të urta ai del haptazi në mbrojtje të gruas dhe dënon ato qëndrime, të zakonshme për ambientin e atëhershëm shoqëror, që cenonin të drejtat e gruas dhe dinjitetin e saj siç ishte sundimi i burrit ndaj gruas apo zakonet që i prishnin jetën siç ishin martesat me pahir dhe pa marrë parasysh vullnetin e saj. „Ai burrë që kërkon të jetë sundues mbi gruan, ka humbur cilësinë e burrit” (1235). „Martesa e vërtetë është ajo që bëhet me

zgjedhje" (1236). Në fjalët e urta dhe në veprën e tij „Gratë" mund të gjenden edhe qëndrime të tjera plot simpati e respekt për gratë ashtu siç mund të bëhen edhe shumë vërejtje kritike. Por ajo që mund të thuhet me siguri, pavarësisht nga vërejtjet e mundshme, është se dhe në qëndrimet e Samiut ndaj gruas vepron e njëjta konstante — konstantja e refuzimit të botës ekzistuese perandorake dhe e kërkimit të një bote të re, të botës së lirë kombëtare, të emancipimit dhe të progresit material, kulturor moral të të gjithë shoqërisë, të burrave dhe të grave.

Në 3000 e ca fjalët e urta ka nga ato që lidhen me qëndrime të caktuara botëkuptimore, shpesh dhe kontradiktore. Në ndonjë rast ka dhe fjalë të urta me brendi fetare pajtuese, që vijnë në kundërshtim me brendinë çlirimtare, patriotike dhe antikonformitse të shumicës prej tyre. Në fjalët e urta të kësaj natyre ka taktikë, ka lëshim kohës dhe ambientit ku jetonte, ka dhe iluzione. Por nuk janë këto që u japin tonin. Ato mbyten në detin e ideve të drejta e përparimtare të Samiut, që ishin këmbana që tingëllonte fort dhe zgjonte njerëzit, ajri i freskët që e bënte të padurueshme kalbësirën sunduese që kishte një emër të urreyer për popujt e shtypur dhe njerëzit përparimtarë të perandorisë — despotizëm dhe burg popujsh. Naimi këndoi në vargje. Samiu arsyetoi në fjalë të urta dhe në traktate politiko-filozofike. Abdyli u hodh në veprime politike. Nga vargu i Naimit, arsyetimi i Samiut dhe veprimtaria e Abdylit do të ndize-shin flakë zemrat e mijëra patriotëve shqiptarë, do të hidhej në beteja të reja një popull i tërë për një atdhe të lirë, për një shoqëri të përparuar.

IX. GJUHËSIA — SHKENCA E PREFERUAR

Në dritën e synimeve që ndiqte Samiu me botimin e Enciklopedisë dhe veprave të tij divulgative, në kontekstin e detyrave politike dhe sociale me të cilat ishte lidhur ai, mund të kuptohen dhe të vlerësohen edhe përpjekjet e realizimet e Samiut në fushën e linguistikës turke. Sa kohë që dijet mbeteshin pronë e një rrethi shumë të kufizuar njerëzish të shtresave të larta, sa kohë që ato nuk dilnin nga kuadri i ideve të teologjisë islame dhe të teksteve të saj, siç ndodhte në Perandorinë Osmane, mund të bëhej dhe pa gjuhën e folur të popullit, mund të kalohej dhe me gjuhën arabe apo me përzierjen turko-perso-arabe që përdorej në shkrimet e asaj kohe, siç kalohej me latinishten e pakuptuar nga populli në botën feudale evropiane. Por proceset e reja ekonomike-shoqërore që po piqeshin kërkonin që të thyhej rrethi i ideve koranike dhe të dilej në fushën e gjerë të dijeve pozitive mbi natyrën dhe mbi njeriun. Këto procese kërkonin gjithashtu që dijet pozitive të bëheshin pronë e një mase më të gjerë njerëzish. Në këto rrethana lindi në tërë rëndësinë e vet problemi i mjetit të komunikimit të dijeve masave të gjera, dmth. problemi i gjuhës, problemi i shkrimit në gjuhën e kuptuar nga populli. Si dikur mendimtarët e Rilindjes

Evropiane hoqën dorë nga latinishtja, filuan të shkruanin në gjuhën e popullit dhe të përpunonin kështu gjuhën letrare të kombeve të ndryshme të Evropës, ashtu dhe Samiu, ky mendimtar kaq shumë i ndjeshëm ndaj kërkesave të reja të shoqërisë dhe të shkencës, shtroi detyrën që të hiqej dorë nga përzjerja turko-perso-arabe që përdorej në shkrimet e asaj kohe dhe të kalohej në gjuhën letrare turke. Por një gjuhë letrare turke në atë kohë nuk ekzistonte. Ajo duhej krijuar. Samiu e kuptoi nga të parët këtë detyrë dhe iu përvesh punës për ta zgjidhur me energjinë dhe erudicionin e tij. Samiu në më se 25 artikuj dhe studime gjuhësore tregoi rrugët, përpunoi parimet e krijimit të gjuhës letrare turke. Samiu e provoi në praktikë vlerën e parimeve të tij. Rezultat i një pune me të vërtetë të gjërë e të odhëshme më se 20 vjeçare janë fjalori turqisht prej 1574 faqesh si dhe Fjalorët turqisht — frengjisht prej 1208 faqesh dhe frengjisht — turqisht prej 1632 faqesh të përgatitur dhe të botuar nga Samiu. Në artikullin kushtuar Sami Frashërit në „Enciklopedia e islamit”, fashikulli 115, viti 1968, Fjalori turqisht cilësohet si „fjalori më me vlerë i turqishtes”, kurse fjalori frengjisht — turqisht po në këtë artikull vlerësohet si „një nga fjalorët më të kërkuar për një periudhë prej gjysmë shekulli, që u është përgjegjur nevojave më të ngutshme... dhe është bërë burimi i të gjithë fjalorëve të mëvonshëm”. Përveç vlerës gjuhësore, fjalorët frengjisht — turqisht dhe turqisht — frengjisht kishin dhe vlerë politiko-shoqërore. Samiu drejtonte vëmendjen nga gjuha frënge jo rastësisht. Në Francë më gjërë dhe më thellë se në çdo vend tjetër ishin zhvilluar ngjarjet revolucionare që kishin goditur në mënyrë rrënjësore dhe me bujë absolutizmin dhe vjetërsirën feudale. Në gjuhën frënge më tepër se në çdo gjuhë tjetër ishin shkruar vepra letraro-filozofike që kishin paralajmëruar dhe frymëzuar revolucionin antifeudal. Nëpërmjet përhapjes së gjuhës frënge Samiu e drejtonte rininë revolu-

cionare, njerëzit përparimtarë të asaj kohe në ato ngjarje dhe në ato burime letrare që do t'i frymëzonin në luftat çlirimtare kundër absolutizmit dhe zgjedhës feudale e kombëtare osmane.

Koha provoi drejtësinë e parimeve gjuhësore të Samiut; ajo provoi qëndrueshmërinë e veprës gjuhësore të tij. Me fjalorët e tij Samiu hodhi themelet e gjuhës letrare turke. Sikur asgjë tjetër të mos kishite bërë Samiu, vetëm ky kontribut që ka dhënë ai në krijimin e gjuhës letrare turke do të ishte i mjaftueshëm për t'i siguruar atij një vend nderi në historinë e kulturës turke.

Si shpjegohet që Samiu, me gjithë se i huaj, u ngrit kaq lart në shkencën gjuhësore turke, zgjidhi detyrat që shtronte krijimi i gjuhës letrare turke më shpejt dhe më mirë se vetë turqit? Epoka në të cilën jetoi Samiu ishte ajo kur kombi ynë duhej të provonte identitetin e tij, të afirmonte vetveten përballë politikës shkombëtarizuese otomane dhe pretendimeve të monarkive shoviniste fqinje. Elementi më i parë i kombit, shprehja më e fuqishme e identitetit dhe faktori më i sigurt i afirmimit të tij është gjuha, prandaj lëvizja çlirimtare shqiptare kishte vënë në qendër të vëmendjes ruajtjen dhe shkrimin e gjuhës shqipe.

Përveç kësaj, momentet kërkonin edukimin patriotik dhe çlirimtar të popullit shqiptar, krijimin tek ai të një kuptimi të drejtë të situatave dhe rrugeve që duheshin ndjekur për t'i përballuar ato me sukses. Mjet më të përshtatshëm për këtë se libri dhe shkolla në gjuhën shqipe nuk kishte. Kjo ishte një arsye tjetër që lëvizja çlirimtare shqiptare u kap aq fort pas gjuhës së shkruar shqipe.

Më në fund, gjuha shqipe ndryshe nga krahina apo feja, që shpesh bëheshin shkas për mosbesim dhe përçarje, ishte e përbashkët për shqiptarët dhe njëlloj e afërt dhe e dashur për ta. Me këtë, gjuha shqipe bëhej një faktor i pazëvendësueshëm bash-



Sami Frashëri me fëmijët e vet (1898)

kimi, një hallkë pas së cilës lëvizja çlirimtare do të kapej fort për të realizuar bashkimin e forcave patriotike në luftë për liri dhe pavarësi kombëtare.

Interesi kaq i lartë i lëvizjes çlirimtare shqiptare për gjuhën e shkruar shqipe u bë dhe interesi i Samiut që ishte një nga drejtuesit dhe frymëzuesit

e saj. Për gjuhën e shkruar shqipe Samiu filloi të mendojë e të punojë qysh në fund të viteve 70-të të shekullit XIX. Rezultat i këtij kujdesi ishte alfabeti i gjuhës shqipe, i krijuar prej Samiut, abetarja dhe gramatika e gjuhës shqipe, të shkruara prej tij, një varg arsyesimesh parimore në gazetat „Drita” e „Dituria” dhe në veprën „Shqipëria ç’ka qenë...” ku argumentohet vlera e gjuhës shqipe si mjet kulture dhe në të njëjtën kohë si mjet edukimi patriotik dhe afirmimi kombëtar. Lëvizja çlirimtare shqiptare ia kishte hapur mendjen Samiut për problemet e gjuhës, kishte mprehur interesin e tij për to, kishte krijuar plot premisa që ai të kthente vëmendjen e tij dhe drejt problemeve të gjuhës turke, ku Samiu punoi dhe krijoi me një autoritet të rrallë shkencor. Fjalorët e ndryshëm, të dalë nga dora e Samiut, janë dëshmia më kuptimplote dhe konkluzioni logjik i arsyesimeve dhe i studimeve linguistike shkencore të tij.

Shumëkush do të tundohej të vërente, me dashamirësi apo me keqdashje, pse Samiu, duke qenë shqiptar dhe udhëheqës e frymëzues i lëvizjes çlirimtare shqiptare, veprat e tij më të mëdha i ka në turqisht dhe jo në shqip? Pse para se të shkruante fjalorin e turqishtes, nuk shkroi atë të shqipes? Pse Enciklopedinë e tij të famshme e shkroi turqisht dhe jo shqip? Po të bëhej një pyetje e tillë ajo duhej të shtrohej pak më ndryshe dhe pikërisht: a mund të shkruante Samiu një enciklopedi në gjuhën shqipe dhe a duhej të bënte këtë? Themi se jo. Popullit tonë në ato kohëra i duhej alfabeti shqip, abetarja shqipe, tekstet shqipe për shkollat, i duheshin vetë shkollat. Ta filloje punën (dhe atëherë ishin fillimet e këtyre punëve) nga enciklopedia donte të thoshte të filloje ndërtimin e çatisë pa hedhur më parë themelet e ndërtesës. Siç duket Samiu kishte një sens të theksuar realist, i kishte këmbët fort mbi truallin e kërkesave imediate të lëvizjes çlirimtare të popullit shqiptar. Është kjo arsyeja që një shkencëtar si Sa-

miu që ishte ngritur në nivele aq të larta të shkencës gjuhësore dhe përgjithësisht të dijes njerëzore ulet e shkruan gjëra të thjeshta si „abetarja e gjuhës shqipe”, „shkronjëtorja e gjuhës shqipe”, „dhe shkronja” për mësonjtoret e para. Me këto vepra, që ishin më të mirat e kohës në gjininë e vet, Samiu i bëri punë shqipes dhe çështjes së çlirimit të Shqipërisë shumë më tepër se ç'do t'i bënte, të themi, me një enciklopedi shqipe. Me të Samiu i jepte gjuhës shqipe gjithçka që i duhej për t'u bërë një gjuhë e shkruar, një gjuhë e shkollës, kurse shqiptarëve një mjet të fuqishëm për t'u afirmuar si komb dhe për ta ngritur më lart ndërgjegjen e tyre kombëtare. Përveç teksteve për mësonjëtorët e para, Samiu shkroi në shqip dhe një vepër si „Shqipëria ç'ka qenë...” që në krahasim me veprat më serioze të shkruara në subjekte të ngjashme s'ka asgjë mangut nga drejtësia e qëndrimeve, forca e argumentimit dhe gjerësia e idealeve.

Botimet e Samiut në shqip ishin akte revolucionare. Ishin akte revolucionare, sepse me to konsolidohej gjuha, një nga shtyllat e kombësisë shqiptare, që atëherë vihej në pikëpyetje nga forcat e errëta të reaksionit osman dhe të shovinistëve fqinjë. Ishin akte revolucionare, sepse ato botoheshin në kundërshtim me urdhrat dhe me të gjithë politikën antikomuniste terroriste të sulltan Abdyl Hamidit II.

Pastaj, sepse shkroi Enciklopedinë në turqisht apo sepse me fjalorët e tij hodhi themelet e gjuhës moderne turke, mos Samiu u bë më pak shqiptar? Sa e sa shkencëtarë të një vendi kanë shkruar për gjuhën, historinë, gjeografinë, entnografinë e një vendi tjetër? Bile dhe në gjuhën e vendit tjetër!

Në rastin e Samiut problemi nuk është aq i thjeshtë sa mund të duket sot kur shthurja e Perandorisë Osmane është bërë një fakt, siç është bërë gjithashtu një fakt Shqipëria e lirë dhe e pavarur. Atëherë punët ishin ndryshe. Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë

Osmane, dhe kjo prej gati 500 vjetësh, kurse banorët e saj qytetarë të kësaj perandorie. Ata mund të punonin dhe të jetonin brenda këtij ambienti shoqëror, në rrethanat e tij ekonomiko-politike. Dhe kur njeriu ishte me një talent të rallë, si Samiu ynë, ai s'kishte sesi këtë talent të mos e shfaqte në gjuhën në të cilën botoheshin dhe përhapeshin veprat letrare dhe shkencore, siç ishte në këtë rast, gjuha turke. Megjithëkëtë gjithë jeta e Samiut, gjithë veprimtaria e tij është një dëshmi e gjallë që provon në mënyrë bindëse se Samiu nuk e humbi asnjëherë fytyrën e tij si shqiptar dhe si patriot. S'ka as edhe një ngjarje të rëndësishme të lidhur me kombësinë shqiptare dhe luftën e saj qllirmtare ku të mos ketë qenë prania e drejtëpërdrejtë apo e tërthortë e Samiut, një prani jo dosido, por udhëheqëse dhe frymëzuese. Dhe kjo që nga vitet 70-të të shekullit XIX kur çështja shqiptare doli me forcë në skenën politike të atëhershme dhe derisa mbylli sytë në fillim të shekullit tonë. Ata që e kanë njohur nga afër tregojnë se vetë Samiu ishte i pakënaqur me ato që kishte shkruar në gjuhën shqipe dhe thoshte se kur të çlirohej Shqipëria ai do të kishte mundësi të shkruante shumë më tepër në gjuhën shqipe. Akademia dhe universiteti me të cilët e përfytyronte Samiu Shqipërinë e lirë do të kishin nevojë patjetër dhe për vepra të tjera madhore të Samiut në gjuhën shqipe.

Samiu ynë njihet në botën osmane me emrin Shemsettin Sami, ashtu si disa qindra vjet më parë Gjergj Kastrioti ynë është njohur atje me emrin Skënderbej. Me gjithë emrin osman që iu është ngjitur, me gjithë orvatjet e bëra nga të tjerët për t'i çnatyralizuar kombërisht dhe për t'i quajtur të vetët, Samiu njëlloj si Skënderbeu ka qenë dhe mbetet shqiptar në origjinë, shqiptar në bindje dhe veprimtari, mendimtar i madh i popullit shqiptar ashtu si Skënderbeu luftëtar i madh i popullit shqiptar. Veprat në gjuhën shqipe dhe kushtuar Shqipërisë si dhe

ato në gjuhën turke dhe kushtuar gjuhës dhe kulturës turke janë dy pjesë të një vepre të vetme. Që të dyja ato janë për ne, bijtë e popullit që nxori Samiun, një titull krenarie kombëtare. Ne jemi krenarë që nga penda e Samiut ka dalë një vepër monumentale si „Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë”, kryevepra e mendimit politik shqiptar të atëhershëm dhe të mëvonshëm. Ne jemi gjithashtu krenarë që nga penda e Samiut kanë dalë vepra monumentale në gjuhën turke si „Fjalori i përgjithshëm i historisë dhe gjeografisë” ose fjalorët turqisht, turqisht — frengjisht dhe frengjisht — turqisht, pa të cilët kultura turke do të dukej më e varfër.

X. FILOZOFI, DIJETARI I SHQUAR I SHQIPËRISË

Në një ditë vere, në ditën e largët të 18 qershorit 1904, në moshën 54-vjeçare, vdiq Sami Frashëri, një nga personalitetet më përfaqësuese të historisë së mendimit dhe të lëvizjes çlirimtare shqiptare të shekullit XIX.

Vepra e Samiut është aq e gjerë, veprimtaria e tij aq e pasur sa që shumë cilësime do të ishin me vend: patriot, revolucionar, mendimtar, publicist, edukator, letrar, linguist. Por cilësimi më i mirë, ai që do ta jepte me një fjalë vlerën e Samiut, është cilësimi „rilindas”. Samiu ishte një rilindas në kuptimin më të mirë të fjalës: me dashurinë e tij për Shqipërinë, me krenarinë e të qenit shqiptar, me mendjen e hapur për dituri dhe mësim në gjuhën shqipe, me kultin e lirisë, me besimin në një të ardhme të bukur për Shqipërinë dhe Shqipëtarët. Para së gjithash, përkujtojmë patriotin, ideologun dhe frymëzuesin e luftës së popullit tonë për liri e pavarësi në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

Samiu u doli përpara kohëve të reja që po vinin për Shqipërinë. Ai e kuptoi me një qartësi që nuk linte asnjë fije dyshimi se Shqipëria duhej të shkëputej nga Turqia dhe të dilte e lirë dhe e pavarur, se situatat zhvilloheshin në një drejtim të tillë që liria

dhe pavarësia duhej të realizoheshin medoemos. Shkëputja e Shqipërisë nga Turqia dhe çlirimi i saj u bënë ideja qendrore e jetës së Samiut dhe, duke filluar nga vitet 70-të të shekullit XIX e derisa vdiq, e gjithë veprimtaria e tij u zhvillua nën shenjë e kësaj ideje.

Më 1877 Samiu është organizator i „Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare” dhe dy vjet më vonë kryetar i „Shoqërisë së shkronjézave shqipe”, e cila do të hedhë themelet e alfabetit dhe të librit shqip, të mësimit dhe të shkollës shqipe.

Gjithnjë në këto vite, në faqet e gazetës së përditshme në gjuhën turqishte „Zëdhënësi i Lindjes”. Samiu, si kryeredaktor i saj, mbron plot vendosmëri e mençuri çështjen shqiptare nga synimet grabitqare të qarqeve shoviniste si dhe nga intrigat që ata thurinin, nën mbrojtjen e Fuqive të Mëdha të Evropës.

Samiu është një nga organizatorët dhe drejtuesit e revistave të para në gjuhën shqip, botuar në Stamboll më 1884 — 1885, „Drita” dhe pastaj „Dituria”. Të një natyre me këtë veprimtari dhe si vazhdim i saj janë përpjekjet e Samiut për hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë (1887). Tekstet e para me të cilat do të mësojnë fëmijët shqiptarë në këto shkolla, janë shkruar nga dora e Samiut: një abetare e gjuhës shqipe një gjeografi (dheshkronjë) e botës dhe një tjetër e Shqipërisë, një gramatikë (shkronjëtoje) e gjuhës shqipe. Me këto tekste të Samiut dhe me të tjerat, të shkruara nga Naimi, filloi jetën e saj shkolla jonë e re. Në këtë kuptim ajo ishte një shkollë e lumtur, sepse të rralla janë shkollat e para në botë që të kenë pasur si organizatorë dhe frymëzues njerëz kaq me talent, kaq me erudicion, kaq entuziastë si Samiu dhe Naimi.

Veprimtarinë letraro-filozofike në të mirë të çështjes shqiptare Samiu e kurorëzon me veprën e tij madhore „Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë” (1899), traktati më i rëndësishëm i mendimit politik

dhe shoqëror të popullit tonë për atë kohë. Deri atëherë nuk kishte dalë ndonjë vepër tjetër ku të ishin shpjeguar dhe argumentuar aq drejt situatat nëpër të cilat kalonte lufta çlirimtare e popullit shqiptar, si dhe detyrat që dilnin nga këto situata. Deri atëherë nuk njihej ndonjë vepër tjetër ku të ishte aq e fuqishme fryma demokratike dhe revolucionare, aq i patundur besimi në të ardhmen e Shqipërisë, në liri e begati. Vepra i përgjigjej më së miri detyrës që Samiu i kishte vënë vetes dhe që e shpallte që në titull: të jepte „mendime për shpëtim të mëmëdheut nga reziket që e kanë rrethuarë”.

Artikujt në revistën „Drita” dhe „Dituria” Samiu i botonte pa emër, vetëm me tri yje poshtë, kurse veprën „Shqipëria ç’ka qenë...” pa emër fare, të gjitha këto shenja që tregojnë se me botimet e tij Samiu nuk bënte punë letrari diletant, por punë revolucionari, propagandisti dhe organizatori politik në kushtet e vështira të absolutizmit politik dhe të ndjekjeve të egra kundër të gjithë atyre që luftonin për çështjen shqiptare.

Krenaria e të qenit shqiptar nuk e la Samiun asnjëherë. Kombësinë e tij shqiptare ai e përmendte me mburrje dhe e shpallte hapur. Kur më 1878 kalëmxhiu i një gazete greke „Neologos”, që botohej në Stamboll, e quante Samiun në mënyrë fyese „shumë fanatik dhe toskë” ai i përgjigjet: „Toskë... për ne është një titull nderi dhe krenarie. Prandaj për këtë ne nuk i zemërohemi, përkundrazi, e falenderojmë „Neologosin”. Kombësia dhe Atdheu janë të shenja për çdo njeri”.

Megjithëse larg Atdheut, në Stamboll, ai në Shqipëri e kishte mendjen. Shpesh ai shqiptonte vargje të Hygoit që, së bashku me kujtimet e fëminisë, i sillnin ndër mend kohën e bukur të kaluar në vendlindje. Këto vargje i ka përkthyer Naimi dhe i ka vënë në „Bagëti e bujqësia”:



Sami Frashëri 47 vjeçar

*Opopo! Kështu pse më vini përpara syve pa pushim,
O ditët e djalërisë, o moj kohëz e të rit tim?*

Ndjenja e hidhur se është në vend të huaj, dëshira për të gjetur prehje në natyrën e bukur shqiptare në mes të popullit të tij shqiptar, e kanë shoqëruar Samiun, njëlloj si Naimin, gjatë gjithë jetës. Në momentet e mërzisë dhe të vështirësive ai përsëriste këto vargje persisht në të cilat gjente prehje dhe ngushëllim.

*Në më zëntë vdekja në kurbet pëqinë tim
Vallë ku do të ma bëjë varrin dhe do të më
qepë qefinë?*

*Qivurin virmani në një vend të lartë,
Që veriu të shpjerë një fllad prej
meje në mëmëdheun tim.*

Ky mall i pashuar për Shqipërinë, kjo dashuri për shqipëtarët e papërfillur që i rrihte taksidari, që i mundonin ethet dhe shpesh linin kockat në dhe të huaj, kjo brengë e pangushëlluar për Atdheun e robëruar dhe të braktisur, e kanë vënë në lëvizje Samiun, e kanë mbushur me energji të pashterura për të bërë atë që bëri në fushat e ndryshme të veprimit patriotik-revolucionar, të krijimit letrar-publicistik, të mendimit shkencor-filozofik.

Shqipëtar lindi Samiu dhe shqiptar mbeti ai për tërë jetën nga binjet, nga ndjenjat, nga idealet e tij. Samiu grumbulloi një dije aq të madhe, krijoi në fusha aq të ndryshme, saqë pa frikë mund të quhet një mendje universale dhe enciklopedike.

Ai nuk la fushë të krijimit letrar dhe të shkencave humanitare në gjuhën turke pa prekur dhe pa treguar erudicionin e talentin e tij. Në shumë prej tyre, si në atë të linguistikës, ai bëri punë pionieri dhe zbuluesi. Me studimet e tij linguistike ai hodhi themelet teorike të gjuhës letrare turke, kurse me fjalorët e tij frën-

gjisht — turqisht, arabisht — turqisht dhe turqisht — turqisht, ai tregoi se si mund të krijohej ajo praktikisht. Me 15 broshurat filozofike të botuara në formën e botimeve „biblioteka e xhepit”, si p.sh. „Njeriu”, „Toka”, „Qielli”, „Gratë”, „Mitet”, etj., ai dha një botëkuptim të përparuar filozofik, një ideologji të lirisë dhe të përparimit ekonomik e shkencor. E kurorezoj këtë me veprën e tij monumentale „Fjalori i përgjithshëm i historisë dhe i gjeografisë” në 6 vëllime me gati 5000 faqe.

Ky krijim kaq i pasur i jep figurës së Samiut përpjesëtime që i kapërcejnë së tepërmi kufijtë e Atdheut tonë. Ai e ngre në nivele që nuk i kishte arritur deri atëherë jo vetëm kultura e re shqiptare, por dhe ajo turke, dhe e bën atë një shkencëtar të nivelit ndërkombëtar.

Kur njeriu sjell ndër mend këtë krijim kaq të pasur letraro-shkencor që matet me dhjetëra vëllime dhe me dhjetra mijëra faqe, s'ka si të mos habitet dhe, në të njëjtën kohë, të mos admirojë talentin e madh dhe aftësinë kolosale për punë të Samiut. Jeta e tij ishte ajo e një punëtori të palodhur dhe të pamposhtur të penës. Samiu shpejtonte të krijonte jo vetëm sepse kishte shumë për të thënë, por edhe sepse epoka, zëdhënësi i së cilës ai u bë, ishte e barsur me probleme të shumta e të mëdha që kërkonin zgjidhje të shpejtë.

Në kohë Samiun e ndajnë 2-3 shekuj nga mendimtarët e Rilindjes evropiane. Por nga pikëpamja e karakterit të problemeve dhe e mprehtësisë së tyre ai është i afërt me ta. Dhe epoka e Samiut, njëlloj si ajo e Rilindjes evropiane, qoftë në planin e Shqipërisë, qoftë në atë të Perandorisë Osmane, kishte nevojë për titanë, dhe një titan si ata të Rilindjes evropiane „nga forca e mendimit, pasioni dhe karakteri, nga njohuritë e shumanshme dhe nga dituria” (Engelsi) ishte edhe Samiu ynë.

Vlera e veprës së Samiut të shkruar në shqip nuk është në përpjesëtim të drejtë me vëllimin e saj. Ndonëse si vëllim ajo është relativisht e pakët, si vlerë ajo zë vend të veçantë në të gjithë kulturën tonë. Kultura shqiptare dhe vetë kombi shqiptar, më tepër se për çdo gjë tjetër, kishin nevojë për alfabet, për abetare, për libra shkollë. Pa hedhur këto shkallë të para nuk mund të ngjiteshin shkallët e mëtejshme në fushën e arsimit e të kulturës. Pa to përpjekjet për formimin e një ndërgjegjeje kombëtare ishin të pamundura. Po t'u shtohet këtyre edhe vepra „Shqipëria ç'ka qënë...” që përbënë filozofinë e çlirimit kombëtar shqiptar, strategjinë dhe taktikën e tij, atëherë del qartë se rëndësia historike e veprës së Samiut e shkruar në shqip është e jashtëzakonshme. Është e jashtëzakonshme, sepse rëndësia e një vepre matet në radhë të parë me atë të re që ajo i shton thesarin të kulturës së një populli, si dhe me rolin që ajo luan në vetë fatin e tij. Me abetaren e tij, me gramatikën dhe me tekstet e tjera për shkollat, Samiu hidhte themelet e kulturës së re shqiptare, kurse me veprën „Shqipëria ç'ka qënë...”, ai frymëzonte dhe i tregonte rrugën e çlirimit dhe të përparimit një populli të tërë.

Botimet e tij në shqip vetë Samiu nuk i shihte si një kufi, por vetëm si fillim të një rruge të gjatë. Shqipërinë e lirë Samiu e përfytyronte me shkollat të shumta e të ndryshme, me universitetet dhe akademi të shkencave, të cilat, patjetër, do të kërkonin vepra të shumta në gjuhën shqipe. Këtë Samiu nuk ua linte brezave të ardhshëm. Ai shpresonte të merrte pjesë edhe vetë në të. Samiu nuk e arriti lirinë e Shqipërisë dhe s'mundi të shkruante në gjuhën shqipe aq sa deshte dhe si deshte. Por edhe me ato gjëra që shkroi në gjuhën shqipe ai hyri përgjithnjë në historinë e kulturës dhe të lëvizjes çlirimtare shqiptare.

Samiu është një nga ato personalitete të kohës që e kuptoi me qartësinë më të madhe se perandoria i kishte ditët e numëruara, se ajo ishte e dënuar pa

shpresë shpëtimi, se gjithë çështja ishte të shpejtohej ky proces si një proces përparimtar. Në veprën e tij „Shqipëria ç'ka qënë...” Samiu e jepte si lajm të mirë përfundimin se „Turqia as mund të rronjë paskëtaj, as di, as do të rronjë, edhe as duhet të rronjë. Ky është një njeri i vdekur. Sado ta duamë një të vdekurë, duhet ta vemë në dhet”. Në këtë përfundim Samiu vinte jo vetëm në bazë të vëzhgimeve dhe të përvojës së tij jetësore brenda perandorisë, por kryesisht si shqiptar, si një njeri që kërkon lirinë e Atdheut të vet, të robëruar pikërisht nga kjo perandori. Që më 1881, d.m.th. gati 20 vjet para se të formulonte këtë konkluzion të prerë. Samiu i shkruante De Radës: „Këtë herë (është fjala për ngjarjet e Lidhjes shqiptare të Prazrenit) shqiptarët e kuptuanë fortë mirë që mbretëria nuk do të bënjë gjë kurrë për ta...”. Më poshtë ai vazhdon në të njëjtën frymë „Turku nuk do zgjimin e shqiptarëve dhe lindjen e Shqipërisë përsëri, po do ta ketë të fjetur e të veruarë”

Problemi për Samiun shtrohej qartë: O Turqia do të vazhdojë të jetojë siç është dhe atëherë s'ka zgjim të shqiptarëve dhe lindje të Shqipërisë, o përkundrazi. Shqipëria do të rilindë, dhe kjo rilindje nuk mund të arrihet veçse nëpërmjet shkatërrimit të Perandorisë osmane. Samiu, si patriot i vendit dhe i popullit të vet, ishte, sigurisht, për alternativën e dytë. Në këtë patriotizëm e ka origjinën gjithë qëndrimi praktik dhe ideologjik armiqësor që mban ai ndaj absolutizmit dhe përgjithësisht ndaj politikës robëruese të Perandorisë osmane.

I bindur se Perandoria Osmane duhej shembur, se absolutizmi i sulltanit, me të cilin ajo mbahej, duhej shkatërruar, se e gjithë jeta shoqërore duhej riformuar në baza të reja demokratike, Samiu, me veprën e tij mori pjesë në përpunimin e ideologjisë së këtij shkatërrimi dhe të këtij riformimi të të gjithë jetës së shoqërisë turke në baza të reja. Kështu lindi

vepra letraro-filozofiko-shkencore në gjuhën turqishte që e futi përgjithnjë emrin e Samiut edhe në historinë e kulturës e të shkencës turke. Në këtë kulturë ai hynte si shqiptar. Në të gjitha qëndrimet përparimtare politiko-filozofike ai vinte nëpërmjet ndërgjegjës së tij si patriot shqiptar, si një njeri që ëndërronte lirinë, diturinë, përparimin për Atdheun e vet.

Bile edhe në fushën e posaçme të studimeve gjuhësore turke, ku Samiu u tregua një shkencëtar i shquar, ai erdhi si shqiptar, nëpërmjet ndërgjegjës së patriotit shqiptar. Në kushtet e atëhershme historike gjuha shqipe ishte bërë hallka për zgjidhjen e problemeve jetike të formimit të ndërgjegjës kombëtare shqiptare, të emancipimit shqiptar dhe politik shqiptar. Në ruajtjen, formimin dhe përpunimin e gjuhës së shkruar shqipe, patriotët shqiptarë shihnin shpëtimin. Interesimi i veçantë për gjuhën shqipe dhe për problemet e saj e bëri Samiun të interesohet edhe për problemet e gjuhës turke dhe si një njeri me aftësi kolosale pune e me talent të madh që ishte, Samiu u ngrit edhe në këtë fushë në nivele të larta teorike dhe shkencore.

Samiu ishte vëllai i denjë i Abdylit dhe i Naimit, vëlla në gjak dhe vëlla në ideale. Si ata dhe së bashku me ta, është në agimin e Shqipërisë së lirë dhe të pavarur. Kjo është arsyeja më e thellë që populli ynë, në ditët e mira dhe në ato të këqija, nuk i harron ata asnjëherë, ruan kujtimin e tyre me një nderim të veçantë.

PËRMBAJTJA

Parathënie	7
Samj Frashëri — figurë qendrore e Rilindjes Kombëtare Shqiptare	9
„Zëdhënësi i Lindjes” — tribunë e mbrojtjes së interesave kombëtare shqiptare	16
Letra drejtuar De Radës — dokument i patriotizmit luftarak	24
Në krye të „Shoqërisë së shkronjézave” të Stambollit	33
Propagandisti i flaktë i diturisë dhe i përparimit . .	40
Statisti i shquar i Shqipërisë	54
Enciklopedia — thesar i pashtershëm diturie	107
Fjalët e urta — një mbrojtje tjetër e botëkuptimit patriotik dhe çlirimtar	115
Gjuhësia — shkenca e preferuar	136
Filozofi, dijetarj i shquar i Shqipërisë	144



Zija Xholi

SAMI FRASHËRI

Redaktor teknik
Shyqri Kushevisa

Korrektor
Nazmi Rrahmani

Tirazhi 10.000 copë

U shtyp në tetor të vitit 1978
në Shtypshkronjën e Ndërmarrjes
gazetare, botuese e grafike
„Rilindja” — Prishtinë